



Udhëzues për dispozitat kryesore
të kontratës së Partneritetit Publik
Privat të bazuar në
disponueshmëri
Partneritetet Publike Private në Ballkanin
Perëndimor

2018

Kushtet e përdorimit të këtij dokumenti

Qendra Evropiane e Ekspertizës së Partneritetit Publik Privat (QEEP) është pjesë e Shërbimeve Këshillimore të Bankës Evropiane të Investimeve (BEI). Ajo është një iniciativë që përfshin Bankën Evropiane të Investimeve, Komisionin Evropian, Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian, shtetet candidate dhe disa shtete të tjera. Për më shumë informacion në lidhje me Qendrën Evropiane të Ekspertizës së Partneritetit Publik Privat dhe anëtarësinë e saj, ju lutemi vizitoni www.eib.org/epec.

Ky dokument është përgatitur me qëllim që të kontribuojë në diskutimet për Partneritetet Publike Private (PPP). Gjetjet, analizat, interpretimet dhe konkluzionet e përfshira në këtë dokument nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet ose politikat e Bankës Evropiane të Investimeve ose të ndonjë anëtari tjetër të Qendrës Evropiane të Ekspertizës së Partneritetit Publik Privat. Asnjë anëtar i Qendrës Evropiane të Ekspertizës së Partneritetit Publik Privat, përfshirë Bankën Evropiane të Investimeve, nuk merr përsipër asnjë përgjegjësi për saktësinë e informacionit që përmban ky dokument apo ndonjë përgjegjësi për ndonjë pasojë që vjen nga përdorimi i tij. Prandaj, risku i mbështetjes në informacionin e dhënë në këtë dokument i përket tërësisht i përdoruesit.

Qendra Evropiane e Ekspertizës së Partneritetit Publik Privat autorizon përdoruesit e këtij dokumenti që të përdorin, të shkarkojnë, të shfaqin, të riprodhojnë dhe të printojnë përmbajtjen e tij duke iu nënshtruar kushteve të mëposhtme: (i) kur përdoruesit të përdorin përmbajtjen e këtij dokumenti, ata duhet të tregojnë burimin e materialit dhe (ii) ky dokument ose përmbajtja e tij nuk duhet të shfrytëzohen në asnjë rrethanë për qëllime tregtare.

Ky dokument është përgatitur me ndihmën financiare të Fondit të Përbashkët Evropian për Ballkanin Perëndimor sipas Kuadrit të Investimeve të Ballkanit Perëndimor.

Pikëpamjet e shprehura këtu janë ato të Qendrës Evropiane të Ekspertizës së Partneritetit Publik Privat dhe, prandaj, ato nuk mund të merren në asnjë mënyrë si pikëpamje që pasqyrojnë mendimin zyrtar të Kontribuuesve të Fondit të Përbashkët Evropian për Ballkanin Perëndimor ose të BERZH-it, si bashkëdrejtues i Fondit të Përbashkët Evropian për Ballkanin Perëndimor.

Tabela e përmbajtjes

Shkurtime.....	5
Historik.....	6
1. Hyrje	8
1.1 Qëllimi dhe struktura e këtij udhëzuesi	10
2. Kuadri ligjor i PPP-ve në vendet e Ballkanit Perëndimor	12
3. Kontrata e Partneritetit Publik Privat.....	14
3.1 Panoramë e përgjithshme e përmbajtjes së kontratës së Partneritetit Publik Privat.....	14
3.2 Kontratat e standardizuara të Partneritetit Publik Privat dhe udhëzimet	17
4. Rregullat e aksesit në truall	19
4.1 Panoramë e përgjithshme	19
4.2 Natyra e të drejtave që jepen	19
4.3 Pronësia.....	19
5. Projektimi dhe ndërtimi.....	22
5.1 Panoramë e përgjithshme	22
5.2 Risqet e mbajtura dhe të ndara	22
5.3 Kolaudimi i ndërtimeve	24
6. Funksionimi dhe mirëmbajtja.....	26
6.1 Panoramë e përgjithshme	26
6.2 Mirëmbajtja gjatë ciklit të jetës.....	28
6.3 Përdorimi nga palët e treta	28
7. Rregullat e pagesës	29
7.1 Natyra e pagesave	29
7.2 Mekanizmat e pagesës të bazuar në disponueshmëri	29
8. Ndryshimet e projektit.....	41
8.1 Panoramë e përgjithshme	41
8.2 Ndryshimet që kërkohen nga autoriteti publik.....	41
8.3 Ndryshimet që propozohen nga partneri privat.....	42
9. Trajtimi i ngjarjeve të paparashikuara.....	43
9.1 Historik.....	43
9.2 Rastet e kompensimit.....	43
9.3 Rastet e ndihmës (rastet e vonesës)	53
9.4 Rastet e forcës madhore	55
10. Ndryshimet ligjore	58
11. Kërkesat e sigurimeve.....	60
12. Garancitë dhe dëmshpërblimet	63
12.1 Garancitë	63
12.2 Dëmshpërblimet.....	63
13. Ndërprerja e parakohshme e kontratës dhe kompensimi për këtë ndërprerje ..	66
13.1 Kompensimi për ndërprerjen e kontratës si pasojë e mosekzekutimit të detyrimeve nga partneri privat.....	66

13.2	Kompensimi për ndërprerjen e kontratës si pasojë e mosekzekutimit të detyrimeve nga autoriteti publik dhe si pasojë e ndërprerjes vullnetare	73
13.3	Kompensimi për ndërprerjen e kontratës si pasojë e forcës madhore të shtrirë në kontratat e Partneritetit Publik Privat	77
13.4	Kompensimi për ndërprerjen e kontratës si pasojë e dhuratave të korruptuara dhe mashtrimit.....	78
14.	Mbarimi i kontratës së Partneritetit Publik Privat.....	80
15.	Çështjet e financimit	83
15.1	Pjesëmarrja e autoritetit publik në financim	83
15.2	Risku i normës së interesit	87
15.3	Risku i kursit të këmbimit.....	88
16.	Të drejtat e ndërhyrjes	90
16.1	Panoramë e përgjithshme	90
16.2	Të drejtat e ndërhyrjes së autoritetit publik	90
16.3	Të drejtat e ndërhyrjes së huadhënësit	91
17.	Influenca e qeverisë	95
17.1	Panoramë e përgjithshme	95
17.2	Influenca përmes kontratës së Partneritetit Publik Privat	95
17.3	Pjesëmarrja në drejtimin/funksionimin e partnerit privat.....	97
18.	Dispozita të ndryshme	99
18.1	Panoramë e përgjithshme	99
18.2	Procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve	99
18.3	Dispozitat e konfidencialitetit dhe kërkesat e lirisë së informacionit	99
18.4	Kufizimet e transferimit të kontratës	101
18.5	Respektimi i ligjeve	102
	Fjalor i termave dhe frazave kryesore.....	103

Shkurtime

BE	Bashkimi Evropian
FB&H	Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës
IRJM	Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë
KHN	Kantoni Hercegovina- Neretva
PPP	Partneriteti Publik Privat
RS	Republika Serbe
SPV	Subjekt për qëllime të veçanta
KIBP	Kuadri i Investimeve të Ballkanit Perëndimor

Historik

Ky udhëzues është përgatitur nga Qendra Evropiane e Ekspertizës së Partneritetit Publik Privat (QEEP) e Bankës Evropiane të Investimeve, si pjesë e mandatit të saj nga Kuadri i Investimeve të Ballkanit Perëndimor (KIBP) *për Rritjen e kapaciteteve të sektorit publik për të ndërmarrë Partneritetet Publike Private në Ballkani Perëndimor* (Shqipëria, Bosnje Hercegovina, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Kosova*, Mali i Zi dhe Serbia).

Ky udhëzues që ka të bëjë me dispozitat kryesore të një kontrate të Partneritetit Publik Privat të bazuar në disponueshmëri i përket një serie dokumentesh udhëzuese të Qendrës Evropiane të Ekspertizës së Partneritetit Publik Privat që synojnë të rrisin kapacitetet e qeverive të Ballkanit Perëndimor (Rajonit) për të përgatitur dhe prokuruar Partneritetet Publike Private (Figura 1).

Së bashku me këtë udhëzues janë hartuar udhëzime shtesë si pjesë e detyrës së Kuadrit të Investimeve të Ballkanit Perëndimor dhe Qendrës Evropiane të Ekspertizës së Partneritetit Publik Privat, që janë më konkretisht:

- **Udhëzuesi për vlerësimin cilësor dhe sasior të vlerës së parasë në Partneritetet Publike Private**

Ky dokument përbëhet nga tre pjesë. Pjesa 1 jep hyrjen në vlerën e parasë me një përmbledhje të objektivave kryesore të vlerësimit të vlerës së parasë. Pjesa 2 përqendrohet në vlerësimin cilësor të vlerës së parasë, duke ilustruar metodat e bazuara në prova për ekzaminimin e përshtatshmërisë së kuadrit të PPP-ve në lidhje me karakteristikat e dhëna të projektit. Pjesa 3 paraqet vlerësimin sasior të vlerës së parasë, duke dhënë udhëzime për metodat sasiore ndaj vlerësimit krahasues të vlerës së parasë, përfshirë përdorimin e Krahasuesit të sektorit publik (KSP).

- **Udhëzuesi për përgatitjen dhe prokurimin e një projekti të Partneritetit Publik Privat**

Ky dokument paraqet praktika të mira të tregut evropian të Partneriteteve Publike Private që janë të rëndësishme për zyrtarët publik të rajonit të Ballkanit Perëndimor të cilët janë përgjegjës për fillimin dhe zbatimin e projekteve të Partneritetit Publik Privat. Ai jep kuadrin e marrjes së shumë vendimeve që kërkohen nga autoriteti publik kur përgatit dhe prokuron një projekt të Partneritetit Publik Privat.

- **Manuali i prokurimit të Partneritetit Publik Privat**


Ky dokument përshkruan në mënyrë më të detajuar hapat që ndiqen normalisht gjatë fazës së prokurimit dhe, veçanërisht, tiparet që zakonisht përfshihen në dokumentin e informacionit të para-kualifikimit dhe në dokumentin e ftesës së tenderit nga autoriteti publik.

Figura 1 tregon zbatueshmërinë e dokumenteve të ndryshme udhëzuese që janë përgatitur sipas përcaktimit të Kuadrit të Investimeve të Ballkanit Perëndimor dhe

* Ky përcaktim nuk cenon qëndrimet ndaj statusit dhe është në përputhje me Rezolutën 1244/99 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe Opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

Qendrës Evropiane të Ekspertizës së Partneritetit Publik Privat për secilën nga fazat e një cikli të projektit të Partneritetit Publik Privat.

Figura 1 – Dokumente udhëzuese të Kuadrit të Investimeve të Ballkanit Perëndimor dhe Qendrës Evropiane të Ekspertizës së Partneritetit Publik Privat që lehtësojnë zbatimin e Partneritetit Publik Privat



1. Hyrje

Partneriteti Publik Privat (*PPP-ja*) është, me fjalë të thjeshta, një marrëveshje midis një organi publik dhe një partneri privat për të ofruar infrastrukturën publike në bazë të një kontrate shërbimi afatgjatë.

Pjesëmarrësit kryesorë në projektin e Partneritetit Publik Privat janë:


- a) Organi publik (*autoriteti publik*) që prokuron projektin;
- b) Partneri privat (*partneri privat*), zakonisht një shoqëri për qëllime të veçanta e krijuar vetëm me qëllimin e realizimit të projektit;
- c) *Huadhënësit* që sigurojnë financimin e projektit të partnerit privat sipas një marrëveshje huadhënie;
- d) *Sponsorizuesit* (d.m.th., pronarët e partnerit privat) që ofrojnë mbështetje financiare dhe mbështetje të tjera për partnerin privat sipas një marrëveshje mbështetje sponsorizimi (zakonisht në formën e një kapitali dhe investimeve të borxhit të varur); dhe
- e) *Kontraktorët* e projektit (p.sh., një kontraktor ndërtimi dhe një kontraktor për menaxhimin e objekteve) që lidhin marrëveshje për t'i siguruar punë dhe shërbime partnerit privat. Kontraktorët kryesorë të projektit të partnerit privat zakonisht punësojnë nënkontraktorë. Herë pas here kontraktorët kryesorë të projektit janë bashkëpunëtorë të partnerit privat. Huadhënësit zakonisht kërkojnë marrëveshje kontraktuale të drejtpërdrejta me kontraktorët kryesorë të projektit për t'iu bërë të mundur atyre që të *ndërhyjnë* në projekt dhe të zëvendësojnë partnerin privat nëse është e nevojshme.

Parimi kryesor i Partneritetit Publik Privat është që risqet që lidhen me projektin t'i alokohen palës që është më e afta për t'i menaxhuar ato. Risqet u alokohen palëve të ndryshme të përfshira në një Partneritet Publik Privat përmes kontratave të ndryshme dhe dokumenteve të tjera të projektit. Alokimi i përshtatshëm i riskut është një parakusht që projekti të jetë *i financueshëm*.

Dokumenti kryesor në një Partneritet Publik Privat është kontrata midis autoritetit publik dhe partnerit privat (kontrata e Partneritetit Publik Privat, që herë pas here quhet edhe marrëveshja e projektit). Në Figurën 2 më poshtë është ilustruar një strukturë tipike e projektit të Partneritetit Publik Privat.

Si kompensim për partnerin privat që ofron një nivel të veçantë shërbimi në lidhje me infrastrukturën publike, autoriteti publik ose i bën partnerit privat pagesa të bazuara në performancë (p.sh., për vënien e një rruge lirisht në dispozicion për përdorim të sigurt), ose e lejon partnerin privat të nxjerrë të ardhura nga ofrimi i shërbimit (p.sh., duke i vendosur tarifa përdoruesve të rrugës).

Figura 2 – Struktura tipike e një projekti të Partneritetit Publik Privat



Sipas kontratës së Partneritetit Publik Privat të bazuar në disponueshmëri, autoriteti publik i bën partnerit privat pagesa periodike që janë të lidhura me infrastrukturën që vihet në dispozicion për përdorim dhe shërbimet e përcaktuara që realizohen (*pagesa e disponueshmërisë*). Në shumicën e kontratave të këtij lloji, pagesa e parë e disponueshmërisë do t'i bëhet partnerit privat vetëm pasi të ketë përfunduar faza e ndërtimit dhe mund të realizohen shërbimet.

Meqenëse çdo kontratë e Partneritetit Publik Privat e bazuar në disponueshmëri është përshtatur me natyrën e projektit dhe juridiksionin përkatës të vendit pritës, shumica e kontratave të këtij lloji ndajnë shumë karakteristika të përbashkëta. Kjo do të thotë që dispozitat kryesore që rregullojnë kontratën e Partneritetit Publik Privat janë përgjithësisht të njëjta në çdo sektor. Këto karakteristika zakonisht zbatohen për njëren ose të dy fazat kryesore të projektit, konkretisht *fazën e ndërtimit* dhe *fazën e funksionimit*.

Dispozitat thelbësore të kontratës tipike të Partneritetit Publik Privat të bazuar në disponueshmëri do të përfshijnë sa më poshtë vijon:

Faza e ndërtimit

- Detyrimi për partnerin privat që të ndërtojë (ose rinovojë) infrastrukturën publike me standardet e përcaktuara sipas *specifikimit të bazuar në produkt*,¹
- Detyrimi për të ndërtuar infrastrukturën brenda një date të caktuar, duke iu nënshtruar rregullimeve për ngjarjet që janë jashtë kontrollit të secilës palë (*ngjarjet e paparashikuara*);

¹ Specifikimi i bazuar në produkt tregon rezultatet që do të arrijë një projekt (p.sh. lloji dhe vëllimi i trafikut që duhet të përballojë një rrugë). Specifikimi i bazuar në burime detajon saktësisht se si duhet të ndërtohet një projekt.

- c) Dëmet e likuiduara, penalizimet kontraktuale ose dispozitat e ndërprerjes së kontratës si mjete ligjore për vonesat që lidhen me përfundimin e infrastrukturës;
- d) E drejta e autoriteti publik për të ndryshuar kërkesat e specifikimeve; dhe
- e) Detyrimi i autoritetit publik për të ushtruar kompetenca ligjore (p.sh., për të siguruar tokën e kërkuar).

Faza funksionale

- a) Detyrimi i partnerit privat për të siguruar një nivel specifik shërbimi ose disponueshmërie të infrastrukturës;
- b) E drejta e autoritetit publik për të kryer punë shtesë;
- c) Mekanizmi i pagesës;
- d) Transferimi i përgjegjësisë për kthimin e infrastrukturës përsëri tek autoriteti publik pas mbarimit të kontratës së Partneritetit Publik Privat; dhe
- e) Detyrimi i partnerit privat për ta kthyer infrastrukturën pas mbarimit të kontratës së Partneritetit Publik Privat në atë gjendje që plotëson standardet minimale të përcaktuara në kontratë.

Të dy fazat, ajo e ndërtimit dhe e funksionimit

- a) Kufizimet për refinancimin e projektit dhe/ose dispozitat që partneri privat të ndajë përfitimet e refinancimit me autoritetin publik;
- b) Alokimi i riskut të ngjarjeve të parashikuara që janë jashtë kontrollit të palëve; dhe
- c) Të drejtat e ndërprerjes së parakohshme të kontratës dhe pagesat që shoqërojnë kompensimin kësaj ndërprerje.

1.1 Qëllimi dhe struktura e këtij udhëzuesi

Ky dokument paraqet një udhëzues të përgjithshëm për dispozitat kryesore dhe termat kryesore të miratuara shpesh për të menaxhuar elementët kryesorë të kontratës së Partneritetit Publik Privat të bazuar në disponueshmëri. Këto dispozita, të cilat nuk janë specifike për një sektor të veçantë, shihen në kontekstin e tregut të PPP-ve në Ballkanin Perëndimor. Udhëzimet tregojnë, në rastet kur është e zbatueshme, qasje specifike ndaj atyre elementeve sipas ligjeve të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Për rastet kur ligji vendor nuk rregullon një aspekt të caktuar të kontratës së Partneritetit Publik Privat, ky dokument ofron një pasqyrë të praktikave të mira evropiane të Partneritetit Publik Privat për këtë lloj kontrate. Në mungesë të akteve ligjore dhe nënligjore vendore për një çështje të veçantë, referenca ndaj zgjidhjeve që përdoren shpesh në praktikën evropiane të Partneritetit Publik Privat mund të shërbejë si një pikënisje e mirë dhe kuadër model për autoritetet publike në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Seksionet fillestare japin një përmbledhje të kuadrit legjislativ të Partneritetit Publik Privat në vendet e Ballkanit Perëndimor si dhe strukturën tipike e përmbajtjen e kontratës së Partneritetit Publik Privat të bazuar në disponueshmëri.

Seksionet vijuese merren me secilën nga dispozitat kryesore të kontratës së Partneritetit Publik Privat të bazuar në disponueshmëri. Në secilin seksion jepet një shpjegim i çështjes themelore dhe dispozitës bazuar në praktikën e mira nga tregjet e BE-së. *Pjesët me ngjyra* në secilin Seksion përshkruajnë se si është përfshirë secila prej çështjeve në legjislacionin aktual në vendet e Ballkanit Perëndimor. Për të ndihmuar më tej të kuptuarit, disa nga termat dhe konceptet që përdoren shpesh në një kontratë të Partneritetit Publik Privat paraqiten *duke i theksuar me germa në italikë*.

Mirënjohje

Ky dokument është përgatitur me mbështetjen e Allen & Overy LLP, në bashkëpunim me Karanovic & Nikolic për çështjet e së drejtës së Bosnjës, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë, dhe Boga & Associates për çështjet e së drejtës së shqiptare dhe kosovare.

2. Kuadri ligjor i PPP-ve në vendet e Ballkanit Perëndimor

Shumica e vendeve të Ballkanit Perëndimor kanë tashmë legjislacionin e tyre specifik për PPP-në dhe ligje të tjera të lidhura. Ligjet kryesore të Partneritetit Publik Privat përshkruhen shkurtimisht më poshtë.

Shqipëria

Pjesa kryesore e legjislacionit që rregullon Partneritetet Publike Private në Republikën e Shqipërisë është Ligji nr. 125/2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat (*Ligji për koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat*).

Bosnja dhe Hercegovina

Bosnja dhe Hercegovina përbëhet nga dy entitete, Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës (*FB&H*) dhe Republika Serbe (*RS*), dhe Qarku i Brçkos si një njësi administrative autonome. Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës është e ndarë në dhjetë kantone, ku secili prej tyre shpesh ka legjislacionin e vet.

Kjo përbërje komplekse kushtetuese reflektohet në legjislacionin e Partneritetit Publik Privat, i cili është miratuar në nivele të ndryshme. Më konkretisht, në Republikës Serbe (*RS*), zbatohet ligji i Republikës Serbe për Partneritetin Publik Privat.² Në Federatën e Bosnjës dhe Hercegovinës, nuk ka ligj për Partneritetet Publike Private në nivelin e entitetit të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës.³ Nëntë nga dhjetë kantonet kanë ligjet e tyre për PPP-në që rregullojnë këtë çështje. Ligjet e ndryshme të Partneritetit Publik Privat në nivel kantonit janë të ngjashme. Ky dokument i referohet si shembull Ligjit për Kantonin e Hercegovinë-Neretvas (*KHN*) për Partneritetin Publik Privat.⁴

Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë (IRJM)

Krijimi dhe zbatimi i PPP-ve në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë (*IRJM*) rregullohet në përgjithësi me Ligjin e Maqedonisë për Partneritetet Publike Private.⁵ Edhe ligjet specifike sektoriale (p.sh., ligjet vendore që rregullojnë ujin, mbetjet ose shërbimet bashkiake) mund të zbatohen gjithashtu për Partneritetet Publike Private. E drejta e përgjithshme e kontratave zbatohet për kontratat e Partneritetit Publik Privat, ndërkohë që objekti i gjerë i dispozitave të së drejtës publike (p.sh. tatimet, rregullimi i borxhit publik) vlen si për kontratat e Partneritetit Publik Privat ashtu edhe për projektet në përgjithësi. Marrëdhëniet midis kontratave të Partneritetit Publik Privat dhe kontratave administrative të rregulluara nga e drejta e përgjithshme e procedurës administrative duhet të sqarohen ende në ligj.

Kosova*

² Ligji i Republikës Serbe për Partneritetin Publik Privat (Gazeta Zyrtare e Republikës Serbe, nr. 59/09 dhe 63/11, Ligji i Republikës Serbe për Partneritetin Publik Privat).

³ Gjatë viteve të fundit, diskutimet kanë vazhduar në lidhje me mundësinë e miratimit të një ligji për Partneritetin Publik Privat në nivelin e Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës. Megjithatë, aktualisht, nuk ka ndonjë aktivitet që tregon se ligji për Partneritetin Publik Privat në nivelin e Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës mund të miratohet në të ardhmen e afërt.

⁴ Ligji i Kantonit të Hercegovinë-Neretvas për Partneritetin Publik Privat (Gazeta Zyrtare e Hercegovinë-Neretvas, nr. 2/13, Ligji i Kantonit të Hercegovina-Neretvas për Partneritetin Publik Privat).

⁵ Ligji për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat, botuar në Fletoren Zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr. 6/2012, i ndryshuar më pas (Ligji i Maqedonisë për Partneritetin Publik Privat).

Pjesa kryesore e legjislacionit që rregullon Partneritetet Publike Private në Kosovë* është Ligji nr. 04 / L-045 "Për partneritetet publike private (Ligji i PPP-ve).

Mali i Zi

Legjislacioni për PPP-në në Mal të Zi është në fazat e para të zhvillimit. Rregullat në lidhje me Partneritetet Publike Private janë të përhapura në disa ligje, shpeshherë duke krijuar konflikte të mundshme ose duke lënë shumë hapësirë për interpretim. Për këtë arsye, është planifikuar të shqyrtohet hartimi i një projektligji për PPP-në nga Parlamenti i Mali i Zi në vitin 2018.

Serbia

Akti kryesor legjislativ që rregullon Partneritetet Publike Private dhe koncesionet në Serbi është Ligji serb për Partneritetet Publike Private.⁶ Ai është një pjesë relativisht e re e legjislacionit. Partneritetet Publike Private janë futur në Serbi vetëm kohët e fundit, prandaj ka pak praktikë të tregut lidhur me interpretimin e Ligjit të Serbisë për Partneritetet Publike Private dhe ligjeve me të cilat ai ndërvepron (siç janë ligjet që rregullojnë borxhin publik, shërbimet bashkiake, buxhetin dhe sistemin buxhetor) në varësi të objektit të projektit. Ligjet që rregullojnë çështje që lidhen me Partneritetet Publike Private (në nivel sektori) mund të mos jenë në përputhje me njëri-tjetrin.

⁶ Ligji për Partneritetet Publike Private dhe koncesionet ("Fletorja Zyrtare e Republikës së Serbisë" Nr. 88/2011, 15/2016 dhe 104/2016; Ligji i Serbisë për Partneritetet Publike Private).

3. Kontrata e Partneritetit Publik Privat

Kontrata e Partneritetit Publik Privat është dokumenti që përcakton marrëdhëniet midis autoritetit publik dhe partnerit privat dhe detyrimet e tyre ndaj njëri-tjetrit. Ajo nënshkruhet në fund të fazës së prokurimit (d.m.th., në momentin që zakonisht njihet si lidhja e kontratës).

Përgatitja dhe nxjerrja e një projekti të plotë të kontratës së Partneritetit Publik Privat së bashku me dokumentet e ftesës për ofertë është një praktikë e mirë. Kushtet e kontratës diskutohen më pas gjatë fazës së dialogut të procesit të tenderit ndërkohë që projekti përfundimtar i kontratës nxirret kur kërkesa bëhet për ofertat përfundimtare. (Shih *Udhëzuesin për procesin e prokurimit të Partneritetit Publik Privat: Partneritetet Publike Private në Ballkanin Perëndimor, Qendra Evropiane e Ekspertizës së Partneritetit Publik Privat* (2018).

3.1 Panoramë e përgjithshme e përmbajtjes së kontratës së Partneritetit Publik Privat

Kontrata e Partneritetit Publik Privat do të mbulojë, të paktën, temat e mëposhtme:

- Alokimin e riskut (kjo zakonisht arrihet përmes përcaktimit të ngjarjeve që i japin palës private të drejtën e një ndihme dhe/ose kompensimi);
- Kërkesat e autoritetit publik për projektin, të përcaktuara nga standardet dhe objektivat e performancës së ndërtimit dhe të shërbimit. Këto duhet të jenë objektive dhe të matshme;
- Procedurën për ndryshimet e lejuara të kërkesave të autoritetit publik, dhe objektin dhe natyrën e ndryshimeve të lejuara;
- Mekanizmin e pagesës dhe procesin për të bërë rregullime në pagesa si përgjigje ndaj situatave të ndryshme emergjente;
- Zbritjet që rrjedhin nga performance (dhe ndoshta edhe shpërblimet) që kanë pasoja financiare ose sjellin njoftime paralajmëruese (duke çuar përfundimisht në ndërprerjen e kontratës së Partneritetit Publik Privat);
- Garancitë e sigurisë dhe të realizimit të kontratës;
- Sigurimet e projektit;
- Afati i kontratës së Partneritetit Publik Privat;
- Kushtet e ndërprerjes së parakohshme të kontratës (të kategorizuara sipas palës dhe llojit të ngjarjes) dhe kompensimin që paguhet për ndërprerjen e kontratës (për secilin lloj);
- Të drejtat e ndërhyrjes, si për huadhënësit ashtu edhe për autoritetin publik;
- Përkufizimin dhe ndikimin e forcës madhore dhe ndryshimet në ligj; dhe
- Procedurën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.

Një nga qëllimet kryesore të kontratës së Partneritetit Publik Privat është të identifikojë dhe alokojë risqet që lidhen me realizimin e infrastrukturës dhe të shërbimeve. Kontrata standarde do të përfaqësojë një pozicion të zakonshëm të riskut që është zhvilluar dhe dakordësuar nga autoritetet publike në vendin përkatës. Tabela 1 më

poshtë tregon një matricë tipike të alokimit të riskut për një Partnerit Publik Privat të bazuar në disponueshmëri.

Tabela 1 – Matricë tipike e shpërndarjes së riskut të një PPP-je të bazuar në disponueshmëri

Kategoria e riskut	Përmbledhje përshkuese	Publik	Privat	E ndarë
Toka/trualli	Blerja dhe sigurimi i aksesit falas	✓		
Lejet	Liçensat dhe lejet ligjore			✓
Arkeologjia	Zbulimet; ndërprerjet e punës, vonesat dhe kostot			✓
Projektimi	Respektimi i standardeve		✓	
Ndërtimi	Përshtatja me qëllimin, përgjegjësia për defektet		✓	
Përfundimi	Në kohë dhe brenda kostos		✓	
Mirëmbajtja	Jeta e projektimit të përfunduar e mbrojtur		✓	
Gjendja e mbetur	Respektimi i standardit minimal		✓	
Performanca	Shërbimet përputhen me standardet		✓	
Inflacioni	Kostot rriten më shumë sesa pritej			✓
Forca madhore	Vonesa/pengesa e zbatimit			✓
Sigurimet	Nuk janë më të disponueshme në treg			✓
Kuadri rregullator/ligji	Ndryshimet që prekin vetëm projektet e Partneritetit Publik Privat	✓		
Mjedisi	Ndotja, kontaminimi i tokës, materialet e rrezikshme			✓
Elementi social/ankimi	Ndërhyrja e palëve të treta			✓
Disponueshmëria	Asetet mund të përdoren lirshëm dhe në mënyrë të sigurt		✓	
Kërkesa	Sasia e kërkesës	✓		
Ndërprerja e parakohshme	Pasojat monetare			✓
Të ardhurat	Të ardhurat nga palët e treta, fitimi i ri-financimit			✓
Teknologjia e re	Prish praktikën e krijuar, kosto	✓		

Klauzolat e kontratës së Partneritetit Publik Privat do të trajtojnë mënyrën e ndarjes dhe menaxhimit të këtyre risqeve ndërmjet palëve. Një numër i këtyre çështjeve janë të zakonshme për të gjitha kontratat e PPP, por rrethanat e veçanta të projektit, sektorit dhe praktikës në juridiksion nënkuptojnë që shumica e kontratave të Partneritetit Publik Privat do të përfshijnë dispozita specifike që do të jenë unike për projektin. Tabela 2 jep një tabelë të përmbajtjes të një forme tipike standarde të kontratës së Partneritetit Publik Privat.

Tabela 2 – Tabela e përmbajtjes së një kontrate tipike Partneritetit Publik Privat të bazuar në disponueshmëri

Emërtimi tipik i klauzolës	Seksioni i këtij udhëzuesi
Përkufizime dhe interpretime	<i>Shih fjalorin kryesor</i>
Fillimi i kontratës dhe afati	<i>[Specifike sipas projektit]</i>
Dokumentet e projektit	<i>Specifike sipas projektit]</i>
Detyrimet e përgjithshme	<i>Seksioni 3</i>
Përfaqësuesit e palëve dhe ndërlidhësit	<i>[Specifike sipas projektit]</i>
Aksesi tek toka dhe tek trualli	<i>Seksioni 4</i>
Autorizimet dhe lejet	<i>Seksioni 4</i>
Detyrimet për projektimin dhe ndërtimin	<i>Seksioni 5</i>
Programi i ndërtimit	<i>Seksioni 5</i>
Kolaudimi	<i>Seksioni 5</i>
Detyrimet e shërbimit	<i>Seksioni 6</i>
Monitorimi i performancës	<i>Seksioni 7</i>
Vonesat, ndihma, rastet e kompensimit	<i>Seksioni 9</i>
Ngjarjet e forcave madhore	<i>Seksioni 9</i>
Ndryshimet në ligj	<i>Seksioni 10</i>
Ndryshimet në kontratë	<i>Seksioni 8</i>
Detyrimet e pagesës	<i>Seksioni 7</i>
TVSH-ja dhe detyrimet tatimore	<i>[Do të zbatohen rregullat nacionale]</i>
Ndërprerja e parakohshme	<i>Seksioni 13</i>
Kompensimi i ndërprerjes së parakohshme të kontratës	<i>Seksioni 13</i>
Pasojat e ndërprerjes së parakohshme të kontratës	<i>Seksioni 13</i>
Të drejtat e ndërhyrjes	<i>Seksioni 16</i>
Mbarimi i kontratës	<i>Seksioni 14</i>
Procedura e kthimit	<i>Seksioni 14</i>
Dëmshpërblimet dhe garancitë	<i>Seksioni 12</i>
Sigurimet	<i>Seksioni 11</i>
Çështjet e financimit	<i>Seksioni 15</i>
Transferimi dhe nënkontraktimi	<i>Seksioni 16</i>
Ndryshimet në pronësinë e partnerit privat	<i>Seksioni 18</i>
Informacioni dhe konfidencialiteti	<i>Seksioni 18</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve	<i>Seksioni 18</i>
Njoftimet	<i>Seksioni 18</i>

Detajet e aktiviteteve specifike zakonisht përfshihen në anekset e kontratës së Partneritetit Publik Privat dhe modelet për këto anekse shpesh janë në dispozicion me dokumente standarde të kontratës. Shembuj përfshijnë anekset që përmbajnë vizatime që përcaktojnë sitin, përshkruajnë procedurat e rishikimit dhe certifikimit dhe përcaktojnë propozimet e partnerit privat që u pranuan në ofertën e tenderit. Tabela 3 jep një listë të anekseve të kontratës së përbashkët që janë bashkangjitur në dokumentin kryesor të kontratës.

Tabela 3 – Shtojcat e kontratës së një projekt kontratë tipike të Partneritetit Publik Privat të bazuar në disponueshmëri

Anekset tipike të një kontrate të Partneritetit Publik Privat

- Përshkrimi i truallit dhe planet;
- Projektimi dhe ndërtimi: kërkesat e autoritetit publik;
- Projektimi dhe ndërtimi: propozimet e partnerit privat (*bosh në projekt kontratë; zëvendësohen nga propozimet e ofertuesit të preferuar*);
- Shërbimet: kërkesat e autoritetit publik;
- Shërbimet: propozimet e partnerit privat (*bosh në projekt kontratë; zëvendësohen nga propozimet e ofertuesit të preferuar*);
- Procedura e shqyrtimit të projektimit;
- Kolaudimi dhe procedurat e përfundimit të ndërtimit;
- Mekanizmi i pagesës;
- Kërkesat e sigurimeve;
- Procedura e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve;
- Kërkesat dhe procedurat e kthimit;
- Llogaritja e kompensimit të ndërprerjes së parakohshme të kontratës;
- Modeli tip i marrëveshjes së drejtpërdrejtë të huamarrësit (*zëvendësohet me marrëveshjet përfundimtare të mbylljes financiare*)

3.2 Kontratat e standardizuara të Partneritetit Publik Privat dhe udhëzimet

Për të shmangur përsëritjen dhe për të menaxhuar pritshmëritë e tregut, një numër vendesh evropiane kanë zhvilluar kontrata standarde të Partneritetit Publik Privat të bazuara në disponueshmëri. Këto dokumente të formës standarde përcaktojnë klauzolat kryesore të kontratës, shumë prej të cilave ndjekin precedentin e krijuar dhe të pranuar në tregjet fqinje evropiane.

Juridiksionet që përdorin kontratat standarde të Partneritetit Publik Privat shpesh ofrojnë udhëzime për kontratat dhe kanë procedura të veçanta, të cilat e duhet t'i ndjekin autoritetet publike nëse dëshirojnë të ndryshojnë tekstin standard.

Praktika e mirë rekomandon gjithashtu që në të gjitha fazat e përgatitjes dhe të prokurimit të projektit të përfshihen këshilltarët juridikë me përvojë për ta ndihmuar autoritetin publik që të përgatisë dhe pranojë kontratën e tij të Partneritetit Publik Privat.

Dokumente udhëzuese për referencë

Tipi Klauzier, Francë (2012) (www.economie.gouv.fr/ppp/clusier-type)



Shabllon i marrëveshjes së projektit të strehimit, Irlandë (2007) (www.ndfa.ie/tenders/standard-procurement-docs-and-ndfa-template-project-agreement)



Model i marrëveshjes DBFMO, Holandë (2012) (www.government.nl/documents/directives/2012/03/28/model-dbfm-agreement-directorate-general-waterways-and-public-works-2012)



Marrëveshje projekti e formës standarde (projektet e qendrës DBFM) (dhe dokumentet e tjera shabllon), Mbretëri e Bashkuar (Skoci), (2018) (www.scottishfuturetrust.org.uk/publications/tag/hub)



Dokumente teknike të modelit të investimeve të ndërsjella, Mbretëri e Bashkuar (Uells), (2018) (www.gov.wales/funding/wales-infrastructure-investment-plan/mutual-investment-model/technical-documents/?lang=en)



Udhëzime për financat private 2 (PF2), Mbretëri e Bashkuar (Angli), (2012): (<https://www.gov.uk/government/publications/private-finance-2-pf2>)



Udhëzuesi i përdoruesit për marrëveshjet standarde të Qendrës së Projekteve (dhe materiale të tjera udhëzuese) Mbretëri e Bashkuar (Skoci), (2018): (www.scottishfuturetrust.org.uk/publications/tag/hub)



Udhëzuesi i përdoruesit për marrëveshje projekti të formës standarde në Mbretërinë e Bashkuar (Uells), (2016) (www.gov.wales/funding/wales-infrastructure-investment-plan/mutual-investment-model/technical-documents/?lang=en)



Udhëzime për dispozitat kontraktuese të PPP-ve, Botimi PPPIRC-i të Bankës Botërore (2017) (<https://ppp.worldbank.org/public-private-partnership/library/guidance-on-ppp-contractual-provisions-2017-edition>)



Alokimi i risqeve në kontratat e partneritetit publik privat - Qendra Globale e Infrastrukturës (2017) (<https://ppp-risk.qihub.org/>)

4. Rregullat e aksesit në truall

4.1 Panoramë e përgjithshme

Kontrata e Partneritetit Publik Privat do të përcaktojë në përgjithësi sipërfaqen e tokës (*truallin*) që do të vihet në dispozicion nga autoriteti publik për të bërë të mundur që partneri privat të zhvillojë projektin. Planet që detajojnë vijat kufizuese të truallit (të cilat mund të ndryshojnë sipas fazave të ndryshme të ndërtimit dhe të funksionimit të projektit) zakonisht përfshihen në një aneks të kontratës së Partneritetit Publik Privat.

Dispozitat e kontratës së Partneritetit Publik Privat për aksesin në truall tregojnë bazën dhe natyrën e të drejtave të aksesit të partnerit privat në truallin e projektit dhe rregullojnë detyrimet e autoritetit publik në lidhje me këtë.

autoriteti publik do të jetë përgjegjës në shumicën e rasteve për identifikimin dhe (nëse është e nevojshme) blerjen e truallit. Në shumicën e rrethanave autoriteti publik do të zotërojë truallin (ose do të ketë akses në të) në datën kur nënshkruhet kontrata.

Në disa raste, për shembull, në projektet e transportit sipërfaqësor në shkallë të gjerë, autoriteti publik mund të planifikojë të blejë tokën e nevojshme ose të drejtat e aksesit pas nënshkrimit të kontratës dhe paralelisht me zhvillimin e projektit të partnerit privat. Kjo mund të ndodhë, për shembull, nëse është e mundur të merren vetëm të drejtat e aksesit në pronën që është në pronësi të palëve të treta (p.sh. mbi linjat hekurudhore) pasi projektimi i projektit të partnerit privat të ketë përparuar mjaft. Megjithatë, çdo vonesë e autoritetit publik në sigurimin e aksesit për partnerit privat truall ka të ngjarë të rezultojë në një *rast kompensimi* (shiko Seksionin 8.2)

Ligjet e Ballkanit Perëndimor zakonisht kërkojnë që çështjet e aksesit në truall të rregullohen në kontratën e Partneritetit Publik Privat.

4.2 Natyra e të drejtave që jepen

Lloji i të drejtave të aksesit që i jepen partnerit privat do të varet nga natyra e projektit dhe masa në të cilën autoriteti publik zotëron tokën përkatëse. Një faktor tjetër ndikues mund të jetë fakti nëse llojet e ndryshme të së drejtës së aksesit kanë apo jo implikime të ndryshme në koston e projektit (p.sh. forma të ndryshme të së drejtës së aksesit mund të kërkojnë tarifa të ndryshme të regjistrimit të tokës ose detyrime tatimore).

Në praktikë, partneri privat do të jetë neutral për sa i përket bazës në të cilën autoriteti publik i jep të drejtat e aksesit. Shqetësimet e partnerit privat do të jenë të lidhura me faktin që të drejtat të jenë të përcaktuar qartë dhe në mënyrë të mjaftueshme për t'i mundësuar atij të përmbushë detyrimet e veta sipas kontratës së Partneritetit Publik Privat dhe se ai ka në dispozicion mjetet e përshtatshme ligjore (p.sh., të drejtën për të kërkuar kompensim) nëse aksesit që autoriteti publik ka ndërmarrë për ta siguruar mohohet ose komprometohet.

4.3 Pronësia

Një çështje e zakonshme sipas ligjeve të juridiksioneve të Ballkanit Perëndimor është se autoriteti publik nuk mund të transferojë pronësinë e truallit tek partneri privat. Si

rrjedhojë, autoriteti publik mban pronësinë e truallit dhe lejon aksesin në një ose disa nga mënyrat e përshkuara më poshtë.

- **Qiraja**; p.sh., në IRJM (për tokën bujqësore në pronësi të shtetit për aktivitete të specifikuar siç janë rezervate peshku, aktivitete sportive dhe rekreative, dhe turizëm rural), Mali të Zi dhe Serbi. Në projektet ku autoriteti publik e merr projektin gjatë fazës së tij të funksionimit (p.sh., një shkollë ose spital), partnerit privat zakonisht i kërkohet t'i kthejë të drejtat e aksesit përsëri tek autoriteti publik (p.sh. përmes një nën-qiraje ose licence);
- **Të drejtat e ndërtimit**; p.sh., në Republikën Serbe, autoriteti publik i jep partnerit të drejtën për të ndërtuar infrastrukturën e projektit sipas kontratës së Partneritetit Publik Privat; dhe
- **Të drejtat e përdorimit**; kjo është një bazë shumë e zakonshme, mbi të cilën i jepet akses partnerit privat në juridiksionet e Ballkanit Perëndimor. Në kontratën e Partneritetit Publik Privat, autoriteti publik thjesht angazhohet t'i sigurojë partnerit privat akses të mjaftueshëm në truall në mënyrë që t'i mundësojë partnerit privat të përmbushë detyrimet e tij sipas kontratës.

Me mbarimin ose ndërprerjen e kontratës së Partneritetit Publik Privat, partneri privat transferon pronësinë e infrastrukturës së ndërtuar në truall tek autoriteti publik.

Legjislacioni në vendet e Ballkanit Perëndimor

Shqipëria

Kontratat e qirasë me një afat që tejkalon nëntë vjet të lidhura si akte noteriale duhet të regjistrohen në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme.⁷ Kontratat e qirasë të lidhura si akte noteriale me një afat që tejkalon një vit por jo më shumë se nëntë vjet mund të regjistrohen në atë regjistër.⁸ Lejet e ndërtimit regjistrohen edhe në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme nga bashkia që lëshon lejet.⁹ Të drejtat e përdorimit të dhëna mbi tokën në pronësi të shtetit regjistrohen gjithashtu në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme.¹⁰

Bosnja dhe Hercegovina

Të drejtat mbi pasuritë e paluajtshme që i janë dhënë partnerit privat për qëllimin e një projekti, të tilla si qiraja afatgjatë, e drejta e përdorimit, e drejta e ndërtimit ose koncesioni duhet të regjistrohen në regjistrin e tokës.

Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë (IRJM)

Qiraja e tokës bujqësore dhe dhënia me qira afatgjatë e tokës ndërtimore¹¹ duhet të regjistrohen në Agjencinë e Kadastrës së Pasurive të Paluajtshme. Përveç

⁷ Neni 51 i Ligjit 33/2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme".

⁸ Neni 51 i Ligjit 33/2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme".

⁹ Neni 46 i Ligjit 33/2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme".

¹⁰ Neni 56 i Ligjit 33/2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme".

¹¹ Neni 32 i Ligjit të Maqedonisë për tokën bujqësore; Neni 29 i Ligjit për tokën ndërtimore, botuar në Fletoren Zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr. 15/2015, i ndryshuar më pas (Ligji i Maqedonisë për tokën ndërtimore), dhe neni

kësaj, qiradhëniet afatshkurtra dhe afatgjata të tokës ndërtimore regjistrohen edhe në Regjistrin e posaçëm të Tokës Ndërtimore të menaxhuar nga komunat, komunat në qytetin e Shkupit dhe Bashkia e Shkupit.¹²

Kosova*

Të drejtat e përdorimit të pronave komunale, publike, sociale dhe shtetërore duhet të regjistrohen në Regjistrin e të Drejtave të Pasurive të Paluajtshme.¹³ Edhe kontratat e qirasë mund të regjistrohen në Regjistrin e të Drejtave të Pasurive të Paluajtshme.

Mali i Zi

Si qiradhëniet ashtu edhe të drejtat e përdorimit të tokës duhet të regjistrohen në regjistrin e posaçëm të tokës.¹⁴

Serbia

E drejta e përdorimit, marrja me qira e tokës ndërtimore me qëllim kryerjen e punimeve të ndërtimit, të drejtat e servitutit, të hipotekës dhe të drejtat e tjera mbi pasuritë e paluajtshme duhet të regjistrohen në regjistrin e tokës.¹⁵

170 i Ligjit për kadastrën e pasurive të paluajtshme, botuar në Fletoren Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 55/2013.

¹² Neni 93 i Ligjit të Maqedonisë për tokën ndërtimore.

¹³ Neni 2, Paragrafi 2 i Ligjit nr. 2002/5 "Për krijimin e regjistrit të të drejtave të pasurive të paluajtshme".

¹⁴ Neni 49 i Ligjit "Për regjistrin e tokës" (Fletorja Zyrtare e Republikës së Malit të Zi" nr. 29/07 dhe "Fletorja Zyrtare e Malit të Zi") nr. 32/11, 40/11, 43/15 dhe 37/17).

¹⁵ Neni 77 i Ligjit të Serbisë "Për regjistrin e tokës" (Fletorja Zyrtare e Republikës së Serbisë, 72/2009, 18/2010, 65/2013 dhe 15/2015).

5. Projektimi dhe ndërtimi

5.1 Panoramë e përgjithshme

Projektimi dhe risku i ndërtimit në projektet e Partneritetit Publik Privat në të gjithë BE-në zakonisht arrihet në mënyrën e mëposhtme:

- a) Partneri privat merr përgjegjësinë për hartimin e projektit dhe ndërton infrastrukturën për një çmim fiks dhe sipas një afati të caktuar. Megjithëse autoriteti publik shpesh do të ndërmarrë aktivitete paraprake projektuese në lidhje me një projekt, partneri privat merr përgjegjësi për përshtatshmërinë e një pune të tillë të projektimit.
- b) Partneri privat pranon që të hartojë dhe ndërtojë infrastrukturën brenda një date të caktuar. Autoritetit publik mund t'i paguhen dëmet e konstatuara në rast të përfundimit me vonesë. Sigurimi i dëmeve të konstatuara (ose i penalizimeve kontraktuale) ndryshon sipas sektorëve dhe projekteve, por zakonisht gjendet vetëm në ato projekte ku autoriteti publik do të pësojë humbje financiare nga një vonesë në vënien në funksionim të projektit. Sidoqoftë, në disa shtete ku e lejon ligji themelor, kontrata e Partneritetit Publik Privat mund të imponojë dëmtime të konstatuara (ose penalizime kontraktuale) edhe kur vonesa nuk shkakton ndonjë humbje të tillë financiare.
- c) Partneri privat merr përgjegjësinë për të siguruar lejet përkatëse (me ndihmën e autoritetit publik për lejet që partneri privat nuk mund t'i marrë në emrin e vet).
- d) Partneri privat merr përgjegjësinë për performancën e të gjithë anëtarëve të zinxhirit të tij të furnizimit.
- e) Çdo miratim që autoriteti publik i bën projektimit të partnerit privat për projektin, nuk e çliron partnerin privat nga përgjegjësia për të garantuar që projektimi përmbush specifikimet dhe testet e kolaudimit.
- f) Pasi të jenë realizuar testet e kolaudimit dhe të ketë filluar faza e funksionimit të projektit, partneri privat vazhdon të mbajë riskun e projektimit të projektit dhe do të pësojë zbritje financiare sipas mekanizmit të pagesës nëse projektimi i projektit shkakton padisponueshmëri ose dështime të performancës.
- g) Kontrata e Partneritetit Publik Privat përcakton një listë shteruese të rrethanave të kufizuara në të cilat partneri privat mund të kërkojë një zgjatje kohore për vonesat dhe/ose kompensimin për kostot e rritura (dhe/ose të ardhurat e humbura) që krijohen gjatë fazës së ndërtimit (Shih Seksionin 5.2 më poshtë në lidhje me risqet e mbajtura ose të ndara, shih gjithashtu Seksionin 9).

5.2 Risqet e mbajtura dhe të ndara

Edhe pse shumica e kontratave të Partneritetit Publik Privat kërkojnë që partneri privat të ndërtojë infrastrukturën për një çmim fiks dhe brenda një date të caktuar, ato shpesh pranojnë se është joreale të pritët që partneri privat të japë llogari për ndikimin e të gjitha risqeve të mundshme në çmimin e tij fiks. Në veçanti, autoriteti publik mund

të mendojë se është joreale (dhe joekonomike) të presë që partneri privat të çmojë risqet materiale, për të cilat ai nuk është në gjendje të kryejë hetimin dhe vlerësimin e vet (ose vlerësimin diagnostikues - *due diligence*) para nënshkrimit të kontratës.

Është e rëndësishme të theksohet se mund të mos jetë e mundur që të transferohen tek partneri privat të gjitha risqet që lidhen me ndërtimin ose të transferohen në një mënyrë që është ekonomike (ose vlerë e parasë) për autoritetin publik. Autoriteti publik mund të vendosë, sipas rrethanave, që të sigurojë njëfarë ndihme për partnerin privat lidhur me pasojat financiare dhe me pasojat që kanë të bëjnë me vonesën e risqeve të caktuara të ndërtimit.

Shkalla në të cilën autoriteti publik e bën këtë ndryshon në mënyrë të konsiderueshme nga sektori në sektor, por risqet e ndërtimit që autoriteti publik shpesh mban ose ndan me partnerin privat përmes kushteve të kontratës së Partneritetit Publik Privat mund të përfshijnë sa më poshtë vijon:

- a) Kushtet e paparashikueshme gjeologjike;
- b) Zbulimet arkeologjike;
- c) Ndotjen e paparashikueshme të mjedisit në truall ose në tokën ngjitur;
- d) Zhvendosjet e paparashikueshme të shërbimeve;
- e) Vonesat e marrjes së lejeve që ndikojnë në rrugën që ka rëndësi kritike për projektin;
- f) Defektet e paparashikueshme të mundshme në infrastrukturën ekzistuese që, pas përfundimit, përfshihen në projekt (nëse kjo gjë është e rëndësishme);
- g) Specie të rrezikuara të paparashikueshme;
- h) Veprimet e protestuesve në lidhje me projektin; dhe
- i) Vonesa në marrjen e miratimit të projektimit nga palët e treta (shpesh subjekte të tjera publike, p.sh., një operator kombëtar hekurudhor ose roja bregdetare për kalimet në ura).

Nëse autoriteti publik mban ose ndan ndonjë prej këtyre risqeve me partnerin privat, atëherë marrëveshja zakonisht shtrihet vetëm për ato risqe për të cilat partneri privat nuk ka qenë në gjendje të ushtrojë kujdes të mjaftueshëm për të matur (dhe vlerësuar) riskun përkatës (siç theksohet lart).

Shkalla në të cilën autoriteti publik mban ose ndan risqe të caktuara në ndërtim do të varet nga sasia dhe cilësia e informacionit që ai mund të vërë në dispozicion të ofertuesve (p.sh. rilevimet gjeoteknike, të dhënat e shpimeve, hartat e shërbimeve dhe të dhënat historike) ose që ofertuesve u jepet mundësia të bëjnë konstatimet e veta.

Para fazës së tenderit të projektit, autoriteti publik duhet të përcaktojë nëse është në interes të publikut apo jo që të sigurojë informacion për ofertuesit në mënyrë që t'u mundësojë atyre që të çmojnë risqe të caktuara, ose, në mënyrë alternative, të bëjnë marrëveshje që ofertuesit të kryejnë vlerësimin e tyre diagnostikues.

Për më shumë informacion mbi rrethanat në të cilat autoriteti publik mund të kompensojë partnerin privat, shih Seksionin 9 (Trajtimi i rasteve të paparashikuara).

5.3 Kolaudimi i ndërtimeve

Në kontekstin e një PPP-je të bazuar në disponueshmëri, qëllimi i kolaudimit është të përcaktohet nëse infrastruktura përkatëse është e aftë të përdoret dhe funksionojë siç kërkohet nga kontrata (d.m.th., e *disponueshme*). Nëse prova e kolaudimit kalohet, atëherë partneri privat do të fillojë të nxjerrë të ardhura në formën e *pagesës së disponueshmërisë* që merr nga autoriteti publik (shih gjithashtu edhe Seksionin 7.2).

Kolaudimi duhet të jetë objektiv dhe të pasqyrojë pasojat e rëndësishme financiare me të cilat përballet partneri privat nëse nuk realizohet kolaudimi. Në përgjithësi, ekzistojnë dy qasje për mënyrën e kryerjes së kolaudimit:

- a) autoriteti publik përcakton nëse kolaudimi është realizuar apo jo, ndërkohë që partneri privat ka mundësinë që të kundërshtojë mendimin e autoritetit publik; ose
- b) Përdorimi i një pale të tretë të pavarur (p.sh., një inxhinier profesionist) për të bërë kolaudimin, ku secila palë të ketë mundësinë të marrë pjesë në provat e kolaudimit dhe të paraqesë parashtrime tek pala e pavarur që realizon provat.

Një pikë kyçe që duhet theksuar është shkalla në të cilën realizimi i provave të kolaudimit e çliron partnerin privat nga risku i vazhdueshëm i projektimit (d.m.th., risku i ndonjë mosrespektimi të kërkesave të projektimit të kontratës gjatë fazës së funksionimit të projektit).

Pavarësisht nëse partneri privat i kalon provat e kolaudimit apo jo, ai ka përgjegjësi të vazhdueshme për të respektuar standardet e performancës të përcaktuara në kontratën e Partneritetit Publik Privat. Me fjalë të tjera, partneri privat vazhdon të mbajë riskun e efikasitetit të projektimit të infrastrukturës gjatë kohëzgjatjes së kontratës së Partneritetit Publik Privat.

Legjislacioni në vendet e Ballkanit Perëndimor

Juridiksionet e Ballkanit Perëndimor në përgjithësi lejojnë që palët të bien dakord mbi mekanizmin e kolaudimit, siç përmbledhet më poshtë.

Shqipëria

Ligji për koncesionet dhe PPP-në nuk shprehet për metodologjinë e kolaudimit. Palët do të bien dakord në kontratën e Partneritetit Publik Privat lidhur me provat që përdoren.

Bosnja dhe Hercegovina - Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës (Kantoni i Hercegovina-Neretvas)

Ligji i Kantonit të Hercegovina-Neretvas për Partneritetin Publik Privat dhe Ligji i Kantonit të Hercegovina-Neretvas ¹⁶ për koncesionet nuk përmbajnë dispozita që rregullojnë kolaudimin. Palët janë të lira t'i zgjedhin provat e kolaudimit, përveçse nëse parashikohet ndryshe nga rregulloret sektoriale për një lloj të veçantë objekti.

¹⁶ Ligji për Koncesionet e Kantonit të Hercegovinës-Neretva (Fletorja Zyrtare e Kantonit të Hercegovinës-Neretva, Nr. 1/2013 dhe 7/2016, Ligji i HNC-së për Koncesionet).

Bosnja dhe Hercegovina - Republika Serbe

Ligjet në fuqi që rregullojnë Partneritetet Publike Private në Republikën Serbe nuk përmbajnë dispozita në lidhje me kolaudimin e ndërtimit. Palët mund t'i zgjedhin lirisht provat e kolaudimit, përveçse nëse parashikohet ndryshe nga rregulloret sektoriale për një lloj të veçantë objekti.

Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë (IRJM)

Në praktikë, metoda e përshkruar Pikën a) të Seksionit 5.3 më lart mund të jetë më e zakonshme, pasi asetet e projektit mund të vihen në funksionim vetëm

- i) Pasi të jetë dhënë një leje funksionimi (p.sh., në rastin e rrugëve shtetërore ose hekurudhave nga Ministria e Transportit dhe e Komunikacionit), ose
- ii) Pasi të jetë përgatitur një raport teknik nga një inxhinier mbikëqyrës (në rastin e shkollave dhe rrugëve vendore).¹⁷

Palët e treta shpesh angazhohen në mbikëqyrjen dhe kryerjen provave të kolaudimit në projekte më të mëdha. Provat e kolaudimit të palëve të treta mund të shërbejnë vetëm si konfirmim që tregojnë se një fazë e caktuar ose i gjithë projekti ka përfunduar, jo si konfirmim për vënien në punë të asetit. Prandaj, në varësi të llojit të projektit, ekziston hapësira për të përdorur metodën e përshkruar Pikën b) më lart.

Kosova*

Ligji për PPP-në nuk rregullon metodologjinë e provave të kolaudimit. Palët do të bien dakord në kontratën e Partneritetit Publik Privat për provat që përdoren.

Mali i Zi

Asnjë nga metodat e mësipërme nuk mbizotëron në Mal të Zi, pasi kjo varet në mënyrë strikte nga kushtet e secilës kontratë individuale.

Serbia

Metoda varet nga kushtet e secilës kontratë individuale të Partneritetit Publik Privat. Sipas Ligjit të Serbisë për PPP-në,¹⁸ kontrata e Partneritetit Publik Privat duhet të rregullojë të gjitha procedurat përkatëse të përdorura nga autoriteti publik për të shqyrtuar dhe aprovuar projektet.

¹⁷ Neni 87 i Ligjit për ndërtimin, botuar në Fletoren Zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr. 130/2009, i ndryshuar.

¹⁸ Neni 46 i Ligjit të Serbisë për Partneritetet Publike Private.

6. Funksionimi dhe mirëmbajtja

6.1 Panoramë e përgjithshme

Metoda e përdorur për funksionimin dhe mirëmbajtjen mund të jetë shumë e ndryshme nga sektori në sektor dhe nga projekti në projekt. Mirëmbajtja e vazhdueshme e infrastrukturës përkatëse qëndron në thelb të kontratës së Partneritetit Publik Privat, por, për shumë projekte, partnerit privat i kërkohet edhe të ofrojë shërbime shtesë.

Disa shembuj nga e gjithë BE-ja që ilustronë metodat e ndryshme të funksionimit dhe mirëmbajtjes përfshijnë sa më poshtë vijon:

- a) Në disa Partneritete Publike Private që kanë të bëjnë me burgjet, partnerit privat i kërkohet që të operojë burgun (përfshirë ofrimin e shërbimeve të ruajtjes), ndërsa në raste të tjera përgjegjësitë e partnerit privat kufizohen vetëm në mirëmbajtjen e ndërtesave të burgut;
- b) Në disa Partneritete Publike Private që kanë të bëjnë me rrugët, partnerit privat i kërkohet të sigurojë *shërbimet e reagimit të parë* (p.sh. shërbimet e pastrimit të borës/mbetjeve dhe të rimorkimit), ndërsa në disa raste të tjera ofrimi i këtyre shërbimeve mbahet nga autoriteti publik;
- c) Disa Partneritete Publike Private që kanë të bëjnë me rregullimin e infrastrukturës sociale (p.sh. shkolla dhe spitale) kërkojnë që partneri privat të sigurojë shërbime katering, pastrimi, sigurie dhe/ose lavanderie (shpesh të quajtura si *shërbime të buta*), ndërsa në disa raste të tjera kërkohet që partneri privat të sigurojë vetëm mirëmbajtjen (që shpesh njihen si *shërbimet e forta*);
- d) Megjithëse përgjegjësitë e partnerit privat në shumë projekte të Partneritetit Publik Privat janë të kufizuara tek mirëmbajtja, autoriteti publik mund të mbajë gjithashtu edhe disa aspekte të përgjegjësive të mirëmbajtjes (p.sh., në rastin e një projekti shkollor, autoriteti publik mund të mbajë përgjegjësinë e dekorimit të brendshëm, siç është pikturimi); dhe
- e) Disa kontrata të Partneritetit Publik Privat kërkojnë, veçanërisht në kontekstin e projekteve të akomodimit, që partneri privat të jetë përgjegjës për të siguruar dhe mirëmbajtur shërbimet e objekteve (p.sh. furnizimin me ujë ose furnizimin me energji elektrike), ndërsa në kontratat e tjera të Partneritetit Publik Privat, autoriteti publik merr përgjegjësinë për këtë. (Shih Seksionin 7 për diskutimin lidhur me rregullat e pagesave dhe se si përshtaten pagesat kryesore të partnerit privat për të reflektuar luhatjet e kostove të shërbimeve).

Legjislacioni në vendet e Ballkanit Perëndimor

Juridiksionet e Ballkanit Perëndimor nuk kanë shumë praktikë apo rregulla të përcaktuara në lidhje me marrëveshjet e funksionimit dhe të mirëmbajtjes, gjë e cila paraqitet në mënyrë të përmbledhur më poshtë.

Shqipëria

Sipas Ligjit për koncesionet dhe PPP-në, partnerit privat mund t'i kërkohej ta përdorë asetin, ta mirëmbajë asetin pa e përdorur atë ose ta përdorë dhe ta mirëmbajë asetin.¹⁹

Bosnja dhe Hercegovina - Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës (Kantoni i Hercegovina-Neretvas)

Ligjet në fuqi që rregullojnë Partneritetet Publike Private në Kantonin e Hercegovina-Neretvas nuk njohin mënyra të ndryshme në lidhje me funksionimin dhe mirëmbajtjen e ofruar nga partneri privat në sektorë të ndryshëm.

Bosnja dhe Hercegovina - Republika Serbe

Ligjet në fuqi që rregullojnë Partneritetet Publike Private në Republikën Serbe nuk njohin metoda të ndryshme në lidhje me funksionimin dhe mirëmbajtjen e ofruar nga partneri privat në sektorë të ndryshëm.

Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë (IRJM)

Nuk ka shembuj specifikë për tu theksuar.

Kosova*

Sipas Ligjit për PPP-në, partnerit privat mund t'i kërkohej të përdorë asetin, ta mirëmbajë asetin pa e përdorur atë ose ta përdorë dhe ta mirëmbajë asetin.²⁰

Mali i Zi

Duke pasur parasysh fazën fillestare të zhvillimit të kuadrit ligjor, nuk ka shembuj përkatës për këtë pikë.

Serbia

Ligji i Serbisë për PPP-në nuk njeh metoda të ndryshme lidhur me funksionimin dhe mirëmbajtjen e projekteve.

¹⁹ Neni 8 i Ligjit për koncesionet dhe Partneritetet Publike Private.

²⁰ Nenet 1.17, 1.19, 6.2, dhe 7.1 të Ligjit për Partneritetin Publik Privat.

6.2 Mirëmbajtja gjatë ciklit të jetës

Duke pasur parasysh natyrën afatgjatë të projekteve të Partneritetit Publik Privat, partneri privat zakonisht i kërkohet të ndërmarrë një rinovim ose zëvendësim të infrastrukturës gjatë kontratës së Partneritetit Publik Privat. Shembuj lidhur me këtë përfshijnë zëvendësimin e kaldajave në një spital ose shkollë dhe zëvendësimin e sipërfaqes së një rruge ose riveshjen e dyshemesë së një ure.

Zbritjet e përdorura në bazë të mekanizmit të pagesave (*regjimi i zbritjeve*) kanë për qëllim të nxisin partnerin privat që të ruajë infrastrukturën në gjendjen minimale të specifikuar. Kjo duhet të minimizojë riskun që partneri privat të ndalojë investimet e nevojshme për riparimin, zëvendësimin dhe rehabilitimin e asetëve ose, realisht, të shtyjë mirëmbajtjen, gjë e cila që do të çonte në uljen e performancës së pritshme të asetit.

6.3 Përdorimi nga palët e treta

Shpesh ndodh që infrastruktura e projekteve të Partneritetit Publik Privat është në gjendje të nxjerrë të ardhura jashtë ofrimit të shërbimeve në bazë të kontratës së Partneritetit Publik Privat. Shembujt e zakonshëm përfshijnë sa më poshtë vijon:

- a) Lejimi i aksesit të publikut në objektet sportive shkollore në mbrëmje, fundjavë dhe pushime;
- b) Shitja e hapësirës reklamuese;
- c) Sigurimi i aksesit për përdoruesit e autostradës në karburante dhe restorantet në stacionet e shërbimit përgjatë autostradës; dhe
- d) Marrja me qira e hapësirës për tregti me pakicë në spitale, gjykata ose lloje të tjera ndërtesash qeveritare.

Kontratat e Partneritetit Publik Privat përdorin kryesisht një nga qasjet e mëposhtme në lidhje me klauzolat që kanë të bëjnë me nxjerrjen e të ardhurave nga përdorimi i palëve të treta:

- a) Partnerit privat nuk i lejohet të përdorë infrastrukturën e projektit për ndonjë arsye tjetër përveçse për të përmbushur detyrimet e tij sipas kontratës së Partneritetit Publik Privat. Kjo qasje nuk e lejon partnerin privat që të nxjerrë të ardhura shtesë nga infrastruktura e projektit. autoriteti publik vetë mund të zgjedhë të nxjerrë të ardhura nga infrastruktura e projektit (direkt ose indirekt, siç është dhënia e një koncesioni për një palë të tretë) ose mund të vendosë të mos e bëjë fare një gjë të tillë;
- b) Partnerit privat i lejohet të përdorë infrastrukturën e projektit për të nxjerrë të ardhura shtesë, duke iu nënshtruar kufizimeve të caktuara (p.sh., kufizimet kohore dhe kufizimet e llojeve të përdorimit); dhe
- c) Si në Pikën b) më lart, por autoriteti publik ka të drejtë të marrë pjesë në të ardhurat ose fitimet e krijuara nga aktivitete të tilla. Rregullat e ndarjes ndryshojnë nga kontrata në kontratë, por shpesh përfshijnë kërkesën që partneri privat t'i paguajë autoritetit publik një përqindje të çdo të ardhure të krijuar mbi një nivel të përcaktuar.

7. Rregullat e pagesës

7.1 Natyra e pagesave

Kontrata e Partneritetit Publik Privat duhet të përcaktojë strukturën e pagesave dhe dispozitat që rregullojnë bazën e shpërblimit të partnerit privat në bazë të kontratës (*mekanizmi i pagesës*).

Strukturat e pagesave të përdorura në kontratat e Partneritetit Publik Privat mund të jenë komplekse, në varësi të shkallës së projektit dhe natyrës së shërbimeve që do të ofrohen nga partneri privat.

Ato zakonisht klasifikohen në katër kategori të gjera:

- a) Bazuar në kërkesë (d.m.th., pagesat që autoriteti publik i bën partnerit privat lidhen me nivelin e përdorimit të infrastrukturës);
- b) Bazuar në disponueshmërinë (d.m.th., pagesat që autoriteti publik i bën partnerit privat lidhen me infrastrukturën që vihet në dispozicion për përdorim dhe shërbimet që kryhen siç përcaktohet në kontratën e Partneritetit Publik Privat);
- c) Një kombinim i a) dhe b); ose
- d) Secila prej opsioneve të mësipërme, duke shtuar shumat e pagesave të njëpasnjëshme në total që bëhen nga Qeveria gjatë fazave të ndërtimit ose të funksionimit të projektit.

Ky udhëzues përqendrohet vetëm në dispozitat e mekanizmave të pagesave të bazuara në disponueshmërinë, ku autoriteti publik merr riskun e ndryshimit të kërkesës për shërbimet e ofruara në bazë të kontratës së Partneritetit Publik Privat.

7.2 Mekanizmat e pagesës të bazuar në disponueshmëri

7.2.1 Panoramë e përgjithshme

Në një Partneritet Publik Privat të bazuar në disponueshmëri, partneri privat rikuperon kostot e tij të realizimit të projektit (së bashku me një fitim për kapitalin e investuar në projekt) përmes pagesës periodike të disponueshmërisë që merr nga autoriteti publik (që zakonisht paguhet me këste të barabarta mujore ose tremujore). Sidoqoftë, kjo pagesë e disponueshmërisë i nënshtrohet zbritjeve për rastet kur infrastruktura nuk është e disponueshme ose ku shërbimet realizohen dobët nga partneri privat.

Kontrata e Partneritetit Publik Privat mund t'i kërkojë partnerit privat që të sigurojë shërbime që tejkalojnë thjesht mirëmbajtjen e infrastrukturës. Për shembull, në Partneritetin Publik Privat të akomodimit (p.sh., shkolla, spitale dhe burgje), partneri privat është i detyruar herë pas here të sigurojë shërbime katering, pastrimi, sigurie dhe/ose lavanderie.

Për këtë arsye, është gjë e zakonshme që kontrata e Partneritetit Publik Privat të bëjë dallimin midis dy llojeve të zbritjes që mund të bëhen nga pagesa e disponueshmërisë për mosrealizim:

- **Zbritjet e disponueshmërisë ose të padisponueshmërisë:** këto përdoren kur infrastruktura nuk konsiderohet e disponueshme për t'u përdorur nga

publiku ose përdoruesit fundorë (sipas rastit). Përkufizimi i asaj se çfarë do të thotë e *disponueshme* ndryshon nga sektori në sektor. Për shembull, një seksion i korsisë së një rruge konsiderohet *i disponueshëm* vetëm nëse është i hapur për trafik, pa pengesa dhe i sigurt (nëse kjo nuk ndodh për shkak të punës mirëmbajtëse për të cilën është rënë dakord paraprakisht), që në rrethana të tjera mund të konsiderohet si *i padisponueshëm*; dhe

- **Zbritjet e performancës:** këto përdoren kur cilësia dhe efikasiteti i shërbimeve të ofruara nga partneri privat nuk i përmbush standardet e specifikuar në kontratën e Partneritetit Publik Privat.

Detyrimi i autoritetit publik për të filluar pagimin e kësteve mujore ose tremujore të pagesës së disponueshmërisë zakonisht zbatohet pas përfundimit të ndërtimit (d.m.th., pika në të cilën infrastruktura përmbush standardin e kërkuar dhe mund të përdoret për qëllimin e saj të synuar). Provat normalisht do të kryhen për t'i treguar autoritetit publik se këto standarde janë përmbushur (shih Seksionin 5.3).

7.2.2 Regjimi i zbritjeve për padisponueshmërinë/disponueshmërinë

Siç u përmend më lart, autoriteti publik ka të drejtë të bëjë zbritje nga pagesa e disponueshmërisë për ato raste kur infrastruktura është vendosur të mos jetë e *disponueshme* (d.m.th., është e *padisponueshme*). Zakonisht, kontrata e Partneritetit Publik Privat:

- a) Do të japë një përkufizim të disponueshmërisë ose të padisponueshmërisë. Kjo duhet të jetë e aftë të provohet dhe të përcaktohet përmes një seri provash objektive.
- b) Do të deklarojë që disponueshmëria e infrastrukturës duhet të vlerësohet zonë pas zone dhe jo në tërësi (p.sh., segmente dhe/ose korsi të një rruge ose dhoma të veçanta në një shkollë). Pavarësisht kësaj metode të zakonshme, disa kontrata të Partneritetit Publik Privat shprehen se nëse nuk është e disponueshme ndonjë zonë ose grup zonash të veçanta të infrastrukturës, atëherë i gjithë projekti duhet të konsiderohet i padisponueshëm (p.sh., nëse të gjitha tualetet e një shkolle nuk janë të disponueshme, atëherë e tërë shkolla konsiderohet e padisponueshme); dhe
- c) Do të monitorojë disponueshmërinë e elementeve ose fushave të ndryshme të infrastrukturës për periudha të përcaktuara (zakonisht të referuara si seanca, p.sh., ditore, gjysmë-ditore ose edhe me orë për zonat me përparësi, p.sh., sallat e operacionit në një spital) dhe në interval të përcaktuar.

7.2.3 Regjimi i zbritjeve për performancë të dobët

Autoriteti publik ka të drejtë të bëjë zbritje nga pagesa e disponueshmërisë nëse shërbimet e kontraktuara nuk janë realizuar në standardet e kërkuara. Ekzistojnë një numër metodash që përdoren në lidhje me zbritjet e performancës:

- a) Kontrata e Partneritetit Publik Privat mund të specifikojë kriteret e veçanta të performancës dhe penalizmin financiar që do të zbatohet kundrejt pagesës së disponueshmërisë nëse nuk plotësohet një standard i performancës. Për shembull, një mund të vendoset një gjobë prej 50 Eurosh nëse nuk riparohet brenda gjashtë orësh një xham i thyer në një shkollë të Partneritetit Publik

Privat, ose 1.000 Euro nëse një automjet i prishur nuk hiqet nga rruga e Partneritetit Publik Privat brenda një ore nga raportimi për të; dhe

- b) Në mënyrë alternative, kontrata e Partneritetit Publik Privat mund të caktojë pikë penalizimi ndaj partnerit privat nëse nuk plotësohet një standard i performancës. Çdo pike ose grupi pikësh penalizmi i caktohet një vlerë monetare dhe vlera totale e të gjitha pikëve të penalizimit të vendosura ndaj partnerit privat zbritet nga pagesa e disponueshmërisë.

Të dy metodat e mësipërme ndaj zbritjeve të performancës arrijnë përfundimisht të njëjtin rezultat tregtar. Regjimi i pikëve të penalizimit përdoret shpesh kur autoriteti publik dëshiron të përfshijë tregues shtesë të performancës për të vlerësuar performancën (për shembull, për të vlerësuar lloje të veçanta të dështimit në shërbime).

Legjislacioni në vendet e Ballkanit Perëndimor

Juridiksionet e Ballkanit Perëndimor nuk kanë shumë praktikë apo rregulla të përcaktuara në lidhje me organizimet e pagesave ose zbritjet tek Partneritetet Publike Private, gjë e cila paraqitet në mënyrë të përmbledhur më poshtë.

Shqipëria

Sipas Ligjit për koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat, kompensimi i partnerit privat paguhet në përputhje me disponueshmërinë e projektit dhe zakonisht lidhet me të.²¹

Bosnja dhe Hercegovina - Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës (Kantoni i Hercegovina-Neretvas)

Ligji i Kantonit të Hercegovina-Neretvas për Partneritetin Publik Privat nuk i rregullon këto çështje.

Bosnja dhe Hercegovina - Republika Serbe

Nuk ekziston ndonjë qasje mbizotëruese për këto çështje në Republikën Serbe.

Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë (IRJM), Mali i Zi dhe Serbia

Nuk ekziston ndonjë qasje mbizotëruese në këto juridiksione.

Kosova*

Nuk ekziston ndonjë qasje mbizotëruese. Sidoqoftë, pagesat që merr partneri privat duhet të pasqyrojnë disponueshmërinë, kërkesën ose riskun e ndërtimit të marrë nga partneri privat.²² Gjithashtu, kontrata e Partneritetit Publik Privat mund të përfshijë dispozita që përcaktojnë se partneri privat të marrë tarifa ose pagesa për përdorimin e objektit ose ofrimin e shërbimeve, si dhe të tregojë se si këto tarifa ose pagesa duhet të llogariten dhe përshtaten.²³

²¹ Neni 8 (d) i Ligjit për koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat.

²² Paragrafi 1.2.3 i nenit 7 të Ligjit për Partneritetin Publik Privat.

²³ Paragrafi 2.7 i nenit 48 të Ligjit për Partneritetin Publik Privat.

7.2.4 Disponueshmëria e arsyeshme dhe performanca e dobët

Kontrata e Partneritetit Publik Privat zakonisht parashikon që zbritjet nuk do të bëhen në rrethana të caktuara. Këto mund të përfshijnë, si për shembull:

- a) Mirëmbajtja e planifikuar;
- b) Mosekzekutim i detyrimeve nga autoriteti publik (p.sh., mospagimi i aksesit në truallin e projektit siç kërkohet nga kontrata e Partneritetit Publik Privat);
- c) Mosekzekutimi i detyrimeve nga ofruesit të shërbimeve;
- d) Rastet e kompensimit (shiko Seksionin 9.2);
- e) Rastet e ndihmës që nuk mund të sigurohen (shiko Seksionin 9.3);
- f) Rastet e forcave madhore (shiko Seksionin 9.4); dhe
- g) Ngjarje të pakontrollueshme të palëve të treta ku partneri privat nuk pritet të ofrojë shërbime.

Për shembull, nëse një korsë e një rruge është e mbyllur për shkak të një aksidenti ose një automjeti që është prishur, zbritjet zakonisht nuk bëhen nga pagesa e disponueshmërisë, nëse përgjegjësitë e partnerit privat në bazë të kontratës së Partneritetit Publik Privat nuk përfshijnë ofrimin e shërbimit të reagimit të parë (p.sh., pastrimi i mbetjeve ose heqja e automjeteve). Nga ana tjetër, nëse partneri privat kërkohet të kryejë shërbime të tilla në bazë të kontratës së Partneritetit Publik Privat, disponueshmëria dhe/ose zbritjet e performancës bëhen zakonisht kur korsia e rrugës nuk është e pastruar dhe e hapur për përdorim (d.m.th., bëhet e disponueshme) brenda një periudhë të caktuar të arsyeshme.

Megjithatë, kontrata e Partneritetit Publik Privat do të pranojë se nuk duhet të ketë lehtësim nga zbritjet që rrjedhin drejtpërdrejt nga dëmtimi i shkakuar nga një ngjarje që sigurohet. Arsyetimi për këtë është se partneri privat zakonisht bën sigurimin e ndërprerjes së punës që do të kompensojë çdo të ardhur të humbur (d.m.th., duke përfshirë edhe ato të zbritjeve) gjatë periudhës së rikuperimit të dëmit në infrastrukturë.

Legjislacioni në vendet e Ballkanit Perëndimor

Metoda e mësipërme për lehtësimin nga zbritjet pritet të zbatohet në mënyrë të ngjashme në juridiksionet e Ballkanit Perëndimor. Në rastin e Kosovës Ligji për Partneritetin Publik Privat parashikon që kontrata e Partneritetin Publik Privat mund të rregullojë shkallën në të cilën secila palë mund të çlirohet nga përgjegjësia e mosekzekutimit të detyrimeve të ose e vonesës së përmbytjes së ndonjë detyrimi sipas kontratës për shkak të rrethanave jashtë kontrollit të tij të arsyeshëm.²⁴*

²⁴ Paragrafi 2.7 i nenit 48 të Ligjit për Partneritetin Publik Privat.

7.2.5 Kalibrimi i regjimit të zbritjeve

Niveli (i matur në terma monetarë) i padisponueshmërisë ose i zbritjeve të performancës do të ndryshojë ndjeshëm nëpër projektet e Partneritetit Publik Privat. Është përgjegjësia e autoritetit publik që të sigurojë se regjimi i zbritjeve është *i kalibruar* (që do të thotë përcaktimi i vlerës monetare të secilës zbritje individuale si dhe kur maten në tërësinë e tyre), në mënyrë të tillë që:

- a) Nxit mjaftueshëm partnerin privat për të minimizuar rastet e padisponueshmërisë dhe dështimeve të performancës së shërbimit; dhe
- b) I jep autoritetit publik besim se nuk do të paguajë (proporcionalisht) për nivelet e shërbimit që nuk merr. E thënë në mënyrë të thjeshtë, partneri privat nuk duhet të marrë ndonjë pagesë disponueshmërie nëse infrastruktura nuk është në dispozicion për t'u përdorur nga autoriteti publik (dhe/ose përdoruesit fundorë).

Mënyra se si funksionon regjimi i zbritjeve ndryshon shumë në praktikë. Për shembull:

- a) Kontrata e Partneritetit Publik Privat mund të kufizojë zbritjet që mund të bëhen ndaj një kësti (mujor, tremujor, në vit) të pagesës së disponueshmërisë në një nivel më të ulët se shuma e planifikuar e këstit. Ky mekanizëm nënkupton që partneri privat (në një skenar të rastit më të keq) nuk do të humbasë të gjithë pagesën e disponueshmërisë për periudhën e caktuar të pagesës (muaj, tremujor, vit) përmes zbatimit të zbritjeve;
- b) Kontrata e Partneritetit Publik Privat mund të rendisë rrethanat në të cilat disponueshmëria ose performanca e dobët mund të justifikohet (d.m.th., zbritjet që nuk janë bërë ndaj pagesës së disponueshmërisë). Nëse kjo listë është shumë e gjerë, atëherë një mekanizëm i tillë mund të nënkuptojë se mund të ekzistojnë vetëm shumë pak rrethana në të cilat partneri privat mund të pësojë zbritje të pagesës së disponueshmërisë;
- c) Regjimi i zbritjeve mund të zbatohet vetëm për një përqindje të përcaktuar të pagesës së disponueshmërisë (p.sh. 40%), megjithëse, nëse zbritjet në një periudhë pagese tejkalojnë përqindjen e përcaktuar, autoriteti publik mund ta trashëgojë tepriçën në periudhën apo periudhat e mëpasshme (dhe pasuese) të pagesës;
- d) Zbritjet mund të vlerësohen vetëm mbi baza vjetore (me një faturë që i dërgohet partnerit privat nga autoriteti publik për pagimin e vlerës totale të zbritjeve të akumuluar në vitin përkatës), pavarësisht se këstet e pagesës së disponueshmërisë janë paguar më shpesh; dhe
- e) Zbritjet mund të vendosen në një nivel që, edhe kur i gjithë projekti nuk është i disponueshëm për t'u përdorur nga autoriteti publik (ose përdoruesit e tjerë fundorë), partneri privat mund të marrë disa nga pagesat e disponueshmërisë.

Zbatimi i disa prej këtyre karakteristikave në kontratën e Partneritetit Publik Privat përshkruhet më poshtë.

7.2.6 Kufijtë dhe limitet e zbritjeve

Kontrata e Partneritetit Publik Privat zakonisht do të përfshijë një dispozitë për një tavan ose kufi financiar të nivelit të zbritjeve që mund të bëhen për pagesën e disponueshmërisë, për shembull në një periudhë të caktuar pagese ose brenda një viti.

Natyra e çdo marrëveshje për vendosje tavani ose limiti mund të varet nga sa më poshtë vijon:

- a) Sa shpejt dhe me sa do ta zvogëlojë pagesa e disponueshmërisë gamën e niveleve të ndryshme të padisponueshmërisë ose të mosrealizimit në një periudhë të vetme pagese. Kjo varet pjesërisht nga vlera në të cilën përcaktohen zbritjet, por edhe nga numri i zonave/elementeve që maten për disponueshmërinë ose performancën. (Kjo ndjeshmëri ndaj uljes së shumës së paguar herë pas here quhet kalibrimi i mekanizmit të pagesave, siç është përshkruar në nën-seksionin e mëparshëm); dhe
- b) Natyra e shërbimeve të ofruara nga partneri privat në bazë të kontratës së Partneritetit Publik Privat.

Më poshtë jepen disa shembuj të dispozitave të përdorura për të kufizuar ekspozimin e partnerit privat ndaj zbritjeve:

- a) Kufizimi i ekspozimit të partnerit privat ndaj zbritjeve të përgjithshme (d.m.th., si të padisponueshmërisë ashtu edhe zbritjeve të performancës) për një periudhë të caktuar pagese (p.sh., një muaj ose një vit) në një shumë të barabartë me nivelin e pagesës së disponueshmërisë që duhet të paguhet për atë periudhë;
- b) Kufizimi i të drejtës së autoritetit publik për të bërë zbritjet nga pagesa e disponueshmërisë për një periudhë të caktuar pagese në një përqindje të përcaktuar të pagesës së disponueshmërisë, ku të gjitha zbritjet që nuk mund të bëhen në atë periudhë (sepse është arritur përqindja maksimale e lejueshme) mbartet për t'u bërë në periudhën tjetër të pagesës. Kjo i jep partnerit privat sigurinë e një niveli minimal të fluksit të parasë;
- c) Kufizimi i shumës së zbritjeve të performancës për një shërbim të veçantë në çdo periudhë pagese në një nivel që përputhet më shumë me koston e parashikuar të partnerit privat që ofron shërbimin përkatës (p.sh., kufizimi i ekspozimit të partnerit privat ndaj zbritjeve të performancës në lidhje me shërbimet e pastrimit); dhe
- d) Kufizimi i ekspozimit të partnerit privat ndaj zbritjeve në të gjitha periudhat e pagesës në një përqindje fikse të caktuar të pagesës së disponueshmërisë për periudhën. Dallimi kryesor midis kësaj qasje dhe qasjes së përshkruar në pikën b) është se pagesa totale e disponueshmërisë mund t'i nënshtrohet vetëm një përqindje fikse të pagesës gjatë gjithë periudhës së kontratës.

Një pikë kyçe që duhet përmendur është marrëdhënia midis regjimit të zbritjeve dhe dispozitave të mosekzekutimit të detyrimeve nga partneri privat. Ndodh shpesh që autoriteti publik të përfshijë mosekzekutimin e detyrimeve nga partneri privat në kontratën e Partneritetit Publik Privat për një performancë të dobët sistematike dhe të vazhdueshme. Kjo shpesh arrihet duke përfshirë mosekzekutimin e detyrimeve nga

partneri privat në lidhje me nivelin e zbritjeve të shkaktuara nga partneri privat gjatë një periudhe të caktuar. Për shembull, në qasjen e përshkruar në pikën d) më lart, kontrata e Partneritetit Publik Privat përcakton se mosekzekutimi i detyrimeve nga partneri privat ndodh nëse zbritjet për një periudhë të caktuar arrijnë kufirin e përcaktuar. Në këtë rast, autoriteti publik mund të ushtrojë të drejtën e tij për të ndërprerë kontratën e Partneritetit Publik Privat për shkak të mosekzekutimit të detyrimeve nga partneri privat. Me fjalë të tjera, limit është i lidhur me dispozitat e mosekzekutimit të detyrimeve nga partneri privat që parashikohen në kontratën e Partneritetit Publik Privat (shih Seksionin 13.1).

7.2.7 Periudha e familiarizimit dhe e lehtësirave

Disa kontrata të Partneritetit Publik Privat përfshijnë dispozita që vonojnë zbatimin e zbritjeve derisa projekti të jetë vënë në funksionim për një periudhë të përcaktuar kohore (p.sh., gjashtë muaj). Kjo do të thotë që në disa raste partneri privat mund të kenë nevojë për një periudhë të arsyeshme kohore për të arritur performancën optimale funksionale sipas standardeve të përcaktuara në kontratën e Partneritetit Publik Privat. Kjo lloj dispozite (që njihet herë pas here si periudha e *familiarizimit ose të lehtësirave*) është më e zakonshme në Partneritetet Publike Private me karakteristikat e mëposhtme:

- a) Objekti i shërbimeve që partnerit privat i kërkohet të kryejë sipas kontratës së Partneritetit Publik Privat është më i gjerë se sa mirëmbajtja e infrastrukturës;
- b) Transferimi i stafit nga autoriteti publik te partneri privat, i cili do të përfshihet në ofrimin e përditshëm të shërbimeve ndaj të cilave do të zbatohen zbritjet e performancës; dhe/ose
- c) Realizimi efikas i kontratës së Partneritetit Publik Privat kërkon një nivel të konsiderueshëm ndërveprimi midis autoritetit publik dhe partnerit privat, në mënyrë të tillë që protokollet do të duhet të dakordësohen midis palëve me qëllim që të krijohet njëfarë mirëkuptimi për atë që ata presin nga njëri-tjetri kur të bashkë-vendosen tek trualli dhe të punojnë në mënyrë ndërvepruese së bashku.

Periudhat e familiarizimit ose të lehtësirave mund të marrin forma të ndryshme. Shembuj referuar një periudhe kohore përfshijnë sa më poshtë vijon:

- a) Pezullimi i regjimit të zbritjeve për aspektet e performancës kur shihet se zbritjet do të jenë të pashmangshme deri në momentin kur operacionet të arrijnë gjendjen e tyre normale të planifikuar;
- b) Lënia mënjane e kategorive të caktuara të zbritjeve me qëllim që të përcaktohet nëse ka ndodhur mosekzekutimi i detyrimeve nga e partnerit privat apo jo. Sipas kësaj qasje, zbritjet i bëhen pagesës së disponueshmërisë, por partneri privat nuk është i ekspozuar ndaj riskut të atyre zbritjeve që çojnë në ndërprerjen e kontratës për shkak të mosekzekutimit të detyrimeve nga partneri privat, për një periudhë kohe; ose
- c) Zbatimi i niveleve të reduktuara të zbritjeve.

7.2.8 Rregullimi i mosekzekutimit të detyrimeve

Kontrata e Partneritetit Publik Privat zakonisht pranon që partnerit privat duhet t'i jepet një periudhë e arsyeshme kohore për të reaguuar ndaj ngjarjes që shkakton

padisponueshmërinë ose mos-performancën para se ai të fillojë të pësojë zbritje. Për shembull:

- a) Në rastin e një mbylljeje të përkohshme të korsisë rrugore që shkaktohet nga një automjet që prishet në një projekt të Partneritetit Publik Privat për rrugët, kontrata e Partneritetit Publik Privat mund të shprehet që gjithsesi korsia do të quhet se është e disponueshme nëse automjeti hiqet brenda një periudhe të caktuar (p.sh., 60 minuta) nga momenti që partneri privat është vënë në dijeni për situatën; ose
- b) Në rastin e një projekti shkollor, kontrata e Partneritetit Publik Privat mund të shprehet që nëse një xham është thyer gjatë orarit të mësimin, atëherë të gjitha padisponueshmëritë do të quhen se nuk kanë ndodhur nëse xhami është riparuar brenda një periudhe kohe të caktuar.

Kontrata e Partneritetit Publik Privat mund t'i japë kohë partnerit privat që ai të korrigjojë performancën e dobët ose padisponueshmërinë e tij:

- a) Duke përfshirë një periudhë korrigjimi në përcaktimin kontraktual të disponueshmërisë/padisponueshmërisë ose dështimit të performancës, duke dhënë automatikisht një periudhë korrigjimi çdo rasti të padisponueshmërisë ose performancës së dobët; ose
- b) Duke specifikuar mosekzekutimi e detyrimeve dhe rrethanat e veçanta në të cilat partneri privat do të përfitojë një periudhë korrigjimi dhe duke e specifikuar periudhën e korrigjimit në një nivel që është në përpjesëtim me çështjen përkatëse.

7.2.9 Rregullimet e pagesës së disponueshmërisë për të pasqyruar kostot themelore

Shumica e kontratave të Partneritetit Publik Privat do të përfshijnë dispozita që rregullojnë pagesën e disponueshmërisë në mënyrë automatike në disa rrethana të kufizuara.

Shembujt më të zakonshëm përfshijnë sa më poshtë vijon:

- **Indeksimi i inflacionit:** shumica e kontratave të Partneritetit Publik Privat përfshijnë njëfarë rregullimi të pagesës së disponueshmërisë për rritje të kostos themelore të partnerit privat. Pjesa e pagesës së disponueshmërisë që i nënshtrohet rregullimit zakonisht është e kufizuar në ato kosto që krijohen gjatë fazës operative. Rregullimi bëhet duke iu referuar një indeksi të pavarur që mat ndryshimet e çmimeve në kategorinë përkatëse (zakonisht indeksi kombëtar i çmimeve të konsumatorit).
- **Rregullimet e primit të sigurimit** (Shih Seksionin 9)
- **Standardet krahasuese dhe testimi i tregut:** në Partneritetet Publike Private ku partneri privat ofron një numër shërbimesh që janë më thelbësore sesa thjesht mirëmbajtja e infrastrukturës (p.sh., shërbime pastrimi, shërbimi katering, shërbime lavanderie, shërbime të menaxhimit të trafikut ose shërbime të grumbullimit të mbetjeve) kontrata e Partneritetit Publik Privat mund të përfshijë një dispozitë për koston e atyre shërbimeve që do të jenë subjekt i standardeve krahasuese ose që do të testohen nga tregu në mënyrë periodike. Shih Kutinë 1 më poshtë.

Kutia 1 – Standardet krahasuese dhe testimi i tregut

Standardet krahasuese janë një proces në të cilin autoriteti publik dhe partneri privat kërkojnë të bien dakord për nivelin mbizotërues të tregut për ofrimin e shërbimit përkatës duke përdorur çdo të dhënë që palët mund të përdorin. Nëse palët nuk bien dakord për nivelin mbizotërues të tregut, atëherë kontrata e Partneritetit Publik Privat zakonisht kërkon ushtrimin e testimit të tregut për shërbimin përkatës.

Testimi i tregut është një proces me të cilin partneri privat prokuron ofrimin e shërbimit përkatës përmes një ushtrimi të tenderimit konkurrues. Partnerit privat i kërkohet që zakonisht të caktojë ofertuesin e suksesshëm si nënkontraktues dhe pagesa e disponueshmërisë përshtatet që të pasqyrojë çmimin e ofertuesit të suksesshëm.

Dispozitat e standardeve krahasuese/testimit të tregut zbatohen zakonisht çdo pesë deri në shtatë vjet gjatë fazës funksionale të kontratës së Partneritetit Publik Privat.

Dispozitat e standardeve krahasuese dhe testimi i tregut synojnë të rregullojnë pagesën e disponueshmërisë për të reflektuar ndryshimet e niveleve mbizotëruese të tregut për ofrimin e shërbimeve përkatëse. Vendimi për të përfshirë dispozita të tilla mund të merret për secilën nga arsyet e mëposhtme, i nxitur nga vlera e parasë në transferimin e riskut të çmimit tek partneri privat:

- a) Kostot e ofrimit të shërbimit që është subjekt i standardeve krahasuese përbëhen në thelb kostot e personelit. Këto zakonisht vlerësohen si jashtëzakonisht të vështira për t'u parashikuar për një periudhë afatgjatë, siç është, për shembull, periudha 25 vjet;
- b) Me kalimin e kohës, futja e metodave të reja të punës dhe/ose teknologjisë mund të bëjë të mundur që shërbimi që është subjekt i standardeve krahasuese të ofrohet në një mënyrë tjetër krahasuar me atë që ishte parashikuar në fillim të kontratës së Partneritetit Publik Privat (përfshirë situatën me një kosto më të ulët); dhe/ose
- c) Kostot e caktuara që lidhen me sigurimin e shërbimit që është subjekt i standardeve krahasuese, zakonisht luhaten në përputhje me çmimet përkatëse të mallrave (p.sh., kostot e transportit në kontekstin e një projekti të mbetjeve, ku partnerit privat kërkohet të grumbullojë mbetje nga i gjithë komuniteti).

7.2.10 Kostot e shërbimeve dhe të mallrave

Shkalla në të cilën një projekt përdor energji elektrike, naftë, gaz ose mallra të tjera gjatë fazës së funksionimit varet nga natyra e projektit dhe objekti i shërbimeve që autoriteti publik kërkon nga partneri privat.

Në shumicën e kontratave të Partneritetit Publik Privat të bazuara në disponueshmëri, kostoja që shoqëron shërbimet e përdorura do të jetë si më poshtë vijon:

- a) Përfshihet si pjesë e pagesës së disponueshmërisë. Partneri privat në përgjithësi merr përsipër përgjegjësinë e realizimit të kontratës me ofruesin e shërbimeve (që vepron në emër të autoritetit publik) dhe është i detyruar të

paguajë koston e plotë të çdo shume të faturuar nga ofruesi i shërbimeve, bazuar në përdorim; ose

- b) *Kosto e kalueshme* cila është e ndarë nga pagesa e disponueshmërisë. Në këtë rregullim, partneri privat në përgjithësi merr përgjegjësinë e realizimit të kontratës me ofruesin e shërbimeve (duke vepruar në emër të autoritetit publik), por që autoriteti publik paguan koston e plotë për çdo shumë që faturohet nga ofruesi i shërbimeve bazuar në përdorim. Shpesh kërkohet një dispozitë në kontratën e Partneritetit Publik Privat që të sigurojë lehtësim nga çdo zbritje të pagesës së disponueshmërisë në masën që ndërpritet shërbimi (dhe që ndikon në këtë mënyrë tek disponueshmëria) nëse autoriteti publik nuk arrin të bëjë pagesën e duhur; ose
- c) Kosto e realizuar plotësisht nga autoriteti publik jashtë kontratës së Partneritetit Publik Privat. Në këtë marrëveshje, partneri privat është zakonisht përgjegjës për realizimin e kontratës fillestare me ofruesin e shërbimeve (që vepron në emër të autoritetit publik) deri në fund të fazës së ndërtimit. Më pas, kontrata e shërbimeve mund të mbahet nga partneri privat ose mund t'i transferohet autoritetit publik. autoriteti publik faturohet drejtpërdrejt nga ofruesi i shërbimeve dhe paguan koston e plotë të çdo shume në bazë të përdorimit. Shpesh kërkohet një dispozitë në kontratën e Partneritetit Publik Privat që të sigurojë lehtësim nga çdo zbritje të pagesës së disponueshmërisë në masën që ndërpritet shërbimi (dhe që ndikon në këtë mënyrë tek disponueshmëria) nëse autoriteti publik shkel kontratën e shërbimeve.

Është tipike në projektet e Partneritetit Publik Privat që nuk përdorin, për nga natyra e tyre, nivele krahasimisht të larta të mallrave (siç janë Partneritetet Publike Private të rrugëve) që partneri privat të jetë përgjegjës për të siguruar furnizimin e mallit përkatës dhe të marrë përsipër riskun e luhatjeve të çmimit të mallit gjatë kohëzgjatjes së kontratës. (Në këtë situatë kontrata e Partneritetit Publik Privat nuk përfshin ndonjë mekanizëm të rregullimit të çmimeve për ndryshimet e çmimeve të mallrave ose të vëllimeve të përdorura nga projekti).

Sidoqoftë, në projektet e Partneritetit Publik Privat që, për nga natyra e tyre, përfshijnë nivele të larta të përdorimit të mallit gjatë fazës së funksionimit, ekziston një numër qasjesh për alokimin e të dyjave:

- **Risku i volumit**, që është sasia e mallit që përdoret nga autoriteti publik ose autoriteti privat; dhe
- **Risku i çmimit për njësi**, që është çmimi i tregut për mallin përkatës që vendoset nga ofruesi i shërbimeve.

Shumë projekte që përmbajnë përdorimin e sasive të mëdha të mallrave (p.sh., projektet e akomodimit, projektet hekurudhore dhe/ose energjia nga projektet e mbetjeve) përfshijnë mekanizmat e rregullimit të çmimeve të cilat parashikojnë që pagesa e disponueshmërisë të rregullohet në mënyrë periodike (p.sh., çdo vit) për të reflektuar rritje/ulje të çmimit themelor të mallit. Në këto rrethana, partneri privat merr të gjithën ose pjesën më të madhe të riskut të vëllimit ndërkohë që autoriteti publik merr riskun e çmimit të njësisë.

Kontrata mund të përfshijë gjithashtu edhe një mekanizëm që nxit të dy palët që të zvogëlojnë sasinë e mallit që përdoret (p.sh., masat e kursimit të ujit ose të energjisë), ku përfitimi i çdo kursimi ndahet midis tyre.

7.2.11 Ndikimi i përfundimit të vonuar në shlyerjen e pagesës së disponueshmërisë

Ndikimi i vonesave në ndërtim tek e drejta e partnerit privat për të filluar marrjen e pagesës së disponueshmërisë zakonisht vijon me njërën nga dy metodat e që përdoren zakonisht:

- **Afati i përcaktuar i kontratës:** kontrata e Partneritetit Publik Privat skadon në një datë të përcaktuar, e cila vendoset në bazë të një kohëzgjatje fikse për afatin e kontratës (p.sh., 20 vjet). Data e përcaktuar e mbarimit vendoset duke iu referuar datës faktike të mbylljes së kontratës (ose të mbylljes financiare). Kjo do të thotë që, nëse përfundimi i ndërtimit vonohet, atëherë periudha e funksionimit dhe mirëmbajtjes shkurtohet me të njëjtën periudhë që ka zgjatur vonesa. Si pasojë, partneri privat do të humbasë shumën e pagesës së disponueshmërisë që, ne rrethana të tjera, do të kishte marrë nëse ndërtimi do të kishte përfunduar në kohë; dhe
- **Periudha e përcaktuar e funksionimit:** kut kontrata e Partneritetit Publik Privat parashikon një periudhë të përcaktuar të funksionimit dhe mirëmbajtjes që fillon atëherë kur faza e ndërtimit të ketë përfunduar. Nëse përfundimi i ndërtimit vonohet, atëherë partneri privat do ta marrë pagesën e plotë të disponueshmërisë (që i nënshtrohet zbritjeve) gjatë të njëjtës kohëzgjatje të periudhës së funksionimit dhe mirëmbajtjes, por këstet do të fillojnë më vonë krahasuar me situatën sesa nëse përfundimi i ndërtimit nuk do të ishte vonuar. Sidoqoftë, partneri privat do të pësojë humbje në mbulimin e kostos së periudhës së ndërtimit për një periudhë më gjatë se sa ishte planifikuar, përfshirë çdo kosto shtesë shoqëruese të financave. (Shënim: në këtë rregullim, data e mbarimit të kontratës nuk është e përcaktuar në mbylljen e kontratës ose në mbylljen financiare, por përkundrazi në datën faktike të përfundimit të ndërtimit.)

Disa autoritete publike preferojnë mënyrën e kërkimit të një periudhe funksionimi dhe mirëmbajtjeje të përcaktuar, veçanërisht nëse pritet që të kërkohen punë të rëndësishme me cikël jetësor të rëndësishëm gjatë pak viteve të kontratës së Partneritetit Publik Privat. Kjo mund të japë një siguri më të madhe të jetës së shërbimit dhe gjendjes së infrastrukturës (dhe, për këtë arsye, nevojat për investime në të ardhmen) kur dorëzohet në fund të afatit të kontratës.

Autoritetet e tjera publike preferojnë metodën e kohëzgjatjes së përcaktuar të kontratës, sepse rritja e ekspozimit financiar të partnerit privat (të cilën ia kalon kontraktorit të ndërtimit në formën e niveleve më të larta të dëmeve të konstatuara) mund të ofrojë një nxitje shtesë për të përfunduar në kohë. Kjo gjithashtu jep, në një farë mase, siguri më të madhe në lidhje me kohën kur autoriteti publik duhet të marrë përgjegjësinë e ardhshme për infrastrukturën.

autoriteti publik në përgjithësi do të marrë përsipër riskun e ngjarjeve të caktuara gjatë fazës së ndërtimit (p.sh., mosekzekutimin e detyrimeve nga ana e tij). Nëse kontrata e

Partneritetit Publik Privat ka një datë përfundimi të përcaktuar dhe ndërtimi vonohet nga ngjarje të tilla, atëherë autoriteti publik zakonisht do të kompensojë partnerin privat për pjesën e pagesave të disponueshmërisë që ai humbet si rezultat i vonesës. Kompensimi i dhënë nga autoriteti publik mund të jetë ose në formën e një pagese dhe/ose zgjatje të afatit të kontratës së Partneritetit Publik Privat.

Legjislacioni në vendet e Ballkanit Perëndimor

Pozicioni i përgjithshëm në juridiksionet e Ballkanit Perëndimor është se nuk ka ndonjë legjislacion specifik për të bërë rregullime të tarifave të disponueshmërisë, por kjo është një çështje që mund të dakordësohet me kontratë midis palëve.

*Në **Shqipëri**, kushtet materiale të kontratës nuk mund të ndryshohen nëse ndryshimi nuk parashikohet në dokumentet e tenderit.²⁵*

*Në **Kosovë***, çdo dispozitë për rregullime duhet t'i nënshtrohet Paragrafi 2.7, të Nenit 48 të Ligjit për Partneritetin Publik Privat.*

Dokumente udhëzuese për reference



SFT Udhëzues për modelin e mekanizmit të pagesave, Mbretëria e Bashkuar (Skoci), (2014)
(www.scottishfuturetrust.org.uk/storage/uploads/SFT_Payment_Mechanism_Model_Guidance_Note.docx)



Udhëzues për financat private 2 (PF2), Mbretëria e Bashkuar (Angli), (2012)
(<https://www.gov.uk/government/publications/private-finance-2-pf2>)

²⁵ Neni 31.5 i Ligjit për koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat.

8. Ndryshimet e projektit

8.1 Panoramë e përgjithshme

Kontrata e Partneritetit Publik Privat zakonisht i jep autoritetit publik të drejtë të propozojë ndryshime në projekt. Disa kontrata të Partneritetit Publik Privat përfshijnë dispozita që e lejojnë autoritetin publik të ndryshojë në mënyrë të njëanshme kontratën e Partneritetit Publik Privat (p.sh., pa pëlqimin e partnerit privat) për arsye të politikave publike.

Gjithashtu, partneri privat do të ketë përgjithësisht të drejtë të propozojë ndryshime në projekt. Më rrallë, kontrata e Partneritetit Publik Privat mund t'i japë partnerit privat një të drejtë të kërkojë ndryshime (në rrethana të kufizuara).

8.2 Ndryshimet që kërkojnë nga autoriteti publik

Disa juridiksione kanë ligje publike që i japin autoritetit publik të drejtën për të ndryshuar kontratën e Partneritetit Publik Privat për arsye të politikave publike. Në terma praktikë, kjo do të thotë që partneri privat nuk ka arsye të kundërshtojë ndryshimin përkatës, por zakonisht ka mundësinë të kërkojë kompensim.

Në juridiksionet që nuk i japin autoritetit publik të drejta të ndryshimit të njëanshëm, kjo e drejtë mund të rregullohet me dispozita në kontratën e Partneritetit Publik Privat.

Është pranuar tashmë që nëse autoriteti publik kërkon në mënyrë të njëanshme një ndryshim në projekt, atëherë kontrata e Partneritetit Publik Privat duhet të sigurojë mbrojtje të përshtatshme për partnerin privat. Në shumicën e rrethanave, kontrata e Partneritetit Publik Privat i jep partnerit privat të drejtën që të kërkojë kompensim të dëmeve nga autoriteti publik (për të mbuluar çdo kosto të rritur ose humbje të të ardhurave të shkaktuara nga ndryshimi) dhe të kërkojë lehtësim nga çdo mospërbushje e kontratës së Partneritetit Publik Privat që vjen si rezultat i drejtpërdrejtë i ndryshimit.

Në mënyrë të ngjashme, kontrata e Partneritetit Publik Privat zakonisht do të përfshijë një mekanizëm për të siguruar që partneri privat të mos marrë një fitim financiar të papritur nga ndryshimet që çojnë në një ulje të kostove të tij (ose një rritje të të ardhurave të tij).

Kontrata e Partneritetit Publik Privat mund të përcaktojë arsye të kufizuara, mbi bazë të së cilave partneri privat mund të kundërshtojë një ndryshim që autoriteti publik propozon t'i bëjë projektit. Shembulli më i zakonshëm është fakti se ndryshimi do të paraqiste një ndryshim material të natyrës ose të profilit të riskut të projektit.

Legjislacioni në vendet e Ballkanit Perëndimor

Në Ballkanin Perëndimor, juridiksioni i vetëm që parashikon një koncept të ngjashëm me një të drejtë ligjore të njëanshme për të ndryshuar një kontratë është Kantoni Neretva. Në bazë të ligjit të tij për koncesionet, nëse, për arsye të politikës publike, është e nevojshme të kufizohet objekti i koncesionit ose të përshtatet me një situatë të re, partneri privat duhet të marrë të gjitha masat e kërkuara nga Qeveria për këtë qëllim. Në një rast të tillë, partneri privat do të jetë në gjendje të kërkojë dëmshpërblim, por jo kompensim për fitimet e munguara. Të drejtat për të

ndryshuar projektin zakonisht përfshihen në kontratën e Partneritetit Publik Privat. Për shembull, në Kosovë kontrata mund të përfshijë dispozita që lejojnë autoritetin publik të ndryshojë kushtet e tij në mënyrë të njëanshme në rrethanat e përcaktuara në kontratën e Partneritetit Publik Privat.*

Është diçka e zakonshme në të gjithë juridiksionet e Ballkanit Perëndimor që Qeveria të ketë një të drejtë ligjore të ndërpresë kontratën për arsye të politikave publike (p.sh., në Shqipëri,²⁶ në Republikën Serbe, në Malin e Zi dhe në Serbi) në vend që t'i lejojnë qeveritë të ndryshojnë kontratën në mënyrë të njëanshme.

8.3 Ndryshimet që propozohen nga partneri privat

Kontrata e Partneritetit Publik Privat mund të përfshijë dispozita që i mundësojnë partnerit privat të propozojë ndryshime. Sidoqoftë, kontrata e Partneritetit Publik Privat zakonisht kërkon që autoriteti publik të aprovojë çdo ndryshim të propozuar nga partneri privat (përveç rastit, ndoshta, kur kërkohet një ndryshim në mënyrë që të pajtohet me një ndryshim në ligj ose rregullore).

Pra, futja e një ndryshimi të propozuar nga partneri privat është në thelb një çështje për negociata midis palëve. Kontratat e Partneritetit Publik Privat që i mundësojnë partnerit privat të propozojë ndryshime të specifikimit përfshijnë herë pas here edhe dispozita që kanë të bëjnë me çdo kursim të kostos që vjen nga ndryshimet e propozuara nga partneri privat dhe të aprovuara nga autoriteti publik (p.sh., dispozita për kursimet e kostove të ndahet në mënyrë të barabartë midis palëve).

²⁶ Kjo rrjedh nga kushtet standarde të përgjithshme të kontratave të koncesionit.

9. Trajtimi i ngjarjeve të paparashikuara

9.1 Historik

Metoda tradicionale në kontratat e Partneritetit Publik Privat është se, përveçse nëse e drejta e kontratave parashikon ndryshe, partneri privat merr riskun e çdo lloj mos-performance, edhe nëse shkaku i mos-performancës është jashtë kontrollit të partnerit privat. Është harxhuar shumë kohë duke analizuar risqet që mund të lindin gjatë afatit të kontratës së Partneritetit Publik Privat dhe shkallën në të cilën partneri privat duhet të çlirohet nga performanca e dobët ose mos-performanca e shkaktuar nga ngjarjet e paparashikuara, d.m.th., ngjarje që janë jashtë kontrollit të palëve.

Me kalimin e kohës, kjo ka bërë që shumica e juridiksioneve të përdorin një qasje me tre nivele ndaj rasteve të riskut, si më poshtë:

- a) **Rastet e kompensimit:** këto janë ngjarje për të cilat autoriteti publik merr përsipër riskun. autoriteti publik i paguan kompensim partnerit privat dhe jep çdo formë tjetër të lehtësimit kontraktues që kërkohet për ta lënë partnerin privat në pozicionin ku ka qenë para se të ndodhte rasti përkatës i kompensimit.
- b) **Rastet e ndihmës** (të quajtura shpesh **rastet e vonesës** kur ato ndodhin gjatë fazës së ndërtimit): këto janë ngjarje për të cilat pritet që partneri privat (të paktën deri në një farë mase) të marrë përsipër riskun financiar, por çlirohet nga pasojat e tjera të mos-performancës që shkaktojnë ngjarje të tilla. Rastet e ndihmës janë, nga natyra, raste që ose janë të siguroshme ose nuk pritet të vazhdojnë për shumë ditë.
- c) **Rastet e forcës madhore:** në terma të gjerë, këto janë ngjarje:
 - Jashtë kontrollit të palëve; dhe
 - Që e bëjnë të pamundur përmbushjen e të gjitha, ose një pjese materiale, të detyrimeve të njëjës palë.

Megjithëse legjislacioni dhe/ose praktika gjyqësore e disa juridiksioneve evropiane i ofrojnë partnerit privat mbrojtje ndaj forcës madhore, koncepti zakonisht përfshihet në kontratën e Partneritetit Publik Privat. Kontrata e Partneritetit Publik Privat do të përcaktojë ngjarje që vlerësohen si ngjarje të forcave madhore. Përkufizimi është përqendruar shpesh në ngjarje që janë të pasiguroshme, jashtë kontrollit të secilës palë dhe katastrofike në natyrë, p.sh., një tërmet apo tornado.

9.2 Rastet e kompensimit

9.2.1 Përkufizimi i një rasti të kompensimit

Rastet e kompensimit përcaktohen dhe renditen në kontratën e Partneritetit Publik Privat. Lista e rasteve të përfshira është shpesh shumë specifike për projektin, por zakonisht do të përfshijë sa më poshtë vijon:

- a) Shkeljen e kontratës së Partneritetit Publik Privat nga autoriteti publik, për shembull::

- Mossigurimi nga autoriteti publik i aksesit tek trualli ose lejon që ai është përgjegjës për prokurimin në bazë të kontratës së Partneritetit Publik Privat;
 - Vonesa në përfundimin e infrastrukturës mbështetëse për të cilën autoriteti publik është përgjegjës në bazë të kontratës së Partneritetit Publik Privat;
- b) Zbulimi i kushteve të paparashikueshme të tokës. Në varësi të natyrës së projektit, kjo mund të përqendrohet, për shembull, tek risku i kontaminimit mjedisor, risku gjeologjik dhe tek risku i zbulimit të infrastrukturës që lidhet me shërbimet;
- c) Mosmarrja e një leje kryesore për projektin që nuk mund t'i atribuohet ndonjë mosekzekutimi të detyrimeve nga ana e partnerit privat;
- d) Ndryshimet në ligjin ose rregulloret kombëtare; dhe
- e) Rreziqe të tjera specifike të projektit për të cilat autoriteti publik merr përsipër riskun (ose plotësisht ose të ndarë) mbi bazë të vlerës për para.

9.2.2 Ndhimja që i jepet partnerit privat në rastin e ndodhjes së një rasti kompensimi

Parimi që mbështet mekanizmin e kompensimit të rasti është që autoriteti publik merr përsipër riskun e ngjarjes dhe partneri privat mbrohet nga ndodhja ose vazhdimi i rasti. Rastet e kompensimit trajtohen si më poshtë:

- a) Nëse rasti i kompensimit shkakton vonesë në përfundimin e ndërtimit të projektit, atëherë partneri privat çlirohet nga pagimi i dëmeve të konstatuara tek autoriteti publik (nëse është e rëndësishme) ndërkohë që datat kryesore të programit të ndërtimit shtyhen aq sa është e arsyeshme për rrethanat (p.sh., nëse autoriteti publik ka mundësinë të ndërpresë kontratën e Partneritetit Publik Privat për mos-përfundimin e ndërtimit deri në një datë të caktuar, atëherë kjo datë shtyhet);
- b) Gjatë fazës funksionale të projektit, të gjitha zbritjet e bëra në bazë të mekanizmit të pagesës së shkaktuar nga një rast kompensimi anulohen;
- c) Partneri privat ka të drejtë të kërkojë kompensim monetar nga autoriteti publik për çdo kosto të rritur që i shkaktohet si rezultat i drejtpërdrejtë i atij rasti kompensimi (p.sh., rritja e kostove të punës ose materialeve); dhe
- d) Partneri privat kompensohet për çdo të ardhur që do të kishte marrë nëse nuk do të kishte ndodhur rasti përkatës i kompensimit. Qasja e ndërmarrë për të përcaktuar kompensimin do të varet nga fakti nëse kontrata ka një kohëzgjatje dhe datë përfundimi të përcaktuar ose ka një periudhë funksionimi të përcaktuar. (Kjo diskutohet më tej në nën-seksionin më poshtë).

Legjislacioni në vendet e Ballkanit Perëndimor

Ligji shqiptar dhe ai serb parashikojnë mundësinë e përfshirjes së një klauzole të stabilizimit në kontratën e Partneritetit Publik Privat për të mbrojtur partnerin privat kundër pasojave të një ndryshimi të dëmshëm në ligj. Në Shqipëri, parashikimi i një klauzole të stabilizimit në kontratë kërkon pëlqimin e Këshillit të Ministrave.

9.2.3 Mbrojtja e partnerit privat nga humbja e të ardhurave

Nëse një rast kompensimi vonon fillimin e fazës funksionale të projektit, atëherë mënyra se si kompensohet partneri privat do të varet nga fakti nëse kontrata ka një kohëzgjatje dhe datë përfundimi të përcaktuar apo ka një periudhë funksionimi të përcaktuar (shih Seksionin 7 për një shpjegim të detajuar të ndryshimit midis këtyre dy koncepteve).

- **Periudha funksionale e përcaktuar:** në kontratën që ka një periudhë funksionale të përcaktuar, partneri privat nuk pëson humbje të drejtpërdrejta të të ardhurave si rezultat i ndonjë vonese në përfundimin e fazës së ndërtimit. Sidoqoftë, ai është i ekspozuar ndaj problemit të qarkullimit të parasë (d.m.th., të ardhurat shtyhen) dhe, veçanërisht, mund të shkaktohen kosto shtesë të financimit si rezultat i vonesës. Edhe kapitali IRR (Norma e brendshme e kthimit) i partnerit privat mund të zvogëlohet gjithashtu si rezultat i vonesës.
- Prandaj, partneri privat shpesh rimburohet për ndonjë kosto shtesë, por (duke reflektuar tiparin e afatit funksional të kontratës së Partneritetit Publik Privat) nuk do të ketë të drejtë të marrë shumën e plotë të pagesës së disponueshmërisë që do të priste të merrte në rrethana të tjera gjatë periudhës së vonesës.
- **Kohëzgjatja e përcaktuar e kontratës** (me datë të përcaktuar të mbarimit): Partneri privat mund të kërkojë një shumë të barabartë me atë të pjesës së pagesës së disponueshmërisë që do të ishte marrë, në rrethana të tjera, gjatë një periudhe të barabartë me periudhën e vonesës. Kostot e shmangshme (p.sh., kostot e sigurimit funksional ose kostot e mirëmbajtjes që partneri privat nuk do të pësojë si rezultat i vonesës) zbriten zakonisht nga pagesa e kompensimit.

Legjislacioni në vendet e Ballkanit Perëndimor

Konceptet juridike analoge me ngjarjet e kompensimit

Ekzistojnë disa koncepte ligjore të ngjashme me rastet e kompensimit në juridiksionet e Ballkanit Perëndimor që janë të rëndësishme për kontratën e Partneritetit Publik Privat. Kjo përfshin sa më poshtë vijon:

- a) Parimin e mbrojtjes së interesit publik;*
- b) Pamundësinë e përmbushjes së detyrimeve; dhe*
- c) Rrethanat e ndryshuara.*

Shqipëria

a) Mbrojtja e interesit publik

Sipas termave dhe kushteve të përgjithshme të dokumenteve standarde për koncesionet/Partneritetet Publike Private të punëve civile dhe shërbimeve dhe prokurimin publik, autoriteti publik ka të drejtë të ndërpresë kontratën në çdo kohë, nëse e vlerëson se ndërprerja është në interes të publikut. Nëse autoriteti publik e ndërpret kontratën bazuar në këto arsye, atëherë ai duhet t'i paguajë partnerit privat a) shpërblimin për të gjitha punët e marra në dorëzim dhe të kryera para ndërprerjes së kontratës; dhe b) kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga ndërprerja e kontratës. Partneri privat duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të zbutur dëmin.

b) Pamundësia e përmbushjes së detyrimeve

Nëse një detyrim kontraktual i njëres palë është bërë i pamundur për t'u realizuar dhe nuk është faji i asaj pale, atëherë pala tjetër nuk mund të kërkojë nga kjo palë që të realizojë kontratën ose të paguajë dëmet, përveçse nëse përcaktohet ndryshe në kontratë ose në ligjin në fuqi.

Secila palë do të ketë të drejtë të marrë nga pala tjetër atë që ka dhënë për qëllimin e realizimit të detyrimeve të mbetura në bazë të kontratës (p.sh., kthimi i pagesave të paradhënies).

c) Rrethanat e ndryshuara

Në disa raste, palët në një kontratë të Partneritetit Publik Privat mund të ndryshojnë kontratën, p.sh., kur qëllimi i kontratës nuk mund të përmbushet më, aseti nuk mund të përdoret për shkak të forcës madhore, kuadri ligjor në fuqi për kontratën ka ndryshuar ose ka ndryshime të tjera që ndikojnë në përdorimin e asetit ose në realizimin e shërbimeve.

Bosnja dhe Hercegovina - Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës (Kantoni i Hercegovina-Neretvas)

a) Mbrojtja e interesit publik

Sipas ligjit vendor të koncesionit, nëse për arsye të politikave publike është e nevojshme të kufizohet objekti i koncesionit ose të përshtatet me një situatë të re, atëherë partneri privat duhet të marrë të gjitha masat e urdhëruara nga autoriteti publik. Në raste të tilla, partneri privat do të ketë të drejtë të përfitojë kompensim për dëmet, por pa të drejtën e kompensimit për fitimet e munguara.

b) Pamundësia e përmbushjes së detyrimeve dhe rrethanat e ndryshuara

Sipas së drejtës së përgjithshme të kontratave, nëse, pas lidhjes së kontratës:

- i. Krijohen rrethana që ndikojnë negativisht në performancën e një pale ose nëse qëllimi i kontratës nuk mund të arrihet për shkak të këtyre rrethanave;

- ii. Në të dyja rastet kjo është në një shkallë të tillë që është e qartë se kontrata nuk plotëson më pritshmëritë e palëve; dhe
- iii. Përgjithësisht vlerësohet se do të ishte e padrejtë që kontrata të mbahej në fuqi në këtë formë,

Atëherë, pala, performanca e së cilës ndikohet negativisht, mund të kërkojë ndërprerjen e kontratës.

Sidoqoftë, kontrata nuk mund të ndërpritet nëse pala që pretendon se rrethanat kanë ndryshuar ka qenë e detyruar t'i marrë parasysh këto rrethana në kohën e lidhjes së kontratës ose pala mund t'i kishte shmangur ose kapërcyer ato. Pala që kërkon ndërprerjen e kontratës nuk mund të mbështetet në rrethanat e ndryshuara që kanë lindur pas përfundimit të afatit për përmbushjen e detyrimeve të asaj pale. Palët mund të mos zbatojnë disa rregulla të caktuara të rrethanave të ndryshuara, përveçse nëse kjo është në kundërshtim me parimin e mirëbesimit.

Kontrata e Partneritetit Publik Privat duhet të rregullojë, përveç çështjeve të tjera, paaftësinë e mëvonshme për të zbatuar kontratën, duke përfshirë detaje në lidhje me rrethanat e ndryshuara që çojnë në paaftësi të plotë për të zbatuar kontratën.

Bosnja dhe Hercegovina - (Republika Serbe)

a) Mbrojtja e interesit publik:

Sipas ligjit vendor të koncesionit, marrëveshja e koncesionit mund të ndërpritet nga autoriteti publik për arsye të interesit publik për ndërtimin e objekteve dhe realizimin e punimeve në pronën e koncesionit, në përputhje me rregullat e shpronësimit. Ligji i Republikës Serbe për Partneritetin Publik Privat²⁷ parashikon ndalimin e shpronësimit të pronës së projektit, përveç rasteve kur është në interes publik, rast në të cilin partneri privat mund të kërkojë kompensim të plotë për dëmin e pësuar.

b) Pamundësia e përmbushjes së detyrimeve dhe rrethanat e ndryshuara:

Sipas së drejtës së përgjithshme të kontratave:

- i. Debitori do të lirohet nga përgjegjësia e humbjes nëse dëshmon (a) pamundësinë e tij për të përmbushur detyrime ose (b) vonesa e tij në përmbushjen e detyrimeve është rezultat i rrethanave që kanë ndodhur pas lidhjes së kontratës dhe që ai nuk ka qenë në gjendje t'i eliminojë ose t'i shmangë;
- ii. Nëse, pas lidhjes së kontratës, ndodhin rrethana që ndikojnë negativisht në zbatimin e kontratës nga njëra palë, ose nëse qëllimi i kontratës nuk mund të arrihet për shkak të këtyre rrethanave, dhe në të dyja rastet, kjo gjë është në një shkallë të tillë që është e qartë se kontrata nuk plotëson më pritshmëritë e palëve, dhe se përgjithësisht vlerësohet se do të ishte e padrejtë që kontrata të mbahej në fuqi në këtë formë, atëherë pala,

²⁷ Neni 17 i ligjit të Republikës Serbe për Partneritetin Publik Privat.

performanca e së cilës ndikohet negativisht, mund të kërkojë ndërprerjen e kontratës.

Sidoqoftë, një palë nuk mund të kërkojë që kontrata të ndërpritet nëse ajo palë është vonuar në përmbushjen e detyrimeve të saj, nëse ajo palë ka qenë e detyruar të marrë parasysh rrethanat e ndryshuara në kohën e lidhjes së kontratës ose ajo palë mund t'i kishte shmangur ose kapërcyer ato rrethana. Pala që kërkon zgjidhjen e kontratës nuk mund të mbështetet në rrethanat e ndryshuara që kanë lindur pas mbarimit të afatit për përmbushjen e detyrimeve të asaj pale. Palët mund të mos zbatojnë disa rregulla të caktuara të rrethanave të ndryshuara, përveçse nëse kjo është në kundërshtim me parimin e mirëbesimit.

Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë (IRJM)

a) Rrethanat e ndryshuara - kontratat administrative

Ligji i Maqedonisë parashikon mundësinë e ndryshimit dhe të zgjidhjes së kontratave administrative në rastin e "rrethanave të ndryshuara" (d.m.th., rrethanat që ndodhin pas lidhjes së kontratës administrative dhe që ndikojnë negativisht në zbatimin e kontratës) ose rrethana të tjera të përcaktuara me ligjin sektorial që zbatohet për subjektin e kontratës administrative. Ligji i Maqedonisë nuk tregon se cila nga palët do të kishte të drejtë të ndryshonte ose të ndërpriste kontratën mbi këto baza. Prandaj, mund të argumentohet se kjo mundësi është e disponueshme si për autoritetin publik ashtu edhe për partnerin privat.

Megjithëse kontratat administrative njihen dhe rregullohen me Ligjin e Procedurës së Përgjithshme Administrative të Maqedonisë,²⁸ dhe ndërkohë që kontratat e Partneritetit Publik Privat rregullohen në bazë të Ligjit të Maqedonisë për Partneritetin Publik Privat, është e paqartë nëse kontratat e Partneritetit Publik Privat mund të konsiderohen se janë kontrata administrative në të njëjtën kohë. Mund të argumentohet se disa kontrata të Partneritetit Publik Privat të interpretuara dhe të lidhura në përputhje me Ligjin e Maqedonisë për Partneritetin Publik Privat (d.m.th., me qëllim të kryerjes së shërbimeve publike nga partneri privat) mund të vlerësohet se janë kontrata administrative në të njëjtën kohë. Prandaj, autoriteti publik do të kishte të drejtë të ndryshojë, ndërpresë dhe anulojë kontratat e Partneritetit Publik Privat në përputhje me Ligjin e Maqedonisë për Procedurën e Përgjithshme Administrative.²⁹

b) Rrethanat e ndryshuara - e drejta civile

Sipas së drejtës së Maqedonisë për detyrimet,³⁰ lindja e rrethanave që ndikojnë negativisht në përmbushjen e detyrimeve të njëjës palë, ose nëse për shkak të këtyre rrethanave qëllimi i kontratës nuk mund të arrihet,

²⁸ Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative, botuar në Fletoren Zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr. 124/2015 (Ligji i Maqedonisë për Procedurën e Përgjithshme Administrative).

²⁹ Nenet 99, 100 dhe 101 të Ligjit të Maqedonisë për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

³⁰ Neni 122 i Ligjit të Maqedonisë për detyrimet, botuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr. 18/2001, i ndryshuar.

atëherë pala që ka vështirësi në përmbushjen e detyrimeve të saj, mund të kërkojë ndërprerjen e kontratës. Në secilin rast, kontrata do të ndërpritet nëse nuk plotëson pritshmëritë e palëve dhe mbajtja e saj në fuqi do të ishte e padrejtë.

Ndërprerja e kontratës nuk mund të kërkohet nëse pala që pretendon rrethanat e ndryshuara kishte për detyrë që, në kohën e lidhjes së kontratës, t'i merrte parasysh këto rrethana, ose nëse ajo palë mund t'i kishte shmangur ose kapërcyer ato rrethana. Pala që kërkon zgjidhjen e kontratës nuk mund të mbështetet në rrethana të ndryshuara që kanë lindur pas mbarimit të afatit për përmbushjen e detyrimeve të asaj pale. Në mënyrë alternative, në bazë të Ligjit të Maqedonisë për detyrimet, palët mund të vendosin të ndryshojnë kontratën.

Nëse kontrata ndërpritet për shkak të rrethanave të ndryshuara, atëherë pala e dëmtuar mund të kërkojë kompensim për humbjen e pësuar si rezultat i ndërprerjes.

Kur vendoset që kontrata të ndërpritet ose të ndryshohet, atëherë gjykata do t'i referohet parimeve të marrëdhënies së drejtë, veçanërisht duke marrë parasysh qëllimin e kontratës, risqet tipike që lidhen me këtë lloj kontrate, interesin publik dhe interesat e të dyjave palëve.³¹

c) Pamundësia e përmbushjes së detyrimeve

Sipas së drejtës së Maqedonisë për detyrimet³² nëse përmbushja e një detyrimi nga një palë në një kontratë e dyanshme bëhet e pamundur për shkak të një ngjarje që:

- i. Nuk është shkaktuar nga asnjë palë;
- ii. Ka ndodhur pas hyrjes në fuqi të kontratës, por përpara datës në të cilën duhet të përmbushet ai detyrim; dhe
- iii. Nuk mund të ishte parashikuar, parandaluar, shmangur ose eliminuar nga pala përkatëse,

Atëherë kjo do të konsiderohet si një ngjarje e forcave madhore që e ndërpret atë detyrim.

Nëse njëra nga palët i ka përmbushur detyrimet e saj, pjesërisht ose plotësisht, atëherë ajo palë mund të kërkojë shpërblim për humbjet në përputhje me rregullat e shpërblimit për humbjet në rast të begatimit pa shkak.

Në rast të pamundësisë së pjesshme të përmbushjes së detyrimeve kontraktuale për shkak të ngjarjeve që nuk janë shkaktuar nga asnjë palë, njëra palë mund të ndërpresë kontratën nëse zbatimi i pjesshëm i kontratës nuk i plotëson nevojat e saj. Përndryshe, kontrata do të mbetet në fuqi, ndërsa pala tjetër do të ketë të drejtë të kërkojë uljen proporcionale të detyrimeve të saj.

³¹ Neni 124 i Ligjit të Maqedonisë për detyrimet.

³² Neni 126 i Ligjit të Maqedonisë për detyrimet.

Ligji i Maqedonisë për detyrimet nuk tregon se cilat raste mund të konsiderohen si ngjarje të forcës madhore dhe as nuk parashikon ndonjë rregull të mëtejshëm në lidhje me këtë. Megjithëse palët në një kontratë të Partneritetit Publik Privat do të kishin lirinë për të rënë dakord për formulimin, dhe klauzola e forcës madhore do të duhet të jetë në përputhje me rregullat e përgjithshme për pamundësinë e përmbushjes së detyrimeve sipas Ligjit të Maqedonisë për detyrimet, siç përshkruhet më lart.

Kosova*

a) Mbrojtja e interesit publik

Partneritetet Publike Private i nënshtrohen parimit të mbrojtjes së interesit publik.³³ Kontrata e Partneritetit Publik Privat mund të tregojë rrethana që lidhen me mbrojtjen e interesit publik. Ndodhja e këtyre rrethanave do t'i jepte autoritetit publik një të drejtë të ndryshonte kontratën e Partneritetit Publik Privat në mënyrë të njëanshme.

b) Pamundësia e përmbushjes së detyrimeve

Nëse përmbushja e detyrimeve sipas kontratës bëhet e pamundur për njërën palë për shkak të ndodhjes së një ngjarje ose të një rrethane për të cilën nuk është përgjegjëse asnjë palë, atëherë pala tjetër nuk është e detyruar të përmbushë detyrimet e veta sipas kontratës (Neni 120 i Ligjit të Kosovës për detyrimet). Në një rast të tillë, pala që ka përmbushur një pjesë të detyrimeve të saj mund të kërkojë shpërblim për humbjet në përputhje me rregullat e shpërblimit për humbjet në rast të begatimit pa shkak, d.m.th., të marrë atë që i ka dorëzuar palës tjetër si përmbushje të kontratës ose të kompensohet për vlerën e fitimit të fituar nga pala tjetër.

Në rast të pamundësisë së pjesshme të zbatimit të kontratës për shkak të ngjarjeve që nuk janë shkaktuar nga asnjë prej palëve, njëra palë mund të ndërpresë kontratën nëse zbatimi i pjesshëm i kontratës nuk i plotëson nevojat e asaj pale. Në rast të kundërt, kontrata do të mbetet e vlefshme, ndërsa pala tjetër do të ketë të drejtë të përfitojë ulje proporcionale të detyrimeve të saj.

c) Rrethanat e ndryshuara

Si parim i përgjithshëm i ligjit të kontratave (Neni 116 i Ligjit të Kosovës për detyrimet), nëse:

- i. Pas lidhjes së kontratës, ndodhin rrethana që e bëjnë të vështirë për njërën palë të përmbushë detyrimet e saj sipas kontratës ose qëllimi i kontratës nuk mund të arrihet;*
- ii. Është e qartë se kontrata nuk korrespondon me atë që fillimisht pritej nga palët; dhe*
- iii. Do të ishte e padrejtë që kontrata të mbahej e pandryshuar,*

³³ Neni 4 i Ligjit për Partneritetin Publik Privat.

Atëherë pala që nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet e saj për të arritur qëllimin e kontratës mund të kërkojë që kontrata të zgjidhet ose të ndryshohet. Kontrata nuk do të përfundojë nëse pala që pretendon për rrethanat e ndryshuara kishte detyrimin, në kohën e lidhjes së kontratës, që t'i merrte parasysh ato rrethana, mund të kishte parandaluar ndodhjen e tyre ose mund t'i kishte lehtësuar ato.

Palët mund të heqin dorë nga e drejta për të kërkuar paraprakisht ndonjë rrethanë specifike të ndryshuar, nëse kjo heqje dorë nuk bie ndesh me parimin e ndërgjegjes dhe drejtësisë.

Mali i Zi

Sipas ligjit të Malit të Zi për Procedurën Administrative, kontrata administrative mund të ndryshohet ose të zgjidhet në rrethanat që ndodhin pas fillimit të saj që nuk mund të ishin parashikuar në kohën e lidhjes së asaj kontrate dhe që ndikojnë negativisht në zbatimin e kontratës.

Ndodhja e rrethanave të ndryshuara mund të rezultojë në sa më poshtë vijon:

- a) Pëzullimin e të drejtave dhe detyrimeve sipas kontratës së koncesionit, në bazë të Ligjit të Malit të Zi për koncesionet; dhe*
- b) Ndryshimin ose zgjidhjen e kontratës së koncesionit në bazë të Ligjit të Malit të Zi për Procedurën Administrative.*

Serbia

- a) Mbrojtja e interesit publik*

Ligji i Serbisë për Partneritetin Publik Privat siguron bazën e ndërprerjes së kontratës për arsye të interesit publik. Sidoqoftë, koncepti i interesit publik nuk është përcaktuar në mënyrë specifike dhe as nuk ka ndonjë praktikë të qartë të tregut që do të hedhë më shumë dritë në këtë çështje. Kjo mund t'i sigurojë autoritetit publik një diskrecion të gjerë për interpretimin e objektit të kësaj baze për ndërprerjen e kontratës.

- b) Rrethanat e ndryshuara*

Koncepti i rrethanave të ndryshuara parashikon mundësinë e ndërprerjes ose të ndryshimit të një kontrate të Partneritetit Publik Privat në rrethana të caktuara.

Nëse, pas lidhjes së kontratës:

- i. Krijohen rrethana që ndikojnë negativisht në performancën e njëres palë ose nëse qëllimi i kontratës nuk mund të arrihet për shkak të ekzistencës së këtyre rrethanave;*
- ii. Kjo gjë është në një shkallë të tillë që tregon qartë se kontrata nuk plotësojë më pritshmëritë e palëve; dhe*
- iii. Përgjithësisht vlerësohet se do të ishte e padrejtë që kontrata të mbahej në fuqi në këtë formë,*

Atëherë pala, performanca e së cilës ndikohet negativisht, mund të kërkojë ndërprerjen e kontratës.

Sidoqoftë, ndërprerja e kontratës nuk mund të kërkojë nëse pala që i referohet rrethanave të ndryshuara ka qenë e detyruar t'i marrë parasysh këto rrethana në kohën e lidhjes së kontratës ose pala mund t'i kishte shmangur ose kapërcyer ato. Pala që kërkon zgjidhjen e kontratës nuk mund të mbështetet në rrethanat e ndryshuara që kanë lindur pas mbarimit të afatit për përmbushjen e detyrimeve të asaj pale.

Palët mund të mos zbatojnë rregullin e rrethanave të ndryshuara, nëse kjo nuk është në kundërshtim me parimin e mirëbesimit.

Në mënyrë tipike, të gjitha pagesat që do të bëhen nga Qeveria (përfshirë kompensimin e dëmeve dhe të ndërprerjes së kontratës) duhet të parashikohen në buxhetin e saj vjetor. Prandaj, për të parandaluar situatën ku Qeveria nuk do të jetë në gjendje t'i paguajë partnerit privat dëmshpërblim ose kompensim për ndërprerjen e kontratës kur është e detyrueshme që ato të paguhet, Qeveria duhet të alokojë fonde të mjaftueshme për qëllimin e pagesave të mundshme shtesë në lidhje me projektin në buxhetin e saj.

9.2.4 Rastet e kompensimit të bazuara në vlerën e parasë

Më poshtë janë dhënë shembuj të dispozitave që mund të hartohen për t'u marrë me risqe të veçanta të projektit që lidhen me truallin:

- **Kontaminimi mjedisor:** autoriteti publik mund të pranojë që të kompensojë partnerin privat për kostot që lidhen me rregullimin e kontaminimit të mjedisit që është i pranishëm në truall, në atë masë që kostoja faktike të ketë qenë më e madhe se një shumë e përcaktuar. Kjo qasje mund të përdoret nëse nuk është e mundur që partneri privat të bëjë një vlerësim të arsyeshëm (dhe kostimin) e sasisë së punës riparuese që kërkojë derisa puna të bëhet realisht. autoriteti publik mund të vlerësojë se nuk është në interesin publik (vlera e parasë) që t'i kërkojë partnerit privat që ai të çmojë një risk që ai nuk është në gjendje ta vlerësojë nga ana sasiore;
- **Kushtet gjeologjike:** autoriteti publik mund të pranojë që të kompensojë partnerin privat nëse kushtet gjeologjike të truallit janë thelbësisht të ndryshme nga ato që i janë paraqitur partnerit privat gjatë procesit të tenderimit dhe që formojnë bazën e kontratës së Partneritetit Publik Privat. Kur partneri privat (dhe ofertuesit e tjerë të projektit) nuk janë në gjendje të ndërmarrin hetime shtesë të arsyeshme gjatë procesit të tenderimit, atëherë autoriteti publik mund të vlerësojë se nuk është në interesin publik (vlera e parasë) që t'i kërkojë partnerit privat të çmojë një risk që ai nuk ka qenë në gjendje ta vlerësojë nga ana sasiore; dhe
- **Aksesi në tokën e palës së tretë:** autoriteti publik mund të pranojë që të kompensojë partnerin privat nëse disa palë të treta të lidhura me projektin (p.sh., autoritetet hekurudhore) refuzojnë t'i sigurojnë partnerit privat akses në pronën e tyre në mënyrë që ta ndërtojë dhe ta përdorë projektin për arsye që partneri privat nuk mund t'i kishte parashikuar në kushte të arsyeshme.

Është praktikë e mirë që autoriteti publik të diskutojë risqe të ngjashme specifike të projektit me partnerët privatë dhe të përfshijë një mekanizëm në kontratën e Partneritetit Publik Privat që i mundëson partnerit privat të përcaktojë në mënyrë sasiore humbjen e tij maksimale në rast se gjatë afatit të kontratës së Partneritetit Publik Privat ndodh një risk që mund të mos përcaktohet në mënyrë sasiore.

9.3 Rastet e ndihmës (rastet e vonesës)

9.3.1 Përkufizimi i ndihmës (rasti i vonesës)

Rasti i ndihmës (ose rasti i vonesës) është një ngjarje që është jashtë kontrollit të partnerit privat, por që partneri privat konsiderohet si më i miri për ta menaxhuar atë.

Shembuj të ngjarjeve të tilla mund të përfshijnë sa më poshtë vijon:

- a) Zjarri, shpërthimi, rrufeja, stuhia, shtrëngata, përmytja, shpërthimi ose tejmbushja e rezervuarëve të ujit, pajisjeve ose tubave, tërmetet, trazirat dhe rrëmujat civile;
- b) Humbje aksidentale (ose dështim) i projektit ose infrastrukturës tjetër tek e cila partneri privat mbështetet për projektin;
- c) Çdo defekt ose mungesë energjie, karburanti ose transporti;
- d) Mosmarrëveshjet e punës në të gjithë industrinë, ngadalësimi i punës ose grevat;
- e) Vonesa në marrjen e lejeve ose autorizimeve;
- f) Ankimet ligjore kundër lejeve, licencave ose autorizimeve për projektin; dhe
- g) Ngjarje të tjera që janë të rëndësishme për t'u përfshirë rasti pas rasti.

9.3.2 Mbrojtja nga ndikimi financiar i një rasti ndihme

Mënyrat për të mbrojtur partnerin privat ndaj ndikimit financiar (d.m.th., kostot e rritura ose humbja e të ardhurave) të një rasti ndihme klasifikohen përgjithësisht në tre kategori:

- a) **Pa kompensim:** Partneri privat pritet të menaxhojë dhe/ose zbusë pasojat financiare të ngjarjeve të tilla;
- b) **Kompensimi paguhet vetëm pasi të ketë kaluar një periudhë fillestare:** Asnjë kompensim nuk i paguhet partnerit privat për një periudhë fillestare të përcaktuar (p.sh., 7 ditë), por pas kësaj periudhe autoriteti publik kompenson partnerin privat për çdo kosto të rritur dhe zgjat afatin e kontratës së Partneritetit Publik Privat aq sa është periudha e vonesës në përfundimin e ndërtimit e shkaktuar nga ngjarja; dhe
- c) **Partnerit privat i paguhet kompensim:** kompensimi zakonisht paguhet me një normë më të ulët sesa paguhet për një rast kompensimi. Për shembull, autoriteti publik mund t'i paguajë kompensim partnerit privat si më poshtë vijon:
 - i. Një tarifë që ka për qëllim t'i mundësojë partnerit privat që ai t'i shërbejë borxhit të tij të vjetër për periudhën (d.m.th., me një normë më të ulët se humbja faktike e të ardhurave të partnerit privat); ose

- ii. Një tarifë që ka për qëllim që të garantojë se risku i humbjes së ardhurave për periudhën ndahet ndërmjet partnerit privat dhe autoritetit publik (p.sh., norma e kompensimit përcaktohet në një nivel që barazohet me 50% të të ardhurave që partneri privat do të kishte përfituar në rrethana të ndryshme); ose
- iii. Për çdo kosto të rritur që ka tejkalluar një prag të përcaktuar (p.sh. 50,000 Euro).

Zakonisht, autoriteti publik nuk do të paguajë ndonjë kompensim nëse ndikimi financiar i ndonjë rasti ndihme mund të sigurohet nga partneri privat.

9.3.3 Lehtësimi nga pasojat jo-financiare të një rasti ndihme

Zakonisht partnerit privat i jepet një zgjatje afati kur rastet ndihmës shkaktojnë vonesa në përfundimin e ndërtimit (dhe rrjedhimisht fillimin e funksionimit). Gjithashtu, partneri privat çlirohet nga çdo detyrim për t'i paguar autoritetit publik dëmet e konstatuara për shkak të vonesës.

Gjatë fazës së funksionimit, periudhat e padisponueshmërisë të shkaktuara nga rastet e ndihmës shpesh injorohen për qëllime të përcaktimit nëse një mosekzekutimi i detyrimeve nga partneri privat (d.m.th., rast i ndërprerjes së kontratës) ka ndodhur në bazë të kontratës së Partneritetit Publik Privat. Shkalla në të cilën partnerit privat i bëhet zbritje për padisponueshmërinë do të varet nga projekti.

Mënyrat e ndryshme të përdorura për këtë gjë përfshijnë sa më poshtë vijon:

- a) Nisur nga fakti që partneri privat mund të sigurohet ose për riskun e ngjarjes (p.sh., humbja fizike e një ure e shkaktuar nga një risk i siguar) ose sepse ngjarja nuk pritet të vazhdojë për periudha të gjata kohore (p.sh., mbyllja e një ure të shkaktuar nga erërat e larta), atëherë vazhdon të zbatohet regjimi i zbritjeve; ose
- b) Zbritjet bëhen vetëm në atë masë sa partneri privat mund të bëjë sigurimin e humbjes së të ardhurave të shkaktuar nga zbritjet; dhe
- c) Zbritjet bëhen, por me një normë të zvogëluar. Për shembull, mund të mos përdoret një shumëzues që zakonisht do të përdorej për zbritjet që bëhen për periudha të zgjatura (të vazhdueshme) të padisponueshmërisë.

9.3.4 Ndërprerja e parakohshme e kontratës për shkak të një rasti të zgjatur të ndihmës

autoriteti publik mund të lejojë secilën palë të ndërpresë kontratën e Partneritetit Publik Privat kur një rast ndihme vazhdon për një periudhë të vazhdueshme dhe të zgjatur (p.sh., 180 ditë).

Në këto rrethana, autoriteti publik mund t'i paguajë partnerit privat kompensimi e ndërprerjes. Niveli i kompensimit është shpesh i njëjtë me atë që paguhet në rast të ndërprerjes së parakohshme që ndodh për shkak të ngjarjeve të zgjatura të forcës madhore, megjithëse në disa raste mund të paguhet një normë pak më e lartë kompensimi. (Sidoqoftë, kjo do të ishte më e ulët se shuma e paguar në rast të ndërprerjes së parakohshme për shkak të mosekzekutimit të detyrimeve nga e autoritetit publik).

Qasja e fundit mund të realizohet në disa mënyra; për shembull, duke përdorur një normë më të lartë zbritje sesa ajo që do të përdorej në skenarin e mosekzekutimit të detyrimeve nga autoriteti publik për qëllime të vlerësimit të kapitalit.

9.4 Rastet e forcës madhore

9.4.1 Përkufizimi i rastit të forcës madhore

Koncepti i *forcës madhore* është i njohur në kontratat e Partneritetit Publik Privat në të gjithë BE-në (qoftë si çështje e kontratës dhe/ose në ligjin përkatës ose praktikën gjyqësore).

Kur forca madhore është e përkufizuar në kontratën e Partneritetit Publik Privat, atëherë jepet një listë e ngjarjeve që përbëjnë forcën madhore, zakonisht duke përfshirë një kombinim të elementëve të mëposhtëm:

- a) Lufta, lufta civile, konflikti i armatosur, revolucioni ose terrorizmi;
- b) Shpërthime bërthamore, rrezatime jonizuese ose ndotje radioaktive, kimike ose biologjike;
- c) Valët e presionit të shkaktuara nga një aeroplan që udhëton me shpejtësi supersonike;
- d) Rrëzimi i avionit;
- e) Katastrofat natyrore si tërmetet, rrëshqitjet e tokës, rrufetë, përmytjet, stuhitë, ciklonet, dhe rrethana të tjera ekstreme klimatike ose mjedisore, me kusht që ato të njihen si fatkeqësi natyrore nga autoritetet;
- f) Zjarre dhe shpërthime (që nuk janë shkaktuar nga partneri privat ose nga nënkontraktorët ose përfaqësuesit e tij);
- g) Shpërthimi i eksplozivëve; ose
- h) Greva, protesta ose trazira.

9.4.2 Trajtimi i mos-performancës së shkaktuar nga një rast i forcës madhore

Si në rastet e kompensimit, ashtu edhe në rastet e Ndhmës, partneri privat do të çlirohet nga çdo shkelje e kontratës që ndodh si rezultat i një ngjarje të forcës madhore. Partnerit privat zakonisht i jepet një zgjatje afati për sa i përket vonesave të mëvonshme në përfundimin e ndërtimit ndërkohë që ai çlirohet nga çdo kërkesë për pagimin e dëmeve të konstatuara në lidhje me një periudhë të tillë vonese.

Nga këndvështrimi kontraktor, ndryshimi kryesor midis një ngjarje të forcës madhore dhe një rasti ndihme është se secila palë ka mundësinë të ndërpresë kontratën e Partneritetit Publik Privat për një ngjarje të zgjatur të forcës madhore (qoftë si çështje kontrate apo si çështje ligjore).

Sipas rrethanave, ekzistojnë dy karakteristika kryesore të kontratës së Partneritetit Publik Privat që do të përcaktojnë metodën që përdoret nga autoriteti publik për të siguruar ndihmë lidhur me mos-performancën e shkaktuar nga një ngjarje e forcës madhore:

- a) Periudha kohore gjatë së cilës duhet të ekzistojë një ngjarje e forcës madhore përpara se secila palë të ndërpresë kontratën; dhe

- b) Shuma e kompensimit që i paguhet partnerit privat nga autoriteti publik gjatë ekzistencës së ngjarjes së forcës madhore.

Periudha kohore që duhet të kalojë para se të mund të ndërpritet kontrata e Partneritetit Publik Privat për shkak të forcës madhore ka tendencë të jetë më e shkurtër në kontratat ku partneri privat nuk merr asnjë kompensim financiar gjatë vazhdimit të ngjarjes së forcës madhore. Në këto kontrata të Partneritetit Publik Privat, e drejta e ndërprerjes së kontratës ka prirje që të lindë kur ngjarja e forcës madhore ka vazhduar për 180 ditë (gjashtë muaj) ose më shumë.

Shkalla në të cilën paguhet kompensimi (ose çlirimi nga zbritjet që bëhet në bazë të mekanizmit të pagesës) gjatë vazhdimit të një ngjarje të forcës madhore zakonisht do të pasqyrojë metodën e përdorur për të njëjtën çështje në kontekstin e rasteve të ndihmës. Metoda e përdorur mund të variojë duke nisur nga situata ky palët mbulojnë humbjet e tyre dhe kostot e shkaktuara gjatë vazhdimit të një ngjarje të forcës madhore (para ndërprerjes së kontratës), e duke shkuar deri në situatën ku autoriteti publik e paguan partnerin privat sikur ai të ishte duke punuar sipas kërkesave të kontratës së Partneritetit Publik Privat.

Legjislacioni në vendet e Ballkanit Perëndimor

Forca madhore (ose konceptet e llojit të forcës madhore) njihen ose në kontrata, në ligje (megjithëse pa përkufizim të hollësishëm) ose në praktikën gjyqësore në të gjithë vendet e Ballkanit Perëndimor. Koncepti i forcës madhore nuk mund të diferencohet në mënyrë strikte nga doktrina e rrethanave të ndryshuara ose pamundësia e përmbushjes së detyrimeve. Prandaj, shpesh mund të ndodhë që ngjarja e forcës madhore do të jetë një rrethanë e ndryshuar ose do ta bëjë të pamundur zbatimin e kontratës së Partneritetit Publik Privat (shih gjithashtu edhe pjesën e mësipërme për pamundësinë e përmbushjes së detyrimeve sipas Ligjit të Maqedonisë, sipas të cilit pamundësia e përmbushjes së detyrimeve përbën një ngjarje të forcës madhore).

Duhet të merren parasysh gjithashtu edhe përqasjet specifike sipas legjislacionit në fuqi të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Bosnja dhe Hercegovina - Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës (HNC)

Kontrata e Partneritetit Publik Privat duhet të japë një përkufizim të forcës madhore dhe të pasojave të ndodhjes së saj. Dispozitat e forcës madhore zakonisht përfshijnë një dispozitë që përcakton se asnjë nga palët nuk do të ketë përgjegjësi për mos përmbushjen e detyrimeve të saj sipas kontratës në atë masë që përmbushja e këtyre detyrimeve është vonuar ose është bërë e pamundur nga forca madhore.

Mali i Zi

Sipas ligjit të Malit të Zi për koncesionet, në rastin e forcës madhore ose të një ngjarje e jashtëzakonshme që ka penguar një palë që të kryejë aktivitete koncesionare që nuk mund të ishin parashikuar në kohën e lidhjes së kontratës, të drejtat dhe detyrimet në bazë të kontratës pezullohen deri në momentin që të

pushojë forca madhore ose ngjarja e jashtëzakonshme. autoriteti publik vendos nëse do të pezullojë apo jo kontratën në bazë të një kërkesë me shkrim nga partneri privat. Sidoqoftë, Ligji i Malit të Zi për koncesionet nuk përkufizon forcën, madhore ose ngjarje e jashtëzakonshme. Përkundrazi, ai kërkon që kontrata e koncesionit të rregullojë, ndër të tjera, sa më poshtë vijon:

- a) Kushtet për ndryshime ose ndërprerje të kontratës në rast të rrethanave të ndryshuara dhe forcës madhore;*
- b) Rastet që do të konsiderohen si rrethana të ndryshuara dhe forcë madhore;*
- c) Kushtet e ndërprerjes së kontratës së koncesionit; dhe*
- d) Gjobat dhe tarifatat për shkeljen e kontratës.*

Serbia

Ligji i Serbisë për kontratat nuk përmban ndonjë përkufizim të forcës madhore. Sidoqoftë, sipas praktikës gjyqësore, forca madhore kuptohet si një ngjarje natyrore ose një veprim, për të cilin njerëzit nuk janë fajtorë, që nuk është i paparashikueshëm dhe nuk mund të kapërcehet, dhe si rezultat i së cilës ka ndodhur dëmi.

Pala që nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet e saj për shkak të forcës madhore nuk do të jetë përgjegjëse për dëmet ndaj palës tjetër, d.m.th, nuk do të jetë e detyruar të zbatojë kontratën. Në këtë drejtim, Ligji i Serbisë për Partneritetin Publik Privat shprehet që palët janë të lira të përcaktojnë shkallën në të cilën një palë mund të çlirohet nga përgjegjësia për mos-performancë ose performancë të vonuar për shkak të rrethanave jashtë kontrollit të saj. Kjo do të thotë që palët mund të zgjedhin të rregullojnë pasojat e ndodhjes së një ngjarje të forcës madhore në masën e lejuar sipas parashikimeve ligjore të detyrueshme.

10. Ndryshimet ligjore

Sipas kontratës së Partneritetit Publik Privat, partnerit privat i kërkohet të respektojë të gjitha ligjet që zbatohen për të dhe projektin. Duke pasur parasysh që kontratat e Partneritetit Publik Privat shpesh janë afatgjata (p.sh., 20 deri në 30 vjet), ekziston një mundësi e madhe që ato të preken nga ndryshimet aktet ligjore dhe nënligjore kombëtare, p.sh., taksat e reja që ndikojnë në projekt. Një ndryshim në ligj mund ta bëjë përmbushjen e detyrimeve të partnerit privat sipas kontratës së Partneritetit Publik Privat plotësisht ose pjesërisht të pamundur, më të kushtueshme ose të vonuar. Prandaj, është e rëndësishme të tregohet në kontratën e Partneritetit Publik Privat se cila nga palët do të mbajë riskun e një ndryshimi në ligj. Ndryshimi i një klauzole ligjore e trajton këtë çështje.

Risku i ndryshimit në ligj zakonisht i përket autoritetit publik në bazë të faktit se është një risk i paparashikueshëm që është nën kontrollin e tij.

Në shumë kontrata të Partneritetit Publik Privat, niveli i mbrojtjes në dispozicion të partnerit privat është i cilësuar, për shembull:

- **Ndryshimet e parashikueshme ligjore:** kontrata e Partneritetit Publik Privat mund të shprehet që partneri privat nuk gëzon asnjë mbrojtje në lidhje me një ndryshim në ligj që ka qenë i parashikueshëm përpara se të nënshkruhet kontrata e Partneritetit Publik Privat. Kontrata e Partneritetit Publik Privat duhet të përcaktojë se çfarë do të thotë *e parashikueshme*, por kostot e ardhshme të ndryshimeve të tilla në ligj zakonisht pritet të përfshihen në çmimin e kontratës nga partneri privat.
- **Ndryshimet e përgjithshme ligjore:** kontrata e Partneritetit Publik Privat mund të kërkojë të cilësohet shkalla në të cilën partneri privat mund të kërkojë kompensim nga Qeveria në lidhje me ndryshimet e përgjithshme në ligj (d.m.th., ndryshimet në ligj që prekin të gjitha bizneset në vendin përkatës, siç është rritja e tatimit të fitimit). Këto cilësime mund të marrin një (ose të dyja) prej dy formave të mëposhtme:
 - a) *Ndryshimet e kostove operative* – kontrata e Partneritetit Publik Privat nuk e lejon partnerin privat të kërkojë kompensim nga autoriteti publik për rritjen e parashikuar të kostove të funksionimit që vijnë si rezultat i një ndryshimi të përgjithshëm në ligj për shkak se mekanizmi i indeksimit i përfshirë në kontratën e Partneritetit Publik Privat siguron mbrojtje të mjaftueshme kundër këtij risku; dhe
 - b) *Rritjet e kostove kapitale* – kontrata e Partneritetit Publik Privat kërkon që partneri privat të ndajë riskun e shoqëruar me rritjen e kostove të kapitalit që vijnë nga ndryshimet e përgjithshme në ligj. Në këtë rast, ekspozimi maksimal financiar i Partnerit privat shpesh është i kufizuar, duke i mundësuar partnerit privat të vlerësojë riskun në ofertën e tij për projektin.

Legjislacioni në vendet e Ballkanit Perëndimor

Në disa juridiksione të Ballkanit Perëndimor, nëse ndodh një ndryshim i ligjit, partneri privat mund të ketë të drejtë të bëjë kërkesë ose të kërkojë që kontrata të zgjidhet ose të ndryshohet në bazë të doktrinës së pamundësisë së përmbushjes së detyrimeve ose rrethanave të ndryshuara (shiko Seksionin 8, Trajtimi i ngjarjeve të paparashikuara).

Kontrata e Partneritetit Publik Privat mund të përfshijë dispozita që sigurojnë se nëse kostot dhe/ose shpenzimet e partnerit privat zvogëlohen si rezultat i një ndryshimi në ligj, atëherë partneri privat nuk duhet të përfitojë përsëri nga një fitim i papritur.

Ligji shqiptar dhe ai serb parashikojnë në mënyrë të qartë mundësinë e përfshirjes së një klauzole të stabilizimit në kontratë për të mbrojtur partnerin privat ndaj pasojave të një ndryshimi në ligj që ndikon negativisht tek partneri privat ose tek projekti (shih gjithashtu Seksionin 8).

11. Kërkesat e sigurimeve

Dispozitat kryesore që kanë të bëjnë me sigurimet në kontratat e Partneritetit Publik Privat përshkruajnë se çfarë siguri duhet të bëhet dhe nga kush, për sa dhe me çfarë termash dhe kushtesh. Kjo pjesë e kontratës ka shumë aspekte teknike që normalisht do të kërkojnë këshillën e një këshilltari të specializuar të sigurimeve. Kontrata kryesore e Partneritetit Publik Privat shpesh shoqërohet me një program të veçantë që përshkruan kërkesat e sigurimeve specifike që duhet të përmbushen nga partneri privat.

11.1.1 Objekti i kërkesave të sigurimeve

Në përgjithësi, partneri privat ka një interes të sigurueshëm për projektin si gjatë fazës së ndërtimit ashtu edhe gjatë fazës së funksionimit. Kjo do të thotë që autoriteti publik mund t'ia transferojë përgjegjësinë partnerit privat për të bërë sigurimet në lidhje me projektin.

Megjithëse partneri privat stimulohet në mënyrë të natyrshme (bazuar në alokimin e riskut në kontratën e Partneritetit Publik Privat) që të zbusë risqe të caktuara duke bërë sigurime, autoriteti publik mund të përfshijë dispozita në kontratën e Partneritetit Publik Privat, duke specifikuar sigurimin e veçantë që partneri privat duhet të bëjë. Duke përshkruar kërkesat minimale të sigurimit (nganjëherë të quajtura *sigurime të kërkuara*) në kontratën e Partneritetit Publik Privat, autoriteti publik mund të jetë i bindur se projekti do të mbrohet në mënyrë të duhur nga ndikimi i risqeve të sigurueshme.

Sigurimet e kërkuara për secilën nga fazat e ndërtimit dhe të funksionimit të projektit mund të përcaktohen në kontratën e Partneritetit Publik Privat në lidhje me sa më poshtë vijon:

- **Sigurimi i dëmshpërblimit profesional:** autoriteti publik do të kërkojë siguri që nënkontraktori i ndërtimit i partnerit privat do të ketë burime të mjaftueshme financiare për të mbështetur çfarëdo detyrimi që mund të lindë në lidhje me defektet e ndërtimit. Prandaj, autoriteti publik mund t'i kërkojë nënkontraktorit të ndërtimit të bëjë sigurimin e dëmshpërblimit profesional që plotëson një sërë kërkesash minimale të përcaktuara.
- **Sigurimi i dëmtimit të pasurisë:** megjithëse herë pas here quhet siguri nga të gjitha risqet e ndërtimit gjatë fazës së ndërtimit, qëllimi i këtij siguri është t'i japë autoritetit publik besim se nëse projekti (ose një pjesë e tij) dëmtohet ose shkatërrohet nga një risk i sigurueshëm, atëherë Partneri privat do të ketë burimet financiare të mjaftueshme në dispozicion për të rikuperuar atë.
- **Sigurimi i përgjegjësisë publike:** si autoriteti publik ashtu dhe partneri privat do të kenë përgjegjësi të mundshme juridike ndaj palëve të treta në lidhje me projektin. Për shembull, partneri privat mund të jetë i ekspozuar ndaj kërkesave për dëmshpërblim nga palët e treta nëse i kryen punimet në mënyrë të pakujdesshme ose shkel kërkesat ligjore. autoriteti publik gjithashtu mund të jetë i ekspozuar ndaj kërkesave për dëmshpërblim nga palët e treta në lidhje me një veprim ose mosveprim të partnerit privat. Për ta trajtuar këtë çështje, kontrata e Partneritetit Publik Privat mund t'i kërkojë partnerit privat që të bëjë sigurimin e përgjegjësisë publike që mbulon të dy palët.

- **Sigurimi i vonesës së fillimit/ndërprerjes së punës:** nëse infrastruktura është e dëmtuar dhe kërkon rikuperim, atëherë partneri privat zakonisht mund të bëjë sigurimin për të ardhurat që ai humbet gjatë periudhës së rikuperimit. Ky sigurim përmendet shpesh si sigurimi i vonesës së fillimit (gjatë fazës së ndërtimit) dhe sigurimi i ndërprerjes së punës (gjatë fazës së funksionimit të projektit).

Dispozitat e secilës nga sigurimet e kërkuara duhet të marrë parasysh çështjet e mëposhtme:

- **Emërtimi si palë e siguruar:** përveç dëmshpërblimit profesional dhe sigurimit të vonesës së fillimit/ndërprerjes së biznesit, autoriteti publik mund të kërkojë që të quhet si një palë e bashkë-siguruar në secilin nga sigurimet e kërkuara. Kjo kërkesë reflekton interesin e sigurueshëm që autoriteti publik ka në projekt dhe i jep mundësinë që të kërkojë dëmshpërblim në bazë të sigurimit përkatës në rast të ndonjë humbje.
- **Mbrojtja kundër rrëzimit të kërkesës për dëmshpërblim:** qëllimi i kësaj mbrojtje është të sigurojë që kërkesa për dëmshpërblim e bërë nga autoriteti publik nuk mund të rrëzohet nga siguruuesi bazuar në mosrepektimin e kushteve të policës së sigurimit nga partneri privat.
- **Heqja dorë nga zëvendësimi:** kjo dispozitë mbron autoritetin publik ndaj çdo risku të siguruuesit që ndjek autoritetin publik në lidhje me çdo kërkesë për dëmshpërblim të paraqitur nga partneri privat në bazë të sigurimeve të kërkuara.
- **Zbritjet maksimale:** çdo kërkesë për dëmshpërblim shpesh do t'i nënshtrohet një shume (të zbritshme) që duhet të mbahet nga pala e siguruar para se siguruuesi të paguajë të ardhurat e sigurimit. Niveli i zbritjes i lidhur me policën përkatëse të sigurimit do të ndikojë në primin e sigurimit që duhet të paguhet. autoriteti publik mund të vendosë në kontratë nivele maksimale të zbritjes.
- **Shuma e siguruar:** kontrata e Partneritetit Publik Privat mund të përcaktojë një kërkesë për bazën e shumës së llogaritur që do të sigurohet nga partneri privat. Për shembull, në kontekstin e një projekti akomodimi, autoriteti publik kërkon që vlera e plotë e rikuperimit të pronës të sigurohet në bazë të sigurimit të dëmit të pronës.

Pavarësisht nga sigurimet e kërkuara që përcaktohen në kontratën e Partneritetit Publik Privat, Partneri privat mund të bëjë sigurime shtesë, veçanërisht me kërkesë të huamarrësve të projektit.

11.1.2 Detyrimet e rikuperimit

Kontrata e Partneritetit Publik Privat zakonisht kërkon që partneri privat të bëjë sigurimin e dëmtimit të pronës gjatë fazës së funksionimit të projektit për të mbuluar detyrimin e tij për rikthimin e infrastrukturës në gjendjen e saj origjinale në rast dëmtimi.

11.1.3 Rrethanat në të cilat partneri privat nuk është i detyruar të ketë sigurim

Mund të ketë raste kur preferohet që partnerit privat të mos i kërkohet që të bëjë disa lloje sigurimesh, për shembull, bazuar në faktin që autoriteti publik nuk mendon se ai përfaqëson vlerë të mirë të parasë.

Kontrata duhet të trajtojë gjithashtu edhe rrethanat në të cilat partneri privat nuk mund të bëjë sigurim (qoftë për shkak se sigurimi është i padisponueshëm ose nuk është i disponueshëm me kushte të arsyeshme tregtare). Nëse një sigurim i kërkuar bëhet i padisponueshëm për projektin dhe projektet e tjera të krahasueshme, kjo shpesh trajtohet si një risk i përbashkët (dhe jo një risk i transferuar), i ngjashëm me riskun e forcës madhore.

Nisur nga fakti se nuk është në interesin publik që një partner privat të përdorë infrastrukturën publike pa sigurime, kontrata e Partneritetit Publik Privat mund të lejojë që secila palë të ndërpresë kontratën. Në rast të kundërt, autoriteti publik mund të vendosë të vazhdojë kontratën e Partneritetit Publik Privat në bazë të faktit se do të veprojë si *sigurues i mjetit të fundit* për ato risqe që partneri privat nuk është më në gjendje t'i sigurojë.

Është e dobishme që të bëhet dallimi në kontratë ndërmjet rrethanave ku partneri privat nuk është në gjendje të përmbushë kërkesat minimale të sigurimit në kontratë sepse:

- a) Sigurimi nuk është më i disponueshëm në tregun e sigurimeve me kushte që përputhen plotësisht me kërkesat minimale të kontratës së Partneritetit Publik Privat (p.sh., niveli maksimal i zbritjes i përcaktuar në kontratë është më i ulët se ai që është i disponueshëm në treg).

Shënim: teksa partneri privat nuk vlerësohet se ka shkelur kontratën e Partneritetit Publik Privat sepse nuk ka bërë sigurimin përkatës me kushtet e kërkuara, autoriteti publik nuk duhet të marrë përsipër ose të ndajë ndonjë risk shtesë si rezultat i sigurimit përkatës që nuk është bërë sipas kushteve të kërkuara;

- b) Sigurimi nuk është më i disponueshëm në treg me asnjë kusht; ose
- c) Megjithëse sigurimi është i disponueshëm, ai nuk vlerësohet i dobishëm nga pikëpamja tregtare duke iu referuar, për shembull, kërkesave minimale të kontratës së Partneritetit Publik Privat, hipotezave të çmimeve fillestare, nivele dukshëm më të larta të primeve të zbritshme dhe të tepërta ose, më gjerësisht, që shoqëritë tregtare kanë ndërprerë përgjithësisht blerjen e një sigurimi të tillë.

Shënim: rrethanat në pikat b) dhe c) kur sigurimi nuk është më i disponueshëm për projektin, shpesh vlerësohen se përbëjnë forcën madhore (shih më sipër).

12. Garancitë dhe dëmshpërblimet

12.1 Garancitë

Garancia është një premtim kontraktues për vërtetësinë e një deklaratë në një datë të veçantë. Garancitë zakonisht kanë të bëjnë me çështje që kërkojnë ose hetim të hollësishëm në mënyrë që të verifikohen nga një kundër-palë ose që nuk mund të verifikohen praktikisht. Prandaj, risku i deklaratës së bërë në lidhje vërtetësinë e atyre çështjeve i përket palës që bën deklaratë.

Shumica e kontratave të Partneritetit Publik Privat përfshijnë garanci të një forme ose të një tjetre. Përfshirja e disa llojeve garancish është e zakonshme në çdo kontratë tregtare (p.sh., garancitë e partnerit privat se ai ka kompetencë të lidhë kontratë ose që nuk ka bërë pagesa për zyrtarët publik në lidhje me dhënien e kontratës).

Garancitë e dhëna në një Partneritet Publik Privat nga autoriteti publik për partnerin privat përbëjnë një komponent kryesor të alokimit të riskut për projektin.

Për shembull, nëse autoriteti publik e garanton partnerin privat në kontratën e Partneritetit Publik Privat që trualli nuk ka ndotje të mjedisit, dhe partneri privat zbulon ndotjen e mjedisit gjatë fazës së ndërtimit, atëherë partneri privat ka të drejtë të bëjë kërkesë në bazë të kontratës së Partneritetit Publik Privat për shkeljen e garancisë. Prandaj, vlerësimi i qëllimit të çdo garancie që autoriteti publik i jep partnerit privat në bazë të kontratës së Partneritetit Publik Privat ka rëndësi thelbësore për të vlerësuar shkallën në të cilën risqet/shpërblimet e lidhura me një projekt ndahen (ose jo) midis palëve.

Në praktikë, autoritetet publike nuk kanë dëshirë të japin garanci në kontratat e Partneritetit Publik Privat. Prandaj, mjeti i preferuar për të mbrojtur partnerin privat në lidhje me një aspekt të veçantë të riskut është mekanizmi kontraktor që i mundëson partnerit privat të kërkojë kompensim dhe/ose një formë tjetër të ndihmës së përcaktuar (p.sh., zgjatje afati).

12.2 Dëmshpërblimet

Dëmshpërblimi është një marrëveshje kontraktuale sipas së cilës njëra palë premtion të mbrojë një person tjetër nga humbja ose të kompensojë një person tjetër për një detyrim specifik që ai person pëson.

Zakonisht, kontratat e Partneritetit Publik Privat përfshijnë dëmshpërblime, megjithëse në shumicën e rrethanave këto i jepen autoritetin publik nga partneri privat.

Autoritetet publike zakonisht nuk kanë dëshirë të japin dëmshpërblim; në disa raste, atyre nuk u lejohet t'i japin ato për shkak të politikave ose me ligj.

Nga ana tjetër, partneri privat shpesh pritet t'i japë autoritetit publik dëmshpërblime të gjera. Partnerit privat mund t'i kërkohet të pranojë përgjegjësinë ligjore ndaj të cilit do të ekspozohet çdo pronar ose përdorues i infrastrukturës, dhe kjo reflektohet në dëmshpërblimet që partneri privat i jep autoritetit publik. Kategoritë e humbjeve/kërkesave për dëmshpërblim ndaj të cilave ekspozohet shpesh partneri privat përfshijnë ato që paraqiten kundër autoritetit publik në lidhje me sa më poshtë vijon:

- a) Dëmtimi personal/vdekja;
- b) Shkeljet e detyrave ligjore të autoritetit publik;
- c) Dëmtimi i pasurisë; dhe
- d) Pretendime të tjera të paraqitura kundër autoritetit publik nga palë të treta që në rrethana të tjera mund të ishin paraqitur kundër partnerit privat,

në masën që ato lindin si rezultat i realizimit ose mosrealizimit të kontratës së Partneritetit Publik Privat nga partneri privat.

Legjislacioni në vendet e Ballkanit Perëndimor: Dëmshpërblimet

Shqipëria

Duke pasur parasysh përkufizimin e gjerë të "mbështetjes financiare" sipas Ligjit për koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat, dëmshpërblimet mund të jepen si "mbështetje financiare".

Bosnja dhe Hercegovina - Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës (Kantoni i Hercegovina-Neretvas)

Sipas ligjit të Kantonit të Hercegovina-Neretvas për Partneritetet Publike Private, palët duhet të rregullojnë të gjitha çështjet në lidhje me dëmshpërblimet e mundshme. Në praktikë, autoriteti publik nuk ka të ngjarë të japë ndonjë dëmshpërblim në dobi të partnerit privat.

Bosnja dhe Hercegovina – Republika Serbe

Nuk ka asnjë kufizim ligjor ndaj autoritetit publik që t'i japë dëmshpërblim partnerit privat. Sidoqoftë, një mundësi e tillë nuk është provuar në praktikë.

Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë (IRJM)

Nuk ka kufizime ndaj autoritetit publik për t'i dhënë dëmshpërblime një partneri privat. Sidoqoftë, autoritetet publike maqedonase nuk kanë dëshirë ta bëjnë këtë në praktikë.

Kosova*

Ligji për Partneritetin Publik Privat nuk shprehet për dëmshpërblimet. Sidoqoftë, nuk ka asnjë kufizim ndaj autoritetit publik që i jep dëmshpërblime një partneri privat në bazë të kontratës së Partneritetit Publik Privat.

Mali i Zi

Megjithëse ligjet e Malit të Zi nuk e pengojnë qeverinë që t'i japë dëmshpërblim një partneri privat, do të ishte jashtëzakonisht e pazakontë që kjo lloj dispozite të parashikohej në një kontratë koncesioni.

Serbia

Nuk ka asnjë kufizim në bazë të Ligjit të Serbisë ndaj autoritetin publik që jep dëmshpërblime për një partner privat. Në përgjithësi, do të ishte në dorë të palëve që të negocionin dëmshpërblimet e zbatueshme. Sidoqoftë, në praktikë autoriteti publik do të ishte i gatshëm t'i jepte dëmshpërblime partnerit privat.

13. Ndërprerja e parakohshme e kontratës dhe kompensimi për këtë ndërprerje

13.1 Kompensimi për ndërprerjen e kontratës si pasojë e mosekzekutimit të detyrimeve nga partneri privat

13.1.1 Përkufizimi i mosekzekutimit të detyrimeve nga partneri privat

Kontrata e Partneritetit Publik Privat do të përfshijë një listë të detajuar të mosekzekutimit të detyrimeve nga partnerit privat që i jep autoritetit të drejtën e ndërprerjes së kontratës. Ndodh zakonisht që lista të përfshijë standarde të tilla si më poshtë vijon:

- Paaftësia paguese/falimenti i partnerit privat;
- Mosarritja e objektivave të caktuara të ndërtimit;
- Mosofrimi i shërbime në standardet e dakordësuara;
- Mosbërja e sigurimeve të kërkuara;
- Shkelja e kufizimeve për ndryshimet e pronësisë ose transferimin e kontratës;
- Shkelje materiale dhe/ose shkelje e vazhdueshme; dhe
- Sjellje mashtruese ose korruptive të partnerit.

13.1.2 Panoramë e përgjithshme dispozitave të kompensimit

Ekzistojnë dy qasje kryesore për të përcaktuar pagesat e kompensimit për ndërprerjen e parakohshme të kontratës si pasojë e mosekzekutimit të detyrimeve nga partnerit privat në një kontratë të Partneritetit Publik Privat. Këto janë:

- a) Kompensimi i bazuar në vlerësimin e vlerës së projektit në momentin e ndërprerjes së kontratës (bazuar në vlerën e mbetur të kontratës ose vlerën e aseteve); dhe
- b) Kompensimi i bazuar në shumën e borxhit kryesor që partneri privat u ka huadhënësve të tij në momentin e ndërprerjes së kontratës.

Përfshirja e dispozitave të qarta në kontratën e Partneritetit Publik Privat për kompensimin e ndërprerjes së parakohshme të kontratës u jep palëve siguri në lidhje me mekanikën dhe pasojat e ndërprerjes së parakohshme të kontratës, pa qenë e nevojshme të mbështeten në procedura ligjore shpesh të gjata dhe të kushtueshme. Ky nivel sigurie mund t'i mundësojë partnerit privat që ai të japë një ofertë me çmim të më të ulët.

Qasjet që janë më pak të zakonshme për kompensimin e ndërprerjes së kontratës për shkak të mosekzekutimit të detyrimeve nga partneri privat përfshijnë sa më poshtë vijon:

- a) Kontrata e Partneritetit Publik Privat që shprehet se nuk paguhet kompensim. Pas ndërprerjes së kontratës, partneri privat mund të kërkojë dëmshpërblim për *begatim pas shkak* ndaj autoritetit publik me qëllim që të kompensohet në bazë të vlerës së asetit përkatës të autoritetit publik; dhe

- b) Kontrata e Partneritetit Publik Privat nuk shprehet për çështjen se sa kompensim duhet të paguhet. Kjo qasje mund të përdoret kur, sipas ligjit, ose partneri privat ka të drejtë të ligjshme të bëjë kërkesë ndaj autoritetit publik për dëmshpërbim, ose ekziston një proces ligjor për përcaktimin e kompensimit që paguhet nga autoriteti publik.

Legjislacioni për kompensimin e ndërprerjes së kontratës

Shqipëria

Ligji i Shqipërisë nuk parashikon rregulla për kompensimin e ndërprerjes së kontratës për shkak të mosekzekutimit të detyrimeve nga partneri privat. Kushtet standarde të kontratave të koncesionit përfshijnë një dispozitë për kompensimin e ndërprerjes së kontratës nga autoriteti publik për arsye të interesit publik. Në këtë rast, autoriteti publik duhet ta paguajë partnerin privat për të gjitha punët dhe shërbimet e marra në dorëzim dhe shërbimet e realizuara para ndërprerjes së kontratës dhe për dëmet që i janë shkaktuar partnerit privat.

Bosnja dhe Hercegovina

Sipas ligjit të përgjithshëm të kontratave, partneri privat ka të drejtë të kërkojë kompensimin e dëmeve nga autoriteti publik për humbjet faktike që vijnë nga ndërprerja e parakohshme. Niveli i dëmeve do të përcaktohet nga gjykata kompetente, në varësi të rrethanave të çështjes.

Bosnja dhe Hercegovina - Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës (Kantoni i Hercegovina-Neretvas)

Pagesa e kompensimit për ndërprerjen e kontratës nuk rregullohet në mënyrë të qartë me ligjin e Kantonit të Hercegovina-Neretvas për Partneritetin Publik Privat ose me ligjin e Kantonit të Hercegovina-Neretvas për koncesionet. Sidoqoftë, rregullat e përgjithshme të kontratës shprehen se pas ndërprerjes së parakohshme të kontratës, pala e që ka dështuar duhet të kompensojë palën që nuk ka dështuar për humbjet dhe dëmin e shkaktuar, përfshirë fitimet e munguara.

Bosnja dhe Hercegovina – Republika Serbe

Ligji i Republikës Serbe për Partneritetin Publik Privat nuk përmban asnjë dispozitë në lidhje me kompensimin pas ndërprerjes së parakohshme të kontratës për shkak të mosekzekutimit të detyrimeve nga partneri privat. Palët në përgjithësi janë të lira të bien dakord për kompensimin e ndërprerjes së kontratës si pasojë e mosekzekutimit të detyrimeve. Ligji i Republikës Serbe për koncesionet³⁴ shprehet se autoriteti publik mund ta ndërpresë në mënyrë të njëanshme marrëveshjen e koncesionit për shkak të mosekzekutimit të detyrimeve nga partneri privat. Në këtë rast, autoriteti publik ka të drejtë të kompensohet për dëmet, përfshirë dhe fitimin e munguar.

³⁴ Neni 46 i ligjit të Republikës Serbe për koncesionet.

Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë (IRJM)

Qasja e kompensimit mund të ndryshojë nga projekti në projekt, por, në përgjithësi, partneri privat nuk do të kompensohet fare nëse kontrata ndërpritet për shkak të mosekzekutimit të detyrimeve nga partneri privat. Ligji i Maqedonisë për Partneritetin Publik Privat kërkon që të drejtat e partnerit privat të shprehen për rastet në të cilat autoriteti publik ndërpret në mënyrë të njëanshme kontratën.³⁵ Fakti nëse do të kompensohet dhe në çfarë mase do të kompensohet partneri privat varet nga (i) rasti i mosekzekutimit të detyrimeve, (ii) kushtet e kontratës dhe (iii) rezultati i çdo procedure gjyqësore të mundshme. Kontrata e Partneritetit Publik Privat mund të parashikojë që partnerit privat të mos i jepet asnjë kompensim ose mund të mos shprehet për këtë çështje. Në të dyja rastet, nuk ka asgjë që e pengon partnerin privat që të fillojë procedurat gjyqësore për kompensimin e mundshëm, por nuk ka asnjë proces ligjor për përcaktimin e kompensimit që duhet të paguhet.

Kosova*

Ligji për Partneritetin Publik Privat nuk parashikon rregulla që zbatohen për kompensimin e ndërprerjes së kontratës për shkak të mosekzekutimit të detyrimeve nga partneri privat. Në varësi të Paragrafit 2.19 të Nenit 48 të Ligjit për Partneritetin Publik Privat, palët e një kontrate të Partneritetit Publik Privat mund të bien dakord për llogaritjen e kompensimit pas ndërprerjes së parakohshme të kontratës.³⁶ Nëse ndërprerja e parakohshme e një kontrate të Partneritetit Publik Privat përfshin pagimin e kompensimit për partnerin privat ose detyrime të tjera financiare për autoritetin publik, kjo i nënshtrohet miratimit paraprak të Komitetit për Partneritetet Publike Private.³⁷

Mali i Zi

Ligjet e Malit të Zi nuk e njohin konceptin e kompensimit për ndërprerjen e Partneriteteve Publike Private, dhe modelet e përshkruara më lart as nuk janë aplikuar dhe as nuk janë zhvilluar në praktikën vendore. Prandaj, për të zbatuar një dispozitë të kompensimit të ndërprerjes së kontratës duhet të bihet dakord në mënyrë të qartë ndërmjet palëve rast pas rasti. Çdo shumë e përcaktuar për t'u paguar nga autoriteti publik ndaj një partneri privat sipas një kontrate të Partneritetit Publik Privat duhet të njihet në buxhetin e autoritetit publik (qoftë në nivel shtetëror, bashki ose provincë autonome), përndryshe ai detyrim pagese do të jetë i pazbatueshëm. Sipas parimeve të përgjithshme të ligjit Malazez, partneri privat ka të drejtë ligjrisht të bëjë kërkesë ndaj autoritetit publik për çdo lloj kompensimi të dëmit faktik, duke përfshirë edhe ndërprerjen e parakohshme të kontratës për shkak të mosekzekutimit të detyrimeve nga partneri privat. Niveli i dëmeve do të përcaktohet nga gjykata kompetente, në varësi të rrethanave të çështjes.

³⁵ Neni 44 i ligjit maqedonas për Partneritetet Publike Private.

³⁶ Paragrafi 2.19 i nenit 48 të ligjit për Partneritetet Publike Private.

³⁷ Neni 49 i ligjit për Partneritetet Publike Private.

Serbia

Kontrata e Partneritetit Publik Privat³⁸ duhet të përcaktojë arsyet e ndërprerjes së parakohshme dhe pasojat e saj, përfshirë shumën minimale që duhet t'i paguhet autoritetit publik ose partnerit privat, mënyrën e pagesës së shumës dhe fondeve nga të cilat do të paguhet kjo shumë. Nëse autoriteti publik ndërpret në mënyrë të njëanshme kontratën e Partneritetit Publik Privat, ai do të ketë të drejtë të kompensohet për dëmet, përfshirë fitimin e munguar.³⁹ Sipas rregullave të përgjithshme të ligjit të kontratave, partneri privat ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblim nga Qeveria për humbjet faktike që vijnë nga ndërprerja e parakohshme e kontratës. Niveli i dëmeve do të përcaktohet nga gjykata kompetente, në varësi të rrethanave të çështjes.

13.1.3 Metoda e përlogaritjes

▪ **Vlera e tregut e kontratës së Partneritetit Publik Privat në rast ndërprerje**

Pas ndërprerjes së kontratës, autoriteti publik mund të vendosë (në vartësi të cilësimit të mëposhtëm) si më poshtë vijon:

- Të bëjë një ri-tenderim në tregun e hapur të kontratës së Partneritetit Publik Privat (në këtë rast partnerit privat që i është ndërprerë kontrata i paguhet shuma e ofruar nga ofertuesi më i lartë); ose
- Të përcaktojë vlerën e drejtë të përlogaritur të kontratës së Partneritetit Publik Privat duke përlogaritur çmimin që një palë e tretë do të paguante për kontratën e Partneritetit Publik Privat në një proces tenderi në tregun e hapur (vlera e drejtë e përlogaritur e kontratës).

Të dyja këto qasje sigurojnë që kompensimi i paguar të marrë parasysht çdo kosto që do të përballohet nga autoriteti publik dhe/ose kontraktori pasardhës për të korrigjuar performancën ose gjendjen e projektit.

E drejta e autoritetit publik që të vendosë për të ri-tenderuar kontratën e Partneritetit Publik Privat në përgjithësi është e kushtëzuar nga ekzistenca e një *tregu likuid* (i cili do të përcaktohet në kontratë) për Partneritetet Publike Private në juridiksionin ose rajonin përkatës. Kjo gjendje e siguron huadhënësin që autoriteti publik nuk mund ta ri-tenderojë kontratën e Partneritetit Publik Privat në rrethanat kur nuk ka treg të rëndësishëm për projektet e Partneritetit Publik Privat në juridiksionin përkatës (p.sh., për shkak të politikës së qeverisë). Nëse nuk ka *treg likuid*, atëherë autoritetit publik do t'i kërkohej të paguajë vlerën e drejtë të përlogaritur të kontratës.

Disa kontrata të Partneritetit Publik Privat nuk i japin autoritetit publik ndonjë mundësi për të ri-tenderuar kontratën e Partneritetit Publik Privat në tregun e hapur. Në vend të kësaj, autoriteti publik paguan vlerën e drejtë të përlogaritur të kontratës. Kjo qasje është përdorur shpesh kur (në mbylljen e kontratës) mendohet se tregu i Partneritetit Publik Privat në juridiksionin përkatës nuk është mjaftueshëm likuid sa që palët të jenë të sigurta që një proces ri-tenderimi do të përcaktonte në mënyrë të duhur vlerën e drejtë të kontratës.

³⁸ Neni 46 i Ligjit të Serbisë për Partneritetet Publike Private.

³⁹ Neni 54 i Ligjit të Serbisë për Partneritetet Publike Private.

Metoda e vlerës së drejtë të përlogaritur të kontratës përfshin llogaritjen (mbi bazën e vlerës aktuale neto) të shumës së përmbledhur të të gjitha pagesave që janë parashikuar të bëhen nga autoriteti publik gjatë afatit të mbetur të kontratës së Partneritetit Publik Privat, të gjitha kostot neto (përfshirë të gjithat kostot e riparimit) që parashikohet të krijohen.

Megjithëse kjo qasje ka për qëllim të përsërisë llogaritjen që një ofertues i gatshëm do të ndërmerre në një proces tenderimi, ajo kërkon që palët të bien dakord për metodën dhe burimet e një llogaritje të tillë. Prandaj, metodologjia duhet të përcaktohet në kontratën e Partneritetit Publik Privat dhe duhet të përfshijë, nëse është e përshtatshme, përdorimin e një eksperti të pavarur për të bërë llogaritjen.

Në rast mosmarrëveshje midis palëve, vlera aktuale e drejtë e përlogaritur e kontratës do të përcaktohet nga një ekspert i duhur ose, në fund të fundit, nga gjykatat.

▪ **Vlera e drejtë e përlogaritur e aseteve në momentin e ndërprerjes së kontratës**

Kjo qasje përdor analizën kontabël për të përcaktuar vlerën e aseteve të infrastrukturës dhe, për rrjedhojë, nivelin e kompensimit që i paguhet partnerit privat. Ndonëse ekzistojnë pikëpamje të ndryshme për bazën dhe mjetet e analizës, zakonisht pranohet përdorimi i vlerës kontabël të aseteve minus amortizimin deri në momentin e ndërprerjes së kontratës.

Ekzistojnë dy qasje kryesore për ta vlerësuar këtë vlerë:

- Përcaktimi i nivelit të kapitalit të investuar në aset, d.m.th., bëhet një vlerësim të burimeve të ndryshme të kapitalit të angazhuar për projektin dhe të investuar përfundimisht (kjo do të përfshijë, për shembull, si kapitalin e investuar ashtu edhe borxhin kryesor të marrë hua); ose
- Përcaktimi i shpenzimeve të bëra nga partneri privat në ndërtimin e projektit (p.sh., kostot e blerjes së tokës, të projektimit, të ndërtimit dhe të lejeve).

Dallimi kryesor midis dy qasjeve është se e para lejon që të merren parasysh kostot e financimit të bëra gjatë ndërtimit, ndërsa e dyta jo.

Në ndryshim nga përlogaritja e vlerës së drejtë të kontratës (përkthyer në pjesën A më sipër), llogaritja e vlerës së drejtë të aseteve nuk merr parasysh koston (nëse ka) e autoritetit publik për të korrigjuar çështjet e realizimit të projektit (p.sh., kostot të korrigjimit të defekteve të infrastrukturës).

Prandaj, në disa juridiksione, kontrata e Partneritetit Publik Privat shprehet se kompensimi që paguhet nga autoriteti publik te Partneri privat duhet të jetë një shumë e barabartë me vlerën kontabël të aseteve minus çdo kosto për korrigjimin e defekteve, d.m.th., kostoja e sjelljes së infrastrukturës në standardin i kërkuar (*Metoda e Vlerës së Përshtatur Kontabël*). Ky formulim përpiqet të sigurojë që autoriteti publik nuk e kompenson partnerin privat në një shumë që është më e madhe se vlera e vërtetë e aseteve të autoritetit publik në momentin e ndërprerjes së kontratës.

Legjislacioni në vendet e Ballkanit Perëndimor: Vlerësimi i kompensimit**Shqipëria**

Ligji për koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat nuk parashikon rregulla për kompensimin që paguhet nga qeveria në rast të ndërprerjes së parakohshme të kontratës për shkak të mosekzekutimit të detyrimeve nga partneri privat. Palët mund të përfshijnë një dispozitë në kontratën e Partneritetit Publik Privat për metodologjinë e llogaritjes së kompensimit, siç është Metoda e vlerës së përshtatur kontabël të përmendur në Seksionin B më lart).

Bosnja dhe Hercegovina - Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës (Kantoni i Hercegovina-Neretvas)

Ligji i Kantonit të Hercegovina-Neretvas për Partneritetin Publik Privat nuk përmban asnjë dispozitë në lidhje me përcaktimin e kompensimit që duhet paguar për ndërprerjen e kontratës së Partneritetit Publik Privat.

Bosnja dhe Hercegovina - Republika Serbe

Ligji i Republikës Serbe për Partneritetin Publik Privat nuk përmban asnjë dispozitë në lidhje me përcaktimin e kompensimit që paguhet për ndërprerjen e kontratës së Partneritetit Publik Privat.

Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë (IRJM)

Në IRJM, nuk ka dispozita ligjore në lidhje me këtë. Palët mund të bien dakord për metodën e kompensimit në kontratën e Partneritetit Publik Privat, por ka të ngjarë që Metoda e vlerës së përshtatur kontabël të zbatohet në praktikë.

Kosova*

Ligji për Partneritetin Publik Privat nuk shprehet në këtë drejtim; megjithatë, nuk ka kufizime në përdorimin e formulimeve të mësipërme për kompensim sipas parashikimeve të kontratës së Partneritetit Publik Privat.

Mali i Zi

Megjenëse ligjet e Malit të Zi nuk e trajtojnë konkretisht këtë çështje, palët janë të lira të përcaktojnë modelin për llogaritjen e kompensimit të ndërprerjes së kontratës.

Serbia

Shuma e kompensimit që paguhet për ndërprerjen e kontratës mund të dakordësohet nga palët në kontratën e Partneritetit Publik Privat. Nuk ka kufizime ligjore të detyrueshme në këtë drejtim.

▪ Llogaritjet e bazuara në borxhin kryesor

Edhe pse nuk është e përhapur në të gjithë BE, disa kontrata të Partneritetit Publik Privat e kompensojnë partnerin privat në bazë të shumës së borxhit që i detyrohet huadhënësve kryesorë. Llogaritja fillon me një përqindje të borxhit kryesor të

papaguar dhe, në disa raste, me shumat e zbritura të tilla si kostot e ri-tenderimit dhe kostot e korigjimit të performancës së dobët.

Llogaritja e bazuar tek borxhi kryesor duhet të sigurojë që kompensimi i ndërprerjes së kontratës nuk u paguhet asnjëherë ofruesve të kapitalit përveç borxhit kryesor (p.sh.. investitorët e kapitalit ose ofruesit e borxhit të ndërmjetëm). Në të njëjtën kohë, për të nxitur huadhënësit kryesorë që ata të marrin kontrollin e një projekti me performancë të dobët, zakonisht parashikohet që huadhënësit e vjetër duhet të shlyejnë disa nga borxhet e tyre nëse projekti do të ndërpritej për shkak të mosekzekutimit të detyrimeve nga partneri privat.

Megjithëse llogaritjet e kompensimit të bazuara në borxhin kryesor ofrojnë një nivel më të lartë sigurie për huadhënësit kryesorë krahasuar me metodën e vlerës së tregut të përmendur në paragrafin A më lart, autoriteti publik nuk mund të jetë kurrë i sigurt se nuk do të paguajë më shumë se vlera e tregut. Me fjalë të tjera, autoritetit publik, teorikisht, mund t'i kërkohej të paguajë një shumë më të madhe se sa një shumë e barabartë në rrethana të caktuara.

Mundësia e këtij skenari do të varet nga performanca e projektit në momentin e ndërprerjes, nga përqindja e borxhit kryesor që llogaritja përdor si pikënisje, nga përshtatja e projektit dhe nga niveli i çdo dyshemeje të shumës së kompensimit.

▪ Përdorimi i tavaneve dhe dyshemeve

Në disa kontrata të Partneritetit Publik Privat, shuma e kompensimit që paguhet nga autoriteti publik i nënshtrohet një tavani ose një dyshemeje. Dyshemeja garanton humbjen maksimale të huadhënësve, ndërsa tavani garanton humbjen minimale të huadhënësve. Shembujt e mëposhtëm ilustrojnë se si mund të përdoret një tavan ose një dysheme:

- a) Autoriteti publik paguan vlerën e drejtë të përlllogaritur të kontratës ose 80% të borxhit të papaguar, cilado që është më e ulët.

Kjo siguron që huadhënësit të mos marrin kurrë më shumë se 80% të borxhit të papaguar.

- b) Autoriteti publik paguan vlerën e drejtë të përlllogaritur të kontratës ose 80% të borxhit të papaguar, cilado qoftë më e lartë.

Kjo siguron që huadhënësit të mos marrin kurrë më pak se 80% të borxhit të mbetur të papaguar.

- c) Autoriteti publik paguan ose i) një shumë të barabartë me 100% të borxhit të papaguar, minus zbritjet e parashikuara në të ardhmen, ose ii) 80% të borxhit kryesor të papaguar, cilado qoftë më e lartë.

Kjo siguron që huadhënësit të mos marrin kurrë më pak se 80% të borxhit kryesor të papaguar.

13.2 Kompensimi për ndërprerjen e kontratës si pasojë e mosekzekutimit të detyrimeve nga autoriteti publik dhe si pasojë e ndërprerjes vullnetare

13.2.1 Përkufizimi i mosekzekutimit të detyrimeve nga autoriteti publik

Më poshtë jepen shembuj të veprimeve ose mosveprimeve që do të përbënin një mosekzekutim të detyrimeve nga autoriteti publik sipas një kontrate të Partneritetit Publik Privat:

- a) Shpronësimi/konfiskimi i aseteve/aksioneve të partnerit privat;
- b) Mospagesë nga autoriteti publik i shumave për shkak të partnerit privat;
- c) Transferimin nga autoriteti publik i të drejtave të tij sipas kontratës së Partneritetit Publik Privat në kundërshtim me dispozitat përkatëse; dhe
- d) Shkelja e detyrimeve nga autoriteti publik në një mënyrë ose në një masë që ndikon materialisht dhe negativisht në aftësinë e partnerit privat për të kryer kontratën.

Një ndryshim në statusin juridik të Autoritetit Publik ose një ndryshim në besueshmërinë e tij zakonisht nuk do të shkaktojë ndërprerjen e kontratës së Partneritetit Publik Privat.

13.2.2 Panoramë e përgjithshme e dispozitave të kompensimit

Në shumicën e Partneriteteve Publike Private, partneri privat ka të drejtë të ndërpresë kontratën e Partneritetit Publik Privat për shkak të mosekzekutimit të detyrimeve nga autoriteti publik (që duhet të përcaktohet). Kur nuk ka dispozita të qarta në kontratën e Partneritetit Publik Privat, atëherë partneri privat mund t'i referohet parimeve të përgjithshme juridike ose dispozitat specifike në ligj që çojnë në një rezultat të ngjashëm me juridiksionet, ku të drejtat e ndërprerjes së kontratës janë parashikuar në kontratën e Partneritetit Publik Privat.

Autoriteti publik normalisht do të ketë të drejtën e njëanshme për të ndërprerë kontratën e Partneritetit Publik Privat qoftë me *vullnetit* e tij (d.m.th., pavarësisht nga performanca e kontratës së Partneritetit Publik Privat) ose mbi baza të interesit publik.

Kompensimi i partnerit privat për shkak të mosekzekutimit të detyrimeve nga autoriteti publik shpesh trajtohet në të njëjtën mënyrë si kompensimi për ndërprerjen vullnetare. Marrëveshja e kompensimit do të përmbajë në përgjithësi tre komponentët kryesorë të mëposhtëm:

- a) Borxhin kryesor;
- b) Kapitalin dhe borxhin i varur; dhe
- c) Kostot e palëve të treta (kostot e prishjes së kontratës me nënkontraktorin dhe pagesat për largimet nga puna).

13.2.3 Metoda e llogaritjes

▪ Borxhi kryesor

Ky komponent përfshin kostot e interesit të akumuluar dhe kostot e ndërprerjes së parakohshme të kontratës (përfshirë kostot e mbrojtjes nga ndërprerja e

parakohshme e kontratës) përveç elementëve të tjerë të përfshirë, siç janë interesi i papaguar i akumuluar deri në datën e pagesës së kompensimit të ndërprerjes së kontratës.

▪ **Kapitali dhe borxhi i varur**

Në shumicën e rasteve, autoriteti publik do të vendosë në fazën e tenderit se si do të bëhet kompensimi i kapitalit. Në të kundërt, (dhe shumë më pak e zakonshme) ofertuesit mund të ftohen të vendosin për një metodë të llogaritjes së kompensimit të kapitalit. Kjo qasje alternative mund të rrisë vlerën e parasë në ofertat e tenderit.

Shuma e kompensuar pas ndërprerjes së kontratës zakonisht llogaritet duke përdorur njërën prej tyre:

- a) **Metoda e rastit bazë të Normës së Brendshme të Fitimit.** kjo i paguan partnerit privat një shumë të mjaftueshme për të siguruar që kthimi i kapitalit gjatë gjithë afatit të kontratës së Partneritetit Publik Privat do të mbetet i barabartë me kthimin e kapitalit të rastit bazë (d.m.th., kthimi i kapitalit i parashikuar në fillimin e projektit); ose
- b) **Metoda e vlerës së tregut** (d.m.th., çfarë do të paguante një palë e tretë për kapitalin e vet). Kjo llogarit kompensimin e kapitalit bazuar në supozimin se kontrata e Partneritetit Publik Privat nuk ishte përfunduar dhe se kapitali ishte shitur në tregun e hapur. Në fund të fundit, shuma e kompensimit që paguhet do të kërkojë marrëveshje midis palëve dhe, në mungesë të një marrëveshje, referim tek zgjidhja e mosmarrëveshjeve; ose
- c) **Metoda e rastit të ardhshëm bazë të Normës së Brendshme të Fitimit.** Kjo llogarit vlerën e kapitalit duke përdorur kapitalin fillestar të rastit bazë të Normës së Brendshme të Fitimit për të vlerësuar kapitalin për afatin e mbetur të kontratës së Partneritetit Publik Privat.

Dallimet kryesore midis pikave a), b) dhe c) mund të përmbliidhen si më poshtë:

- Opsioni a) vlerëson kapitalin në vlerën që pritej të krijonte në fillim të projektit (*Rasti bazë i të Normës së Brendshme të Fitimit*). Me fjalë të tjera, nëse kthimi i investimeve të kapitalit para momentin të ndërprerjes së kontratës tejkalon Rastin Bazë të Normës së Brendshme të Fitimit, atëherë shuma e kompensimit që paguhet për ndërprerjen e kontratës do të jetë më e vogël se sa do të kishte qenë në rrethana të tjera nëse kthimi i investimit të kapitalit para momentit të ndërprerjes së kontratës ka qenë më e ulët se Rastin Bazë të Normës së Brendshme të Fitimit.
- Opsioni b) mund të thuhet se pasqyron vlerën e vërtetë të kapitalit, duke marrë parasysh se çmimi i paguar reflekton si ndikimin pozitiv në vlerën e çdo performance të mirë të projektit, ashtu edhe ndikimin negativ në vlerën e shkaktuar nga ndonjë performancë e dobët e projektit.
- Opsioni c) nuk merr parasysh ecurinë historike të projektit kur llogarit vlerën e kapitalit. Kapitali vlerësohet në bazë të Rastit Bazë të Normës së Brendshme të Fitimit për atë që do të kishte qenë (nëse nuk do të kishte ndodhu ndërprerja) afati i mbetur i kontratës së Partneritetit Publik Privat.

▪ Kostot e palëve të treta

Kompensimi për ndërprerjen për shkak të mosekzekutimit të detyrimeve nga autoriteti publik ose për shkak të ndërprerjes vullnetare do të mbulojë normalisht kostot e ndërprerjes së kontratës së nënkontraktorit dhe pagesat e papunësisë për punonjësit e partnerit privat (ose nënkontraktorëve të tij) që kanë humbur punën e tyre.

Legjislacioni për ndërprerjen e kontratës për shkak të mosekzekutimit të detyrimeve/ndërprerjes vullnetare

E përgjithshme: në Shqipëri, në Republikën Serbe dhe në Serbi, autoritetet publike kanë të drejtë të ndërpresin kontratën në mënyrë të njëanshme për arsye të interesit publik.

Shqipëria

Ligji për koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat parashikon ndërprerjen e parakohshme të kontratës nga secila palë, për shembull në rastet e pamundësisë së realizimit të saj ose të mosekzekutimit të detyrimeve që nuk është korrigjuar. Të drejtat e ndërprerjes së kontratës nga ana e partnerit privat parashikohen në kontratën e Partneritetit Publik Privat. Rregullat e përgjithshme për të drejtat e ndërprerjes së kontratave përcaktohen gjithashtu edhe në Kodin Civil Shqiptar.

Ligji i Shqipërisë për koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat dhe praktika gjyqësore nuk shprehen në lidhje me kompensimin e ndërprerjes së kontratës për shkak të mosekzekutimit të detyrimeve nga autoriteti publik dhe për shkak të ndërprerjes vullnetare. Kodi Civil i Shqipërisë shprehet se dëmet që duhet të shpërblehen në rast të ndërprerjes së një kontrate për shkak të mosekzekutimit të detyrimit të palës tjetër, mbulojnë të gjitha humbjet në lidhje me zvogëlimin e pronës përkatëse dhe fitimin e munguar që mund të ishte nxjerrë në kushtet normale të tregut.⁴⁰ Sipas mendimit të këshilltarit shqiptar, dëmet do të përfshijnë gjithashtu edhe humbjet e nënkontraktorit që kërkon pagesë nga partneri privat dhe pagesa papunësie për punonjësit.

Bosnja dhe Hercegovina - Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës (Kantoni i Hercegovina-Neretvas)

Sipas Ligjit të Kantonit të Hercegovina-Neretvas për Partneritetet Publike Private, të drejtat e ndërprerjes së kontratës janë një element i detyrueshëm i një kontrate të Partneritetit Publik Privat. Kostot e palëve të treta mund të rikuperohen vetëm në bazë të ligjit të përgjithshëm të kontratave.

Bosnja dhe Hercegovina – Republika Serbe

Ligji i Republikës Serbe për Partneritetet Publike Private ia lë palëve të përcaktojnë të drejtat e ndërprerjes së një kontratë të Partneritetet Publike Private. Kostot e palëve të treta mund të rikuperohen vetëm në bazë të ligjit të përgjithshëm të kontratave.

Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë (IRJM)

⁴⁰ Neni 486 i Kodit Civil shqiptar.

Ligji i Maqedonisë për Partneritetet Publike Private parashikon dispozita specifike për të drejtat e të dy palëve për ndërprerjen e kontratës.⁴¹ Në shumicën e rasteve, kontrata e Partneritetit Publik Privat përmban të njëjtat dispozita ose specifikon më tej arsyet e ndërpres së kontratës. Nuk ka dispozita të qarta në lidhje me kompensimin. Çdo kompensim do të jepet bazuar në rregullat e përgjithshme për kompensimin ose bazuar në çdo dispozitë të zbatueshme të kontratës.

Kosova*

Ligji për Partneritetet Publike Private nuk parashikon rregulla për të drejtat e partnerit privat për ndërprerjen e kontratës. Këto të drejta dakordësohen në kontratën e Partneritetit Publik Privat.⁴² Ligji për Partneritetet Publike Private nuk shprehet për dëmet që paguhen pas ndërprerjes së kontratës për shkak të mosekzekutimit të detyrimeve nga autoriteti publik ose për shkak të ndërprerjes vullnetare.

Mali i Zi

Të drejtat e ndërprerjes së kontratës parashikohen në kontratën e Partneritetit Publik Privat. Në mungesë të dispozitave kontraktuale do të zbatoheshin rregulla të përgjithshme për ndërprerjen e kontratës. Ligji i Malit të Zi nuk rregullon kompensimin për kostot e palëve të treta.

Serbia

Partneri privat mund të ndërpresë në mënyrë të njëanshme kontratën e Partneritetit Publik Privat, në përputhje me Ligjin për Partneritetin Publik Privat, me kontratën e Partneritetit Publik Privat dhe rregullat e përgjithshme të së drejtës së kontratave. Kostot e palëve të treta mund të rikuperohen vetëm në bazë të së drejtës së përgjithshëm të kontratave.⁴³

Arsyet e ndërprerjes së kontratës dhe të drejtat e ndërprerjes së kontratës zakonisht përcaktohen në kontratën e Partneritetit Publik Privat. Ligji për Partneritetin Publik Privat⁴⁴ përmban një numër jo-shterues të arsyeve për ndërprerjen e kontratës për shkak të mosekzekutimit të detyrimeve nga qeveria:

- a) *Shpronësimi, konfiskimi ose blerja e aseteve ose e aksioneve të partnerit privat nga autoriteti publik;*
- b) *Mosbërja e pagesave nga autoriteti publik për shkak të partnerit privat; dhe*
- c) *Mosrespektimi nga autoriteti publik i detyrimeve të tij që e pengojnë në mënyrë të konsiderueshme ose e ndalojnë partnerin privat të përmbushë detyrimet e tij kontraktuale.*

Rregullat e veçanta të përcaktuara në kontratën e Partneritetit Publik Privat, si dhe rregullat e përgjithshme të së drejtës së kontratave zbatohen për pasojat e

⁴¹ Nenet 44 dhe 45 të Ligjit të Maqedonisë për Partneritetin Publik Privat.

⁴² Paragrafi 2.18 i Nenet 48 të Ligjit për Partneritetin Publik Privat.

⁴³ Nenet 154 dhe 158 të Ligjit të Serbisë për kontratat.

⁴⁴ Neni 55 i Ligjit të Serbisë për Partneritetet Publike Private.

ndërprerjes së parakohshëm të kontratës së Partneritetit Publik Privat për mosekzekutimit të detyrimeve nga ana e autoritetit publik.

13.3 Kompensimi për ndërprerjen e kontratës si pasojë e forcës madhore të shtrirë në kontratat e Partneritetit Publik Privat

Të gjitha kontratat e Partneritetit Publik Privat njohin parimin e forcës madhore dhe mbrojnë (në shkallë të ndryshme në varësi të projektit) partnerin privat nga pasojat e mos-performancës të shkaktuara nga ngjarje të tilla.

Për të mbrojtur palët nga efektet e një ngjarje të forcës madhore, kontrata e Partneritetit Publik Privat mund të parashikojë që secila palë të ketë të drejtë të ndërpresë kontratën e Partneritetit Publik Privat në rrethanat kur kjo ngjarje ka vazhduar për një periudhë të zgjatur (p.sh., gjashtë muaj).

Nëse kontrata e Partneritetit Publik Privat ndërpritet për shkak të një ngjarje të forcës madhore, atëherë autoritetit publik zakonisht i kërkohet të paguajë kompensim partnerit privat.

Metoda e zakonshme e përdorur në Partneritetet Publike Private është që autoriteti publik t'i paguajë partnerit privat kompensim të mjaftueshëm për të shlyer borxhin kryesor, për të rimbursuar shumat e kapitalit që janë investuar faktikisht nga investitorët dhe për të paguar kostot e ndërprerjes së kontratës me nënkontraktorët dhe të pagesave të paunësisë. Sidoqoftë, shuma e kompensimit zakonisht nuk pasqyron ndonjë humbje të të ardhurave të ardhshme ose vlerën e tregut të projektit. Rimbursimi i shumave të investuara nga investitorët mund të jetë shuma neto e pagesave që i janë bërë tashmë investitorëve.

Legjislacioni në vendet e Ballkanit Perëndimor: Forca madhore

Të gjitha juridiksionet e Ballkanit Perëndimor njohin parimin e forcës madhore, rrethanat e ndryshuara ose pamundësinë e ekzekutimit të detyrimeve. Më konkretisht:

Shqipëria

Ligji i Shqipërisë për koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat nuk shprehet për llogaritjen e kompensimit të ndërprerjes së kontratës si pasojë e forcës së zgjatur madhore.

Bosnja dhe Hercegovina – Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës (Kantoni i Hercegovina-Neretvas) dhe Republika Serbe

Partneri privat nuk do të kompensohet për ndonjë humbje të të ardhurave të ardhshme ose për vlerën e tregut të projektit.

Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë (IRJM)

Partneri privat nuk do të kompensohet për ndonjë humbje të të ardhurave të ardhshme ose për vlerën e tregut të projektit.

Kosova*

Ligji për Partneritetin Publik Privat shprehet se palët e një kontrate të Partneritetit Publik Privat mund të rregullojnë shkallën në të cilën secila palë mund të çlirohet nga përgjegjësia e mosekzekutimit të detyrimeve ose e vonesës së përbushjes së ndonjë detyrimi sipas Marrëveshjes së Partneritetit Publik Privat për shkak të rrethanave jashtë kontrollit të tij të arsyeshëm.⁴⁵

Mali i Zi

Dispozitat e këtij lloji mund të zbatohen nëse bihet dakord shprehimisht midis palëve.

Serbia

Partneri privat nuk do të kompensohet për ndonjë humbje të të ardhurave të ardhshme ose për vlerën e tregut të projektit.

13.4 Kompensimi për ndërprerjen e kontratës si pasojë e dhuratave të korruptuara dhe mashtrimit

Shumica e juridiksioneve të BE-së pranojnë se dhuratat korruptive dhe mashtrimi nga partneri privat duhet të çojnë në ndërprerjen e kontratës. Kjo zakonisht trajtohet si një mosekzekutim detyrimi nga ana e partnerit privat në bazë të kontratës së Partneritetit Publik Privat.

Legjislacioni në vendet e Ballkanit Perëndimor: Dhuratat e korruptuara dhe mashtrimi:

Shqipëria

Sipas kushteve standarde të përgjithshme të kontratave të koncesionit për punë,⁴⁶ autoriteti publik mund të bëjë kërkesë në gjykatë për pavlefshmërinë e kontratës nëse kontraktori ka kryer akte korrupsioni (p.sh., kontraktori jep ose premtun të japë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një zyrtari ose punonjësi, ndonjë kompensim të çfarëdo forme, mundësi punësimi ose mallra, shërbime ose para, për nxitje të miratimit të një akti, vendimi ose procedure që autoriteti publik kontraktor ndërmerr në procedurat e prokurimit). Këto kushte të përgjithshme nuk parashikojnë llogaritjen e kompensimit të partnerit privat në këtë situatë.

Kodi Civil Shqiptar tregon se çdo veprim që ndërmerret, ndër të tjera, në kundërshtim me një rregull të ligjit të detyrueshëm ose mashtrim është i pavlefshëm.⁴⁷ Të gjitha veprimet pasuese gjithashtu do të ishin të pavlefshme. Si rrjedhojë, e gjithë pasuria e dhënë nga palët njëri-tjetrit transferohet në buxhetin e shtetit.⁴⁸ Sidoqoftë, nëse njëra nga palët do të kishte vepruar me mirëbesim, gjykata mund të vendosë që pasuria t'i kthehej asaj pale në vend që të transferohej në buxhetin e Shtetit. Korrupsioni dhe mashtrimi janë akuza penale sipas Kodit Penal të Shqipërisë.

⁴⁵ Paragrafi 2.17 i Nenit 48 të Ligjit për Partneritetin Publik Privat.

⁴⁶ Neni 4 i kushteve të përgjithshme standarde shqiptare të kontratave të koncesionit për punë.

⁴⁷ Neni 92 i Kodit Civil shqiptar.

⁴⁸ Neni 106 i Kodit Civil Shqiptar.

Bosnja dhe Hercegovina - Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës (Kantoni i Hercegovina-Neretvas)

Ligjet e Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës nuk i njohin në mënyrë të qartë dhuratat e korruptuara si një rast për ndërprerjen e kontratës. Sidoqoftë, palët në një kontratë të Partneritetit Publik Privat mund të parashikojnë dhurata korruptive si një si një rast për ndërprerjen e kontratës. Për sa i përket mashtrimit, rregullat e përgjithshme të kontratës e rendisin mashtrimin si një nga arsyet e anulimit të kontratës dhe i japin palës së mashtruar të drejtën e shpërblimit për dëmet⁴⁹.

Bosnja dhe Hercegovina - Republika Serbe

Ligjet e Republikës Serbe nuk i njohin në mënyrë të qartë dhuratat korruptive si një ngjarje përfundimi. Sidoqoftë, palët në një kontratë të Partneritetit Publik Privat mund të parashikojnë dhurata korruptive si një ngjarje përfundimi. Për sa i përket mashtrimit, rregullat e përgjithshme të kontratës rendisin mashtrimin si një nga arsyet e anulimit të një kontrate dhe i japin të drejtën palës së mashtruar në kompensim për dëmet.⁵⁰

Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë (IRJM)

Sipas Ligjit të Maqedonisë për parandalimin e korrupsionit,⁵¹ korrupsioni përbën shkaqe të pavarura për shpalljen e një kontrate të pavlefshme. Çdo person që ka interes ligjor mund të bëjë kërkesë për anulimin e akteve juridike të korruptuara duke paraqitur një vendim gjyqësor të formës së prerë që konfirmon ekzistencën e korrupsionit. Çështja nëse partneri privat do të kompensohej apo jo në një rast të tillë mbetet e hapur.

Kosova*

Ligji për Partneritetin Publik Privat nuk shprehet për dhuratat korruptive dhe mashtrimet si raste ndërprerje të kontratës në kontratat e Partneritetit Publik Privat. Sipas Ligjit 2004/34 për shtypjen e korrupsionit (Neni 7), aktet juridike që rrjedhin nga akte korrupsioni janë të pavlefshme. Çdo person që ka pësuar dëmtime nga veprimet korruptive mund të kërkojë dëmshpërblim.

Mali i Zi

Ligjet e Malit të Zi njohin mashtrimin dhe dhuratat e korruptuara si bazë për anulimin e kontratës së koncesionit. Ligji për procedurën administrative⁵² përcakton se një kontratë e lidhur si rezultat i forcës, zhvatjes, shantazhit, presionit ose akteve të tjera të paligjshme është e pavlefshme. Mashtrimi dhe dhuratat e korruptuara hyjnë në fushën e veprimeve të paligjshme, pasi që të dy përfaqësojnë veprimtari kriminale në bazë të Kodit Penal.⁵³ Pasojat e anulimit janë

⁴⁹ Neni 65 i ligjit të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës për detyrimet.

⁵⁰ Neni 65 i Ligjit të Republikës Serbe për detyrimet.

⁵¹ Neni 46 i Ligjit për parandalimin e korrupsionit, botuar në Fletoren Zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr. 28/2002, i ndryshuar.

⁵² Nenet 28 dhe 139 të ligjit të Malit të Zi për procedurën administrative (Fletorja Zyrtare e Malit të Zi Nr. 56/14, 20/15, 40/16 dhe 37/17).

⁵³ Nenet 244, 423 dhe 424 të Kodit Penal të Malit të Zi ("Fletorja Zyrtare e Republikës së Malit të Zi" nr. 70/03, 13/04, 47/06 dhe "Fletorja Zyrtare e Malit të Zi") Nr. 40/08, 25/10, 32/11, 64/11, 40/13, 56/13, 14/15, 42/15, 58/2015 dhe 44/17).

(i) kthimi dhe (ii) kompensimi i dëmit (nëse ka). Vetëm një palë që nuk ka qenë në dijeni dhe nuk ka mundur të jetë në dijeni të arsyeve të anulimit, ka të drejtë të kërkojë shpërblim për dëmet. Kompensimi është shuma e dëmit faktik dhe fitimit të munguar.

Serbia

Ligji i Serbisë për Partneritetin Publik Privat nuk përmban dispozita në lidhje me ndërprerjen e kontratës së Partneritetit Publik Privat për dhurata të korruptuara dhe mashtrime. Sidoqoftë, kjo mund të jetë arsye për ndërprerjen e kontratës dhe për kompensimin bazuar në rregullat e përgjithshme të së drejtës së kontratave. Për sa i përket mashtrimit, rregullat e së drejtës së përgjithshme të kontratave⁵⁴ e rendisin mashtrimin si një nga arsyet e anulimit të kontratës dhe jep të drejtën që pala e mashtruar të kërkojë kompensim për dëmet.

14. Mbarimi i kontratës së Partneritetit Publik Privat

Kontrata e Partneritetit Publik Privat shpesh përcakton kërkesa për dorëzimin e infrastrukturës së projektit nga partneri privat tek autoriteti publik në fund të kontratës së Partneritetit Publik Privat.

Këto dispozita nxiten nga fakti nëse autoriteti publik ose partneri privat do të marrin apo jo përgjegjësinë e mëpasshme për infrastrukturën. Në shumicën e rasteve (por jo të gjitha), është autoriteti publik ai që e merr këtë përgjegjësi. Shih Kutinë 2.

Kutia 2 – Kur partneri privat merr përgjegjësinë pas mbarimit të kontratës

Në disa Partneritete Publike Private (veçanërisht në sektorin e strehimit), partneri privat ka pronësi ligjore të projektit të infrastrukturës gjatë kontratës së Partneritetit Publik Privat bazuar në faktin se autoriteti publik nuk do ta përdorë infrastrukturën kur përfundon kontrata e Partneritetit Publik Privat.

Këto lloje Partneritetesh Publike Private shpesh do t'i japin autoritetit publik, në fund të kontratës, të drejtën qoftë për të zgjatur afatin e kontratës së Partneritetit Publik Privat dhe/ose të drejtën për të blerë infrastrukturën përkatëse. Në mungesë të autoritetit publik që ushtron ndonjë të drejtë të tillë, marrëdhënia midis partnerit privat dhe autoritetit publik përfundon me përfundimin e kontratës së Partneritetit Publik Privat dhe partneri privat nuk ka asnjë detyrim tjetër ndaj autoritetit publik në lidhje me infrastrukturën.

Në rastet kur autoriteti publik merr përsipër përgjegjësinë për infrastrukturën në fund të kontratës, normalisht ai do ta bëjë këtë gjë pa i bërë partnerit privat ndonjë pagesë shtesë. Kontrata do të përcaktojë dispozita që sigurojnë se infrastruktura do t'i kthehet autoritetit publik në një gjendje që ai e gjykon të pranueshme. Efektshmëria e këtyre dispozitave varet nga përshtatshmëria e dispozitave teknike në lidhje me gjendjen e pritshme të infrastrukturës pas mbarimit të kontratës. Aspekte të tjera të rëndësishme të *dispozitave të dorëzimit* janë si më poshtë:

⁵⁴ Neni 65 i ligjit të Serbisë për kontratat.

- a) Kërkesa për një vlerësim të pavarur të gjendjes së infrastrukturës duhet bërë disa vjet (zakonisht 2 deri në 5 vjet) para mbarimit të kontratës së Partneritetit Publik Privat. Qëllimi i këtij vlerësimi është:
- Të vlerësojë punën që do të duhet të kryhet në mënyrë që infrastruktura t'i kthehet autoritetit publik në gjendje, të paktën, po aq të mirë siç kërkohet nga kontrata, dhe
 - Të vlerësojë koston e kësaj pune;
- b) Pas vlerësimit të pavarur të përmendur në Pikën a) më lart, partnerit privat mund t'i kërkohet të krijojë një fond tek i cili ai duhet të paguajë një shumë të barabartë me koston e përllogaritur për kryerjen e punëve të përcaktuara nga vlerësimi. Qëllimi i fondit është që ta sigurojë autoritetin publik se do të ketë fonde të mjaftueshme në dispozicion për të kryer punët e nevojshme (edhe nëse partneri privat nuk arrin t'i kryejë ato). Prandaj, kontrata e Partneritetit Publik Privat duhet të përcaktojë se shumatat mund të tërhiqen vetëm nga fondi për të paguar punën që është ndërmarrë nga partneri privat për të përmbushur kërkesat e kontratës së Partneritetit Publik Privat lidhur me dorëzimin e infrastrukturës;
- c) Kërkesa për çdo siguri shtesë që fondet e nevojshme do të jenë të disponueshme (për shembull, një sigurim kontrate ose një letër krediti); dhe
- d) Nëse partneri privat nuk kryen punën e nevojshme para përfundimit të kontratës së Partneritetit Publik Privat, atëherë autoritetit publik i lejohet të ketë akses në fondet e llogarisë së përmendur në Pikën b) ose të marrë sigurimin e kontratës/letrën e kreditit të përmendur në Pikën c) për qëllimet e kryerjes së kësaj pune.

Legjislacioni në vendet e Ballkanit Perëndimor: Dispozitat e dorëzimit

Shkalla në të cilën trajtohet kjo çështje në juridiksionet e Ballkanit Perëndimor jepet në mënyrë të përmbledhur më poshtë.

Shqipëria

Ligji për koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat nuk parashikon specifikat e dorëzimit të asetëve të projektit pas mbarimit të Partneritetit Publik Privat ose të kontratës së koncesionit. Kjo do të trajtohet përmes marrëveshjes së palëve të Partneritetit Publik Privat ose të kontratës së koncesionit.

Bosnja dhe Hercegovina - Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës (Kantoni i Hercegovina-Neretvas)

Nuk ka dispozita specifike që kërkohen në mënyrë të detyruar në kontratat e Partneritetit Publik Privat. Sidoqoftë, Ligji i Kantonit të Hercegovina-Neretvas për koncesionet shprehet se në marrëveshjen e koncesionit (e cila mund të jetë kontrata themelore për Partneritetin Publik Privat), palët duhet, përveç të tjerash, të specifikojnë një afat dhe procedurë për dorëzimin e asetëve pas mbarimit të koncesionit. Në mënyrë të ngjashme, Ligji i Kantonit të Hercegovina-Neretvas për Partneritetin Publik Privat parashikon një dispozitë për kushtet dhe procedurën e dorëzimit pas mbarimit si një nga elementët e detyrueshëm të kontratës së Partneritetit Publik Privat.

Bosnja dhe Hercegovina - Republika Serbe

Në ligjin e Republikës Serbe nuk ka dispozita të detyrueshme në këtë drejtim.

Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë (IRJM)

Ligji i Maqedonisë për Partneritetin Publik Privat nuk përmban specifika që kërkojnë në mënyrë të detyrueshme për dorëzimin e asetëve të projektit pas mbarimit të kontratës së Partneritetit Publik Privat. Ligji i Maqedonisë për Partneritetin Publik Privat⁵⁵ përcakton vetëm se asetet e projektit janë pronë e autoritetit publik, përveçse kur është rënë dakord ndryshe në kontratën e Partneritetit Publik Privat, dhe dorëzimi i asetëve të projektit pas mbarimit të kontratës së Partneritetit Publik Privat duhet të bëhet sipas kushteve dhe në mënyrën e rënë dakord në kontratën e Partneritetit Publik Privat.

Kosova*

Nuk ka dispozita specifike të detyrueshme në bazë të ligjeve të Kosovës në lidhje me dorëzimin e asetëve të projektit pas mbarimit të kontratës së Partneritetit Publik Privat. Në bazë të Paragrafit 2.18, të Nenit 48 të Ligjit për Partneritetin Publik Privat, kontrata e Partneritetit Publik Privat mund të parashikojë të drejtat dhe detyrimet e palëve pas mbarimit të kontratës së Partneritetit Publik Privat përfshirë edhe masat e transferimit.*

Mali i Zi

Pas mbarimit të kontratës së koncesionit, partneri privat duhet: (i) të kryejë rivitalizimin dhe/ose rikultivimin e zonave të degraduara nga kryerja e veprimtarisë së koncesionit, në përputhje me kushtet e kontratës së koncesionit; dhe (ii) të dorëzojë pajisjet, asetet dhe objektet që janë ndërtuar dhe përdorur për kryerjen e veprimtarisë koncesionare në gjendje të mirë funksionale dhe të lira nga çdo lloj barre, në përputhje me kontratën e koncesionit⁵⁶.

Serbia

Me përfundimin e kontratës së Partneritetit Publik Privat, objektet, pajisjet, impiantet dhe asetet e tjera që përbëjnë objektin e kontratës së Partneritetit Publik Privat bëhen pronë e autoritetit publik, përveç nëse përcaktohet ndryshe me marrëveshjen e drejtpërdrejtë midis autoritetit publik, partnerit privat dhe huadhënësve.

Partneri privat dorëzon objektin, pajisjet, impiantet dhe asetet e tjera, si dhe të gjitha objektet e tjera që përbëjnë objektin e kontratës së Partneritetit Publik Privat dhe janë në pronësi të autoritetit publik, të lira nga çdo barrë dhe në një gjendje që garanton përdorimin dhe funksionimin e tyre pa pengesa.⁵⁷

⁵⁵ Neni 11 i Ligjit të Maqedonisë për Partneritetin Publik Privat.

⁵⁶ Nenet 54 dhe 55 të Ligjit të Malit të Zi për koncesionet.

⁵⁷ Neni 57 i Ligjit të Serbisë për Partneritetin Publik Privat.

15. Çështjet e financimit

15.1 Pjesëmarrja e autoritetit publik në financim

Disa autoritete publike shqyrtojnë mundësinë e ofrimit të një forme të ndihmës financiare ose të kredisë për projektin me qëllim që:

- a) Të sigurohet që projekti është mjaft tërheqës për investitorët privatë (d.m.th., për të përmirësuar *besueshmërinë financiare* të tij);
- b) Të zvogëlohet kostoja e përgjithshme e projektit për autoritetin publik duke zvogëluar nevojat e përgjithshme të financimit privat;
- c) Të zvogëlohet pagesa e disponueshmërisë (d.m.th., të përmirësohet aftësia paguese), ose
- d) Të trajtohen shqetësimet në lidhje me nivelet e ulëta të likuiditetit në tregun përkatës (p.sh., një shqetësim se mund të mos ketë huadhënie të mjaftueshme, për shembull nga bankat tregtare, të disponueshme në treg për të financuar projektin; d.m.th., përmirësimi i aftësisë së financimit të projektit).

Disponueshmëria e llojeve të mbështetjes të përmendura më lart mund të jetë e kufizuar sipas ligjeve në fuqi (përfshirë rregullat e ndihmës shtetërore). Shembuj të zakonshëm të pjesëmarrjes së autoritetit publik në financimin e projekteve përfshijnë sa më poshtë vijon:

- a) **Pagesa e kësteve** të partnerit privat gjatë dhe/ose në fund të ndërtimit;
- b) Sigurimi i një **projekti të huadhënies publike** për partnerin privat (mundësisht me të njëjtat kushte si huadhënia e bankës tregtare);
- c) Sigurimi i një **garancie publike** të plotë ose të pjesshme të një pjese (ose të gjithë) borxhit të partnerit privat, me kërkesat për dëmshpërblim të autoritetit publik (d.m.th., kërkesa për dëmshpërblim që autoriteti publik do të kishte ndaj partnerit privat nëse ai bënte një pagesë në bazë të garancisë) duke qenë në vartësi të (d.m.th., të ketë renditje më të ulët se) çdo kërkesë për dëmshpërblim të huadhënësve kundër partnerit privat;
- d) Sigurimi i një **garancie** minimale i **të ardhurave** sipas kontratës, p.sh., sigurimin e partnerit privat për fluksin e parave përmes regjimit të zbritjeve në kontekstin e një strukture pagese të bazuar në disponueshmërinë (shih Seksionin 6); ose
- e) Sigurimi i **financimit me grant** përmes një pagese të drejtpërdrejtë kapitale për partnerin privat. Burimi i këtij financimi mund të jetë nga jashtë autoritetit publik (p.sh., grant i BE-së).

Legjislacioni në vendet e Ballkanit Perëndimor

Shqipëria

Sipas Ligjit për koncesionet & Partneritetin Publik Privat,⁵⁸ mbështetja financiare e autoritetit publik përcaktohet si "mbështetje monetare ose jo-monetare dhe/ose financim i dhënë nga sektori publik, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, subvencione, garanci financiare ose të tjera, kontribute në kapital dhe transferim të të drejtave të pronësisë".⁵⁹

Bosnja dhe Hercegovina – Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës (HNC)

Lejohet pagesa e kësteve nga autoriteti publik. Në bazë të Ligjit të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës për borxhet, detyrimet dhe garancitë që jepen për projektet kapitale, d.m.th., projektet e zhvillimit dhe projektet për përmirësimin dhe ndërtimin e infrastrukturës, lejohen gjithashtu edhe garancitë e autoritetit publik.⁶⁰

Bosnja dhe Hercegovina - Republika Serbe

Ligji i Republikës Serbe për Partneritetin Publik Privat lejon pagesat e kësteve nga autoriteti publik.⁶¹ Në mënyrë përjashtimore, qeveria mund të propozojë një lloj kontrate tjetër që nuk do të dëmtojë interesin publik, në përputhje me parimin e ekspozimit minimal financiar të autoritetit publik.

Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë (IRJM)

Sipas Ligjit të Maqedonisë, të gjithë shembujt e mësipërm të pjesëmarrjes së publikut janë të disponueshëm, në varësi të kushteve të përcaktuara në dokumentacionin e tenderit, ku disa prej tyre që i nënshtrohen kërkesave të rregullave të ndihmës shtetërore (p.sh., për dhënien e huave dhe garancive). Në praktikë, opsioni më i mundshëm është sigurimi i një garancie minimale të të ardhurave.

Kosova*

Autoriteti publik mund të japë mbështetje financiare ose mbështetje të tjera për të siguruar qëndrueshmërinë, zbatimin dhe/ose fizibilitetin financiar të projektit nëse është i argumentuar mirë dhe i aprovuar paraprakisht nga Komiteti i Partneritetit Publik Privat (KPPP-ja) dhe nga Ministri i Financave. Një mbështetje e tillë duhet të specifikohet në kërkesën për propozime.⁶² Në varësi të miratimit paraprak nga Komiteti i Partneritetit Publik Privat, qeveria mund të japë kompensim gjithashtu edhe për partnerin privat nëse gjendja financiare e partnerit privat preket negativisht dhe materialisht nga ndryshimet e paparashikueshme në ligj që kanë

⁵⁸ Ligji nr. 125/2013, i ndryshuar.

⁵⁹ Neni 3.16 i Ligjit për koncesionet & Partneritetin Publik Privat.

⁶⁰ Neni 53 i Ligjit të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës për borxhin, detyrimet dhe garancitë.

⁶¹ Nenet 4 dhe 10 të Ligjit të Republikës Serbe për Partneritetin Publik Privat.

⁶² Paragrafi 1 i Neni 12 të Ligjit për Partneritetin Publik Privat.

një ndikim të drejtpërdrejtë në infrastrukturën publike ose shërbimet publike që Partneri privat përdor ose siguron.⁶³

Nëse autoritetit publik i kërkohet të marrë hua ose të japë garanci për financimin e çdo detyrimi ndaj partnerit privat ose nëse zbatohen rregullat e ndihmës shtetërore, atëherë çdo hua ose garanci e tillë do t'i nënshtrohet Ligjit për Borxhin Publik⁶⁴.

Mali i Zi

Qeveria e Malit të Zi mund të marrë pjesë në financimin e projekteve përmes opsioneve të listuara në Pikat c), d) dhe e) më lart, duke iu nënshtuar rregullave vendore të ndihmës shtetërore. Ndonëse sigurimi i garancive dhe fondi i grantit mundësohet drejtpërdrejt (me kufizime të caktuara) nga Ligji për ndihmën shtetërore,⁶⁵ sigurimi i një garancie minimale për të ardhurat sipas kontratës varet nga kushtet e secilës kontratë individuale në fjalë. Ligji i Malit të Zi për koncesionet⁶⁶ nuk shprehet për këtë çështje, duke e lënë në dorë të autoritetit publik dhe partnerit privat që t'i negociojnë dhe t'i rregullojnë këto çështje në një kontratë koncesioni. Në praktikë, deri më tani nuk është përdorur asnjë nga opsionet e listuara më lart.

Serbia

Kushtet në të cilat Qeveria e Serbisë mund të lëshojë garanci rregullohen me Ligjin e Serbisë për borxhin publik.⁶⁷ Qeveria mund të lëshojë vetëm garanci shtetërore për borxhin që rrjedh nga marrëveshjet e kredisë së autoriteteve vendore dhe personave juridikë që krijohen nga shteti. Këto garanci duhet të parashikohen në buxhet për vitin përkatës dhe mund të zbatohen vetëm për kreditë për investime kapitale, jo për financimin e likuiditetit. Garancitë shtetërore jepen në formën e një ligji.

Llojet e tjera të pjesëmarrjes së autoritetit publik në financim janë të disponueshme sipas ligjeve në fuqi, por mund të jenë subjekt i kufizimeve të caktuara bazuar në ligje të tjera sektoriale ose të ndihmës shtetërore. Sidoqoftë, sigurimi nga autoriteti publik i një kredie për partnerin privat nuk është praktikë e zakonshme në tregun e Partneritetit Publik Privat të Serbisë.

15.1.1 Pagesat e kësteve

Kontrata e Partneritetit Publik Privat mund t'i kërkojë autoritetit publik që ai t'i bëjë pagesa partnerit privat përpara se të përfundojë ndërtimi. *Autoriteti publik nuk duhet t'i paguajë në asnjë rrethanë më shumë partnerit privat se sa është shpenzuar nga partneri privat.*

⁶³ Paragrafi 3 i Nenit 12 të Ligjit për Partneritetin Publik Privat.

⁶⁴ Paragrafi 4 i Nenit 12 të Ligjit për Partneritetin Publik Privat.

⁶⁵ Neni 7 i Ligjit për ndihmën shtetërore të Malit të Zi ("Fletorja Zyrtare e Malit të Zi" Nr. 74/09 dhe 57/11).

⁶⁶ Ligji për koncesionet (Fletorja Zyrtare e Malit të Zi nr. 08/09).

⁶⁷ Neni 16 i Ligjit të Serbisë për borxhin publik ("Fletorja Zyrtare e Republikës së Serbisë", Nr. 61/2005, 107/2009, 78/2011 dhe 68/2015).

Shembuj të mënyrës së pagesave të kësteve përfshijnë sa më poshtë vijon:

- a) Autoriteti publik i bën një pagese thelbësore partnerit privat menjëherë pas mbylljes së kontratës ose mbylljes financiare për ta ndihmuar partnerin privat që ai të mbulojë kostot e tij të zhvillimit dhe mobilizimit fillestar.
- b) Autoriteti publik i bën një seri pagesash partnerit privat gjatë fazës së ndërtimit të projektit, ku secila pagesë është e kushtëzuar për partnerin privat në mënyrë që ai të arrijë objektivat e përcaktuara qartë në përparimin e ndërtimit.
- c) Në një projekt me shumë faza, autoriteti publik i bën një pagesë të konsiderueshme partnerit privat në përfundimin e secilës fazë dhe në fund të fazës së ndërtimit.

15.1.2 Projektet e huadhënies publike

Autoriteti publik (ose ndoshta një organ tjetër publik) mund të mendojë që t'i japë një hua partnerit privat:

- a) Kur ka likuiditet të pamjaftueshëm në tregun e huadhënies. Autoriteti publik (ose një organ tjetër publik) do t'i japë një hua partnerit privat me normat e tregut tregtar, d.m.th., me të njëjtat kushte si huadhënësit kryesorë.
- b) Të zvogëlojë koston e përgjithshme të financimit.

15.1.3 Garancitë publike

Tek Partneritetet Publike Private zakonisht përdoren tre kategori kryesore garancish publike:

- a) Dispozitat e përfshira në kontratën e Partneritetit Publik Privat që kanë efektin e garantimit të një niveli minimal të të ardhurave për partnerin privat (d.m.th., autoriteti publik nuk lëshon një dokument të veçantë garancie, por ka një detyrim të pakushtëzuar pagese sipas kontratës së Partneritetit Publik Privat);
- b) Kur autoriteti publik (ose një organ tjetër publik) lëshon një garanci të veçantë për një huadhënës të palës së tretë të borxhit që përmirëson cilësinë e huasë dhe bën të mundur që projekti të përfitojë nga një kosto më e ulët e kapitalit; dhe
- c) (Në raste të jashtëzakonshme) autoriteti publik mund të japë një *garanci të rifinancimit*, e cila i siguron partnerit privat mbrojtje nëse nuk është në gjendje të rifinancojë borxhin e tij me një çmim të paracaktuar deri në një datë të caktuar.

Legjislacioni në vendet e Ballkanit Perëndimor

Në lidhje me garancitë e përshkuara në Pikën c) më lart:

Kosova*

Shteti (duke vepruar përmes Ministrit të Financave) mund të lëshojë garanci shtetërore në mbështetje të detyrimeve të huasë të subjekteve private që financojnë projekte të infrastrukturës publike ose projekte që kanë të bëjnë me një sektor ekonomik me rëndësi strategjike dhe sociale për Kosovën, përfshirë këtu partnerin privat të një projekti. Garancitë shtetërore i nënshtrohen ratifikimit me një shumicë prej dy të tretave të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës.*⁶⁸*

Bosnja dhe Hercegovina – Republika Serbe

Kreditorit ose huadhënësit mund t'i jepet garanci shtetërore për detyrimet e kredisë së një personi juridik të Bosnjës dhe Hercegovinën për zbatimin e projekteve prioritare të një rëndësie të veçantë për stabilitetin ekonomik të Republikës Serbe. Mund të argumentohet se qeveria (shteti) mund të sigurojë një garanci ligjore për detyrimet e huasë së partnerit të projektit nëse projekti i Partneritetit Publik Privat plotëson kriteret e mësipërme.

15.2 Risku i normës së interesit

Risku i normës së interesit zakonisht i përket partnerit privat. Për të trajtuar çdo ekspozim që mund të ketë ndaj interesit të luhatshëm të interesit, partneri privat do të mbrojë ekspozimin e tij përmes përdorimit të ndryshimeve afatgjata të interesit fiks/të ndryshueshëm të interesit.

Për alokimin e riskut të normës së interesit midis palëve mund të përdoren metodat e mëposhtme:

- a) Autoriteti publik merr riskun/shpërblimin e lidhur me luhatjet e *normës bazë referuese të interesit* (d.m.th., EURIBOR ose LIBOR) gjatë periudhës midis datës që partneri privat ka paraqitur ofertën e tij dhe datës së mbylljes financiare. Duket se kjo metodë paraqet vlerën më të mirë të parasë. (Kjo duket se mbështetet në faktin që, në mungesë të një mekanizmi të tillë, partneri privat ka të ngjarë të përfshijë një element mbrojtës të rëndësishëm në çmimin e ofertës së tij për t'u mbrojtur kundër asaj që mund të perceptohet si skenari i rasti më të keq në lidhje me luhatjet e normave të interesit);
- b) Gjatë periudhave të normave të larta të interesit (p.sh., gjatë krizës financiare globale, kur nivelet e likuiditetit të borxhit afatgjatë ranë ndjeshëm, duke çuar në një rritje pasuese të kostos së borxhit afatgjatë), autoriteti publik mund të vendosë të përfshijë të drejtën për t'i kërkuar partnerit privat që ai të ndër marrë një rifinancim, ku çdo fitim i rifinancimit rezultues (d.m.th., një fitim financiar i nxjerrë nga çmimi më i ulët i borxhit të ri) kryesisht në përfitim të autoritetit publik;

⁶⁸ Neni 19 i Ligjit nr. 03 / L-175 "Për borxhin publik".

- c) Autoriteti publik përcakton riskun/shpërblimin e luhatjeve të normës bazë referencë të interesit përtej mbylljes financiare dhe gjatë afatit të kontratës së Partneritetit Publik Privat. Në këto raste, kostoja e normës bazë të interesit për projektin i kalohet autoritetit publik dhe pagesa e disponueshmërisë përshtatet për të garantuar që të ardhurat e partnerit privat sigurojnë një mbrojtje natyrore kundër luhatjeve të normës bazë referencë të interesit.

15.3 Risku i kursit të këmbimit

Risku i kursit të këmbimit mund të lindë kur ka mospërputhje midis fluksit të parave të projektit të Partneritetit Publik Privat që është në monedha të ndryshme (për shembull kur pagesat e disponueshmërisë bëhen në monedhën vendase dhe pagesat e shërbimit të borxhit në një valutë të huaj). Kjo përbën problem veçanërisht kur ka mungesë likuiditeti në tregjet e monedhave vendase dhe/ose kursi i këmbimit është i paqëndrueshëm.

Çështja e kursit të këmbimit është e lidhur ngushtë gjithashtu edhe me riskun e normës së interesit (diskutuar më lart). Projektet e Partneritetit Publik Privat zakonisht kërkojnë që pagesat e shërbimit të borxhit të jenë kryesisht të fiksuara (d.m.th., të njohura) në mbylljen financiare, në mënyrë që të mos e ekspozojnë gjendjen financiare të partnerit privat ndaj luhatjeve të normave të interesit gjatë kohëzgjatjes së kontratës.

Fiksimi i normës së interesit të borxhit zakonisht përfshin një rregullim të shkëmbimit të normës së interesit që është vendosur në mbylljen financiare. Sidoqoftë, tregjet e shkëmbimit të huasë afatgjatë kanë tendencë të jenë shumë të kufizuara kur huaja nuk përcaktohet në një *monedhë kryesore rezervë* (p.sh., Euro, Sterlina, Dollarë Amerikan, Jen Japonez). Me fjalë të tjera, edhe kur huaja mund të merret në monedhën vendase, tregjet e këmbimit shpesh janë shumë të kufizuara për të lejuar që norma e interesit e asaj huaje të shndërrohet në normë fikse.

Në tregjet evropiane të Partneritetit Publik Privat përdoren përgjithësisht katër metoda kryesore për ta trajtuar këtë çështje.

- a) Pagesa e disponueshmërisë caktohet në monedhën vendase dhe projekti financohet në një monedhë rezervë; risku afatgjatë i monedhës merret nga autoriteti publik.

Partneriteti Publik Privat financohet në monedhën rezervë dhe partneri privat merr riskun e normës së interesit gjatë kohëzgjatjes së kontratës së Partneritetit Publik Privat. Partneri privat e menaxhon atë risk përmes një shkëmbimi të normës së interesit. Pagesa e disponueshmërisë bëhet në monedhën vendase, por shuma e paguar (e rregulluar për të gjitha zbritjet) rivendoset në mënyrë periodike për të reflektuar ndryshimet e kursit të këmbimit midis monedhave vendase dhe rezervës. Prandaj, autoriteti publik merr riskun e çdo luhatje afatgjatë të kursit të këmbimit.

- b) Pagesa e disponueshmërisë bëhet në monedhën vendase dhe projekti financohet në monedhën vendase; risku afatgjatë i normës së interesit merret nga autoriteti publik.

Partneritetit Publik Privat financohet në monedhën vendase, ku supozohet se tregu do të mbështesë shumën e plotë të kredisë në maturimin e kërkuar. Partneri privat mban riskun e interesit për një periudhë afatshkurtër fikse (p.sh., pesë vjet) ku mbrojtja është e disponueshme me një kosto të përballueshme. Pagesa e disponueshmërisë bëhet gjithashtu në monedhën vendase. Shuma që duhet të paguhet rivendoset periodikisht pas mbylljes financiare (p.sh., çdo tre deri në pesë vjet) gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës për të reflektuar ndryshimet në normën bazë të interesit. Autoriteti publik merr përsipër riskun e çdo luhatje të normave të interesit në mënyrë periodike gjatë afatit të kontratës.

- c) Pagesa e disponueshmërisë bëhet në monedhën vendase dhe projekti financohet me një maturim financiar të shkurtër në monedhën vendase; risku i rifinancimit merret nga autoriteti publik.

Partneriteti Publik Privat financohet në monedhën vendase, por për një maturim më të shkurtër se afati i kontratës, p.sh., tetë deri në dhjetë vjet. Partneri privat merr riskun e normës së interesit për maturimin e huasë, duke supozuar se është e disponueshme mbrojtja e normës së interesit me një kosto të përballueshme për një afat të tillë. Projekti rifinancohet në fund të periudhës fillestare të financimit, ku autoriteti publik merr riskun e disponueshmërisë së financimit të huasë së re me një kosto të përballueshme.

- d) Pagesa e disponueshmërisë bëhet në monedhën vendase dhe rezervë dhe projekti financohet në monedhën rezervë; risku afatgjatë i monedhës merret nga autoriteti publik në pjesën e paguar në monedhën rezervë.

Huaja për projektin merret në monedhën rezervë. Partneri privat merr riskun e normës së interesit në atë shumë për kohëzgjatjen e kontratës (menaxhohet përmes këmbimit të normave të interesit). Autoriteti publik merr përsipër riskun e kursit të këmbimit për pjesën e pagesës së disponueshmërisë, e cila ka të bëjë me kostot e projektit të shprehura në monedhën rezervë (p.sh., shërbimi i borxhit). Pagesa faktike e disponueshmërisë mund të bëhet ose në monedhën rezervë ose në atë vendase. Nëse bëhet në monedhën vendase, atëherë pagesa e disponueshmërisë rregullohet në mënyrë periodike që të pasqyrojë kursin mbizotërues të këmbimit.

Pjesa e mbetur e pagesës së disponueshmërisë bëhet në monedhën vendase dhe paguhet në atë monedhë. Kjo pjesë e pagesës së disponueshmërisë zakonisht do të pasqyrojë, sa më saktë që të jetë e mundur, kostot e funksionimit që krijohen në monedhën vendase në mënyrë që të krijojë një mbrojtje natyrore. Nëse kjo nuk është e mundur, atëherë autoriteti publik mund të duhet të supozojë ndonjë risk afatgjatë të normës së interesit (shih opsionet b) dhe c) më lart).

Në varësi të metodës së miratuar, procesi i prokurimit mund të kërkojë njëfarë përshtatje, veçanërisht nëse në ofertat përfundimtare kërkohet financim i angazhuar. Në të kundërt, mund të organizohet një konkurrim i financimit të ofertuesit më të preferuar pas pranimit të ofertave përfundimtare.

16. Të drejtat e ndërhyrjes

16.1 Panoramë e përgjithshme

Të drejtat e ndërhyrjes bëjnë të mundur që dikush të zëvendësojë një palë që nuk ka ekzekutuar detyrimet në mënyrë që të mund të korrigjojë një mosekzekutim detyrimi dhe të parandalojë zgjidhen e kontratës.

Ekzistojnë dy lloje kryesore të të drejtave të ndërhyrjes në Partneritetin Publik Privat:

- a) Të drejtat e ndërhyrjes së autoritetit publik; dhe
- b) Të drejtat e ndërhyrjes së huadhënësit.

16.2 Të drejtat e ndërhyrjes së autoritetit publik

Kontrata e Partneritetit Publik Privat mund të garantojë që autoriteti publik të marrë përkohësisht përgjegjësinë (ose të ndërhyjë) në ofrimin të shërbimeve për të cilat partneri privat ka përgjegjësinë për t'i ofruar në bazë të kontratës së Partneritetit Publik Privat.

Të drejtat e ndërhyrjes së autoritetit publik në një kontratë të Partneritetit Publik Privat zakonisht lejojnë ndërhyrjen për arsye të mëposhtme:

- a) Aty ku është në interes të publikut për të vepruar në këtë mënyrë, p.sh., kur ka shqetësime për shëndetin dhe sigurinë, çështje të sigurisë kombëtare dhe/ose autoriteti publik duhet të ndërhyjë për të përmbushur një detyrë ligjore; ose
- b) Kur partneri privat nuk përmbush detyrimet e kontratës së Partneritetit Publik Privat dhe autoriteti publik propozon që të ndërhyhet për të shmangur ndërprerjen e kontratës së Partneritetit Publik Privat.

Të drejtat e ndërhyrjes në kontratën e Partneritetit Publik Privat do të kërkojnë gjithashtu që autoriteti publik:

- a) Ta njoftojë paraprakisht partnerin privat për qëllimin e tij për të ndërhyrë (dhe në disa raste, edhe huadhënësit);
- b) Të ndërhyjë vetëm për një periudhë kohe që është e arsyeshme për të trajtuar problemin që ka sjellë ndërhyrjen; dhe
- c) Të kufizojë veprimet e tij vetëm në trajtimin e problemit që ka sjellë ndërhyrjen.

Në të njëjtën kohë:

- a) Kontrata e Partneritetit Publik Privat mund t'i kërkojë autoritetit publik që të vazhdojë shlyerjen e pagesës së disponueshmërisë për partnerin privat. Nëse shkak i ndërhyrjes është shkelja e kontratës së Partneritetit Publik Privat nga partneri privat, atëherë autoriteti publik do të ketë të drejtë të zbresë nga pagesat e tilla kostot që i janë shkaktuar në mënyrë të arsyeshme gjatë periudhës së ndërhyrjes;
- b) Kur ndërhyrja vjen si rezultat i mosekzekutimit të detyrimeve nga partneri privat, atëherë autoriteti publik mund të lejohet të lidhë kontrata detyruese ose të përdorë palë të treta (në emër të partnerit privat) për punë ose shërbime

gjatë periudhës së ndërhyrjes (kjo e drejtë mund të jetë e kufizuar në kohë); dhe

- c) Kur autoriteti publik njofton huadhënësit për vendimin e tij për të ndërhyrë në kontratën e Partneritetit Publik Privat, atëherë huadhënësit mund të kenë të drejtë ta shmangin një hap të tillë duke vendosur të ushtrojnë të drejtat e tyre të ndërhyrjes.

Legjislacioni në vendet e Ballkanit Perëndimor: Të drejtat e ndërhyrjes

Shqipëria

Ligji për koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat nuk i jep autoritetit publik të drejta ndërhyrjeje. Këto të drejta mund të dakordësohen në kontratat e Partneritetit Publik Privat.

Bosnja dhe Hercegovina

Ligjet përkatëse nuk i sigurojnë autoritetit publik të drejta ndërhyrje ose të drejta të ngjashme.

Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë (IRJM)

Sipas Ligjit të Maqedonisë, nuk ka dispozita të qarta në lidhje me këtë. Sidoqoftë, nuk ka asnjë kufizim në kontratat e Partneritetit Publik Privat për sa i përket këtyre të drejtave.

Kosova*

Këto çështje mund t'i rregullojë kontrata e Partneritetit Publik Privat.⁶⁹

Mali i Zi

Ligjet malazeze nuk parashikojnë të drejta hapi të autoritetit publik ose ndonjë të drejtë të ngjashme.

Serbia

Sipas Ligjit të Serbisë për Partneritetin Publik Privat,⁷⁰ kontrata e Partneritetit Publik Privat mund ta lejojë autoritetin publik që të pezullojë plotësisht ose pjesërisht marrëveshjet ose të marrë përsipër detyrimet përkatëse të partnerit privat për të mbrojtur interesin publik, sigurinë publike, mjedisin ose shëndetin publik, ose nëse Partneri privat ka shkelur kontratën.

16.3 Të drejtat e ndërhyrjes së huadhënësit

Të drejtat e ndërhyrjes së huadhënësit në përgjithësi mund të ushtrohen vetëm kur partneri privat ka ekzekutuar detyrimet ose është paraqet risk të madh vonese sipas kontratës së Partneritetit Publik Privat, dhe kjo ka të ngjarë të rezultojë në ndërprerje të kontratës.

⁶⁹ Paragrafi 2.22 i Nenit 48 të Ligjit për Partneritetin Publik Privat.

⁷⁰ Neni 46 i Ligjit të Serbisë për Partneritetin Publik Privat.

Të drejtat e ndërhyrjes u japin huadhënësve përfitim në kohë dhe fleksibilitet për të korigjuar çdo gjë që ka bërë partneri privat që rrezikon ndërprerjen e projektit. Në rastin më të mirë, të gjitha palët mund të përfitojnë nga të drejtat e ndërhyrjes, d.m.th., huadhënësit kanë mundësinë që të mbrojnë investimin e tyre ndërkohë që autoritetet publike dhe përdoruesit e infrastrukturës mund të përfitojnë nga vazhdimësia e projektit.

Shqetësimi i menjëhershëm i autoritetit publik është të sigurojë që, nëse ndodh ndërhyrja, të ruhet si alokimi i riskut ashtu edhe ofrimi i shërbimit dhe që ndërhyrja të mos e përkeqësojë situatën dhe që autoriteti publik të mos marrë një aset që ai nuk mund ta përdorë më për asgjë.

Me dhënien e të drejtave të ndërhyrjes për huadhënësit, autoriteti publik do të dëshirojë të sigurojë që:

- Dikush është akoma përgjegjës për shkeljet e bëra deri në momentin e ndërhyrjes;
- Dikush mbetet përgjegjës për shkeljet e bëra gjatë periudhës së ndërhyrjes;
- Është caktuar një afat kohor për përpjekjet e huadhënësve për të rregulluar mosekzekutimin detyrimeve nga ana e partnerit privat; dhe
- Vendosen kufij për veprimet që huadhënësit mund të ndërmarrin (p.sh., në veçanti në identitetin dhe natyrën e çdo zëvendësuesi të përkohshëm ose të përhershëm të partnerit privat që huadhënësit mund të caktojnë).

Të drejtat e ndërhyrjes së huadhënësit shpesh rregullohen përmes *një marrëveshjeje të drejtpërdrejtë* midis autoritetit publik, partnerit privat dhe huadhënësve (ose një përfaqësuesi të huadhënësve).

Kur huadhënësve u jepet mundësia për të ndërhyrë, atyre u lejohej të ushtrorjnë të drejtat e partnerit privat në bazë të kontratës së Partneritetit Publik Privat, por ata duhet të marrin përsipër gjithashtu edhe disa detyrime të partnerit privat. Për shembull, huadhënësve mund t'u kërkohet të paguajnë ose të sigurojnë pagesën e shumave të papaguara që partneri privat i a ka borxh autoritetit publik.

Për të nxitur huadhënësit që të ndërhyjnë, autoriteti publik do të marrë përsipër, në marrëveshjen e drejtpërdrejtë, që të mos ndërpresë kontratën e Partneriteti Publik Privat gjatë ndërhyrjes. Kjo mund t'i sigurojë huadhënësit që ata do të kenë një periudhë të arsyeshme për të korigjuar problemet e performancës së dobët. Megjithatë, autoriteti publik do të ruajë normalisht të drejtën për të ndërprerë kontratën e Partneritetit Publik Privat për çdo shkelje të re që ndodh gjatë periudhës së ndërhyrjes.

Pëlqimi i autoritetit publik zakonisht kërkohet si një parakusht ndaj huadhënësve që ndërmarrin masa për transferimin e kontratës së Partneritetit Publik Privat tek një partner privat zëvendësues ose për të zëvendësuar nënkontraktuesit kryesorë të projektit. E drejta e autoritetit publik për të kundërshtuar propozimet e huadhënësve për të ndërmarrë ndonjë veprim të tillë do të jetë e kufizuar dhe e përcaktuar në mënyrë objektive në marrëveshjen e drejtpërdrejtë ose në kontratën e Partneritetit Publik Privat. Kjo u mundëson huadhënësve që të kuptojnë rrethanat, në të cilat ka të ngjarë të mos jepet pëlqimi i autoritetit publik.

Përveç këtyre të drejtave të ndërhyrjes, huadhënësit shpesh do të kenë të drejtë të marrin përsipër funksionimin e partnerit privat duke vendosur një barrë mbi aksionet e partnerit privat (i cili është një element standard i paketës së sigurisë së huadhënësit në financimin e projektit) dhe duke bërë zëvendësimin e menaxhimit të partnerit privat.

Legjislacioni në vendet e Ballkanit Perëndimor: Të drejtat e ndërhyrjes së huadhënësve

Shqipëria

Të drejtat e ndërhyrjes së huadhënësve nuk janë të përfshira në mënyrë specifike në Ligjin për koncesionet dhe Partneritetet Publike Private. Sidoqoftë, ky Ligj shprehet se autoriteti publik mund të lidhë marrëveshje shtesë që synojnë të sigurojnë financimin përkatës të projektit.⁷¹ Marrëveshjet shtesë (të njohura si "marrëveshje të drejtpërdrejta") të lidhura midis autoritetit publik, partnerit privat dhe huadhënësve zakonisht parashikojnë të drejtat e ndërhyrjes së huadhënësve.

Bosnja dhe Hercegovina - Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës (Kantoni i Hercegovina-Neretvas)

Ligji i Kantonit të Hercegovina-Neretvas për Partneritetin Publik Privat nuk parashikon të drejtat e ndërhyrjes së huadhënësve. Ligji i Kantonit të Hercegovina-Neretvas për koncesionet parashikon mundësinë e përgjithshme të transferimit të të drejtave të koncesionit, por është e diskutueshme nëse kjo mundësi mund të përdoret për t'u mundësuar huadhënësve që të ndërhyjnë nëse partneri privat nuk mund të përmbushë detyrimet e tij.

Bosnja dhe Hercegovina - Republika Serbe

Ligji i Republikës Serbe për koncesionet⁷² parashikon të drejtat e ndërhyrjes së huadhënësve kur partneri privat nuk mund të përmbushë detyrimet e tij. Ligji i Republikës Serbe për Partneritetin Publik Privat⁷³ lejon palët të transferojnë gjithashtu edhe të drejtat dhe detyrimet e partnerit privat tek një person i tretë, me pëlqimin e autoritetit publik.

Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë (IRJM)

Sipas Ligjit të Maqedonisë për Partneritetin Publik Privat,⁷⁴ kontrata e Partneritetit Publik Privat mund të sigurojë të drejta ndërhyrje për huadhënësit nëse ndërhyrja nuk ndikon negativisht në funksionimin e projektit, cilësinë e shërbimeve ose çmimin. Autoriteti publik, partneri privat dhe huadhënësit mund të lidhin gjithashtu edhe një marrëveshje të drejtpërdrejtë.

⁷¹ Neni 27 i Ligjit për koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat.

⁷² Neni 40 i Ligjit të Republikës Serbe për koncesionet.

⁷³ Neni 14 i Ligjit të Republikës Serbe për Partneritetin Publik Privat.

⁷⁴ Neni 42 i Ligjit maqedonas për Partneritetin Publik Privat.

Kosova*

Sipas Ligjit për Partneritetin Publik Privat, kontrata e Partneritetit Publik Privat mund të rregullojë të gjitha çështjet që palët i vlerësojnë të përshtatshme, përfshirë edhe të drejtat e ndërhyrjes së huamarrësve.⁷⁵

Mali i Zi

Sipas ligjit në fuqi, huadhënësve nuk u jepen të drejta ndërhyrje, megjithëse të drejtat e ndërhyrjes mund të dakordësohen me kontratë.

Serbia

Sipas Ligjit të Serbisë për Partneritetin Publik Privat,⁷⁶ autoriteti publik mund të pranojë që huadhënësit të jenë të autorizuar që të zëvendësojnë partnerin privat, të ushtrojnë përkohësisht të gjitha të drejtat e tij në bazë të kontratës së Partneritetit Publik Privat dhe të korrigojnë çdo shkelje të shkaktuar prej tij. Sidoqoftë, autoriteti publik mund të ndërpresë në mënyrë të njëanshme kontratën e Partneritetit Publik Privat nëse partneri privat transferon të drejtat e tij sipas kontratës së Partneritetit Publik Privat tek një palë e tretë pa miratimin paraprak të autoritetit publik.

⁷⁵ Paragrafi 2.22 i Nenit 48 të Ligjit për Partneritetin Publik Privat.

⁷⁶ Nenet 49 dhe 54 të Ligjit të Serbisë për Partneritetin Publik Privat.

17. Influenca e qeverisë

17.1 Panoramë e përgjithshme

Nga këndvështrimi i autoritetit publik, një nga objektivat më të rëndësishëm të projektit është mbrojtja e interesit publik. Prandaj autoritetit publik dëshiron të ketë njëfarë ndikimi mbi veprimet dhe sjelljet e partnerit privat, gjë të cilën ai mund të arrijë në dy mënyra kryesore:

- **Influenca përmes kontratës së Partneritetit Publik Privat:** duke përfshirë në kontratën e Partneritetit Publik Privat dispozita që i kërkojnë partnerit privat të marrë miratimin ose pëlqimin e autoritetit publik përpara se të ndërmarrë veprime të caktuara. Kjo është mënyrë më e zakonshme që përdoret nga autoritetet publike; dhe
- **Pjesëmarrja në menaxhimin ose funksionimin e partnerit privat:** nëpërmjet investimit të kapitalit me të drejtë vote tek partneri privat, autoriteti publik ka mundësinë të votojë në mbledhjet e aksionarëve, të aksesojë informacionin në lidhje me mënyrën e marrjes së vendimeve dhe të përfshihet në vendimmarrje (në atë masë që autoriteti publik ka të drejtën të emërojë një anëtar në bordin e partnerit privat). Kjo nuk është një metodë e zakonshme dhe, kur përdoret, zakonisht kombinohet me ndikimin që ushtrohet nëpërmte dispozitave të kontratës së Partneritetit Publik Privat.

17.2 Influenca përmes kontratës së Partneritetit Publik Privat

Kontratat e Partneritetit Publik Privat përfshijnë normalisht dispozita që i kërkojnë partnerit privat të marrë miratimin paraprak të autoritetit publik kur ndërmerr veprimeve të caktuara. Megjithëse, në përgjithësi, autoriteti publik nuk mund ta parandalojë partnerin privat që të ndërmarrë veprime, partneri privat do të shkelë kontratën e Partneritetit Publik Privat nëse e bën këtë pa miratimin paraprak të autoritetit publik. Çdo shkelje e tillë zakonisht do të përbëjë një mosekzekutim detyrimi nga ane e partnerit privat dhe mund të bëjë të mundur që autoriteti publik të ndërpresë kontratën.

Veprimet e mëposhtme zakonisht kërkojnë miratimin e partnerit publik:

- **Ndryshimet në përbërjen e partnerit privat:** partneri privat ka të ngjarë të jetë një subjekt për qëllime të veçanta (SPV) i krijuar me qëllimin e vetëm për të realizuar projektin. Nga këndvështrimi i një autoriteti publik, kjo do të thotë që pala tjetër e kontratës së Partneritetit Publik Privat nuk është e ekspozuar ndaj riskut të falimentimit për shkak të kryerjes së aktiviteteve të biznesit që nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me projektin e Partneritetit Publik Privat.
- Shumë autoritete publike besojnë se kjo është një karakteristikë e rëndësishme e strukturës së projekteve dhe, kështu, ato janë të interesuara të sigurojnë që pozicioni të mos ndryshojë gjatë afatit të kontratës së Partneritetit Publik Privat. Prandaj, shumë kontrata të Partneritetit Publik Privat përfshijnë dispozita që i kërkojnë partnerit privat të marrë miratimin paraprak të autoritetit publik për sa më poshtë vijon:
 - a) Ndryshimet të dokumenteve të përbërjes së partnerit privat;

- b) Ndryshime të adresës zyrtare që partneri privat ka dhënë lidhur me taksat;
 - c) Ndërmarrje e një biznesi që nuk ka lidhje me projektin; dhe
 - d) Ndryshimi i emrit të partnerit privat.
- **Ndryshimet në personelin kryesor:** kontrata e Partneritetit Publik Privat mund të identifikojë individët kryesorë (përfaqësuesit e partnerit privat dhe/ose nënkontraktorët e tij) që do të jenë përgjegjës për realizimin e projektit, dhe mund të detajojë shkallën në të cilën ata do të punojnë ekskluzivisht në projekt. Kontrata e Partneritetit Publik Privat do të kërkojë njoftimin dhe/ose pëlqimin e autoritetit publik për çdo ndryshim të personelit kryesor.
 - **Ndryshimi, përfundimi dhe rinovimi i nënkontratave kryesore:** gjatë prokurimit të projektit, autoriteti publik do të vlerësojë përvojën dhe gjendjen financiare të partnerit privat dhe anëtarëve të caktuar të zinxhirit të tij të furnizimit (p.sh., nënkontraktorët e propozuar prej tij). Duke pasur parasysh rëndësinë e identitetit të nënkontraktorëve kryesorë për suksesin e projektit, kontrata e Partneritetit Publik Privat shpesh përfshinë dispozita që i kërkojnë partnerit privat të marrë miratimin paraprak të autoritetit publik përpara se partneri privat:
 - a) Të bëjë ndryshime materiale të nënkontratave kryesore;
 - b) Të ndërpresë një nënkontratë kryesore; ose
 - c) Të lidhë një nënkontratë të re.
 - **Rifinancimi:** kontrata zakonisht kërkon që partneri privat të marrë pëlqimin paraprak me shkrim të autoritetit publik (të mos mbahet ose të vonohet në mënyrë të paarsyeshme) për çdo rifinancim të borxhit të tij kryesor.
 - **Financimi me hua:** shumica e partnerëve privatë financojnë projektin përmes një kombinimi të huasë dhe kapitalit. *Financimi e projektit me hua* është raporti i huasë ndaj kapitalit. (Një projekt *i financiar shumë me hua* do të ketë një nivel të lartë huaje ndaj kapitalit, p.sh. 90%).
 - Disa kontrata të Partneritetit Publik Privat kufizojnë aftësinë e partnerit privat (për shembull, ky financim me hua nuk duhet të kalojë mbi 90% pa miratimin paraprak të autoritetit publik). Në disa vende, ekzistojnë në ligj kufizime të ngjashme (p.sh., nivelet minimale të kapitalizimit), por, për dallim nga dispozitat e kontratës të përmendura më lart, këto janë të natyrës së përgjithshme dhe jo specifike për projektet e Partneritetit Publik Privat.
 - **Ndryshimi i pronësisë së partnerit privat:** në kuadër të prokurimit të projektit, autoriteti publik do të ketë vlerësuar përvojën dhe gjendjen financiare të aksionarëve të partnerit privat (ose ekuivalenten e kësaj, nëse partneri privat nuk është shoqëri). Pasi të nënshkruhet kontrata e Partneritetit Publik Privat, autoriteti publik do të dëshirojë të sigurojë që aksionarët që janë propozuar në fazën e tenderit të mos ndryshojnë në dem të projektit.

Autoriteti publik mund të jetë më pak i shqetësuar për ndryshimet e aksionarëve në fazat e mëvonshme të kontratës së Partneritetit Publik Privat, veçanërisht pasi të ketë përfunduar faza e ndërtimit të projektit. Nëse kjo gjë

ndodh, atëherë kontrata e Partneritetit Publik Privat mund t'i trajtojë. për shembull, ndryshimeve të pronësisë në mënyrat e mëposhtme:

- a) Autoriteti publik ka të drejtën absolute të miratimit të çdo ndryshimi të pronësisë së partnerit privat përpara përfundimit të një periudhe të caktuar të barabartë me fazën e ndërtimit, plus një periudhë të caktuar (zakonisht deri në 5 vjet). Pas kësaj periudhe, të drejtat e miratimit të autoritetit publik përqendrohen kryesisht në çështjet e politikës publike (shih Pikën (c) më poshtë).
 - b) Disa kontrata të Partneritetit Publik Privat bëjnë dallimin midis klasave të ndryshme të aksionerëve të partnerit privat me të drejta të ndryshme miratimi që zbatohet për secilën klasë. Për shembull, një autoritet publik mund t'i përqendrojë të drejtat e veta të miratimit në heqjen e interesave të kapitalit të aksionerëve që janë të përfshirë gjithashtu edhe në realizimin e projektit (p.sh., kontraktorët e ndërtimit), krahasuar me aksionerët që nuk kanë pjesëmarrje aktive në projekt përtej investimit kapitalit.
 - c) Ndodh më rrallë që autoriteti publik të ketë të drejta miratimi për transferimin e interesave të kapitalit nga një entitet që i ofron partnerit privat shërbime afatgjata të menaxhimit të objekteve. Sidoqoftë, kjo mund të kërkojë një të drejtë miratimi nëse transferimi i kapitalit do të kishte një efekt material dhe negativ në aftësinë e partnerit privat për të përmbushur detyrimet e tij sipas kontratës së Partneritetit Publik Privat.
 - d) Shumë kontrata të Partneritetit Publik Privat përfshijnë të drejtat e miratimit për çdo ndryshim të pronësisë së partnerit privat (pavarësisht nga koha e ndryshimit të propozuar), ku aksioneri i propozuar është i angazhuar në një biznes që ngre shqetësime të politikave publike (p.sh., është i përfshirë në prodhimin e armëve). Shqetësimet duhet të përshkruhen në mënyrë objektive në kontratën e Partneritetit Publik Privat, për t'i krijuar partnerit privat njëfarë sigurie për rrethanat në të cilat do të kërkohej miratimi paraprak i autoritetit publik.
- **Identiteti i siguruesit:** autoriteti publik shpesh ka të drejtë të miratojë identitetin e siguruesit të partnerit privat përpara se të vendosë sigurimin përkatës. Kjo kërkesë normalisht vlen vetëm për policat e sigurimeve në të cilat autoriteti publik është palë që është emëruar si palë e siguruar.
 - Kjo duhet të merret në parasysh krahas ligjeve vendore që mund të kërkojnë që sigurimi parësor të behet pranë siguruesve vendas. Kur zbatohen ligje të tilla, huadhënësit e Partneritetit Publik Privat shpesh kërkojnë që sigurimi shtesë të bëhet në tregun ndërkombëtar dhe të jetë në gjendje të ketë akses të drejtpërdrejtë në të ardhurat e sigurimit përmes strukturës së sigurimit të projektit nëse siguruesi vendor humbet aftësinë pagueuse.

17.3 Pjesëmarrja në drejtimin/funksionimin e partnerit privat

Vendimi i autoritetit publik për të investuar në një partner privat merret në përgjithësi si çështje e politikës publike.

Megjithëse nuk është praktikë e përhapur, vëzhgimet se si është arritur kjo në disa juridiksione përfshijnë sa më poshtë vijon:

- a) Autoriteti publik ka pakicën e aksioneve (duke filluar nga 10% në 30%) por ka të drejtë të emërojë një anëtar në bordin e partnerit privat.
- b) Autoriteti publik investon kapital në baza të barabarta dhe me kushte që janë në përputhje me ato që zakonisht kërkohen nga një palë tregtare që merr pozicionin e pakicës së kapitalit në një partner privat. Kjo i jep autoritetit publik fleksibilitet për të shitur investimet e kapitalit të tij gjatë afatit të projektit.
- c) Marrëveshja e aksionerëve (ose një dokument i ngjashëm) përcakton të drejtat që lidhen me interesin e autoritetit publik tek partneri privat, bazën mbi të cilën partneri privat duhet të marrë vendime dhe të drejtat e secilit aksioner në lidhje me këto vendime.
- d) Marrëveshja e Aksionerëve përmban dispozita të *konfliktit të interesit*, të cilat përqendrohen në garantimin e asaj që autoriteti publik (dhe përfaqësuesi i tij i emëruar) nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në mbledhjet e bordit ose të votojnë për mocione ku lind një konflikt interesi.
- e) Ligji përkatës i shoqërive tregtare parashikon nivele të ndryshme të mbrojtjes për aksionaret e pakicës, do të thotë se masat mbrojtëse që i janë dhënë autoritetit publik (në cilësinë e tij si aksioner i pakicës) janë shpesh një kombinim i masave mbrojtëse të përcaktuara në Marrëveshjen e Aksionerëve dhe i masave mbrojtëse të parashikuara nga ligji. Shembuj të vendimeve të partnerit privat që kërkojnë mbështetjen e të gjithë aksionareve (përfshirë aksionaret e pakicës siç është autoriteti publik) përfshijnë sa më poshtë vijon:
 - Ndryshimin e dokumenteve të përbërjes së partnerit privat;
 - Listimin publik të shoqërisë;
 - Ndryshimin e politikës së dividendit të partnerit privat;
 - Blerjen e aksioneve;
 - Ndryshimet e klasifikimit të aksioneve ose i të drejtave që i bashkëlidhen çdo klase aksionesh;
 - Çdo rritje të borxhit të partnerit privat;
 - Dhënia të huave ose donacioneve bamirëse nga partneri privat;
 - Nisjen e procedurave të falimentimit; dhe
 - Lidhjen e një kontrate me një aksioner (ose filialin e një aksioneri) që nuk është në kushte të barabarta tregtare.

18. Dispozita të ndryshme

18.1 Panoramë e përgjithshme

Përveç llojeve specifike të dispozitave të trajtuara në këtë udhëzues, kontrata e Partneritetit Publik Privat përfshin gjithashtu edhe një seri dispozitash standarde që kanë të bëjnë kryesisht me çështje juridike të zakonshme si p.sh.:

- a) Procedurën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve;
- b) Administrimin e çështjeve të konfidencialitetit dhe kërkesave të lirisë së informacionit (ose LSI-së);
- c) Kufizimet për transferimin e kontratës së Partneritetit Publik Privat; dhe
- d) Pajtueshmërinë me ligjet mbizotëruese.

18.2 Procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve

Kontrata e Partneritetit Publik Privat do të përfshijë dispozita që përcaktojnë bazën e pranuar sipas të cilës zgjidhen ose përcaktohen të gjitha mosmarrëveshjet në lidhje me kontratën e Partneritetit Publik Privat.

Metoda e përdorur ndaj këtyre dispozitave shpesh varet nga politika më të gjëra të autoritetit publik në këtë drejtim.

Ekzistojnë dy metoda kryesore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, respektivisht, si më poshtë vijon:

- a) Referimi në gjykata zgjidh çdo mosmarrëveshje në përputhje me rregullat e procedurës dhe ligjet përkatëse; ose
- b) Arbitrazhi si mjet për zgjidhjen përfundimtare të mosmarrëveshjeve, ku vendi i zgjedhur për arbitrazhin është jashtë juridiksionit përkatës.

Pavarësisht përdorimit të gjykatave ose arbitrazhit për zgjidhjen përfundimtare të mosmarrëveshjeve, kontrata e Partneritetit Publik Privat mund të përfshijë gjithashtu edhe forma alternative të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Në këtë rast, palët do të kërkojnë të përdorin një procedurë alternative (p.sh., bordin e ndërmjetësimit ose të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve) përpara se të drejtohen në gjykata ose në arbitrazh.

Bordet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve zakonisht përdoren në projektet e Partneritetit Publik Privat në BE. Në fillimin e kontratës, palët caktojnë ekspertë të pavarur në një panel (bord) i cili do të japë një mendim ose gjykim për çështjet e mosmarrëveshjes midis palëve nëse kërkohet nga cilado palë. Gjykimi i bërë nga bordi është zakonisht jo detyrues ku referimi i mosmarrëveshjeve tek bordi nuk cenon të drejtën e palëve për t'ia referuar mosmarrëveshjen gjykatave ose arbitrazhit (sipas nevojës).

18.3 Dispozitat e konfidencialitetit dhe kërkesat e lirisë së informacionit

Është diçka e zakonshme që palët e çdo kontrate tregtare të bien dakord reciprokisht (në varësi të përjashtimeve të kufizuara) për t'i mbajtur të fshehta të gjitha çështjet në

lidhje me kontratën dhe administrimin e kontratës. Të dy palët e një kontratë publike (përfshirë kontratat e Partneritetit Publik Privat) zakonisht dëshirojnë t'i mbajnë të fshehta të gjitha çështjet në lidhje me kontratën. Ky parim i ruajtjes së konfidencialitetit shpesh i nënshtrohet të drejtave kushtetuese kombëtare ose vendore të publikut, lirisë së informacionit ose të drejtës për të njohur ligjet e juridiksionit përkatës.

Sidoqoftë, mund të ketë përjashtime nga këto lloje të të drejtave dhe ligjeve tek të cilat autoriteti publik (dhe/ose partneri privat) mund të jenë në gjendje të mbështeten nëse përballen me një kërkesë për zbulimin e informacionit në lidhje me kontratën ose projektin e Partneritetit Publik Privat (p.sh., interesat e sigurisë kombëtare, sekretet tregtare ose informacionet e biznesit me rëndësi kritike).

Legjislacioni në vendet e Ballkanit Perëndimor: Konfidencialiteti dhe liria e informacionit

Në disa vende të Ballkanit Perëndimor, e drejta e një personi për pasur akses në informacionin që mban qeveria është një e drejtë kushtetuese, e cila herë pas here plotësohet me ligj. Në juridiksionet e tjera, e drejta për të pasur akses në informacionin që mban qeveria sigurohet përmes lirisë së informacionit dhe/ose të drejtës për t'u njohur me ligjet. Shumica e të drejtave kushtetuese ose ligjore në lidhje me aksesin në informacionin e qeverisë pasqyrojnë parimin që qeveria duhet të jetë e detyruar të publikojë dhe nxisë hapjen dhe transparencën.

Shqipëria

Çdo person ka të drejtë të ketë akses në informacionet publike.⁷⁷ Ky parim i nënshtrohet disa përjashtimeve⁷⁸ (p.sh., interesi i sigurisë kombëtare, sekretet tregtare).

Bosnja dhe Hercegovina - Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës (HNC)

Në përgjithësi, çdo person ka të drejtë të ketë akses në informacionin që është nën kontrollin e një autoriteti publik, dhe çdo autoritet publik ka detyrimin përkatës që ta bëjë publik një informacion të tillë. Sidoqoftë, autoriteti publik mund të përjashtojë informacione të caktuara nga ky rregull nëse këto informacione përfaqësojnë interesat konfidenciale tregtare të palës së tretë.⁷⁹

Bosnja dhe Hercegovina - Republika Serbe

Si rregull, çdo person ka të drejtë të ketë akses në informacionin që është nën kontrollin e një autoriteti publik. Autoritetet publike janë të detyruara t'i japin këto informacione me kërkesë të çdo personi të interesuar. Sidoqoftë, një autoritet përkatës publik mund të përjashtojë informacione të caktuara nga ky rregull, p.sh., nëse ky informacion përfaqëson interesat konfidenciale tregtare të palës së tretë.

⁷⁷ Neni 3 i Ligjit 119/2014 për të drejtën e informimit.

⁷⁸ Neni 3 i Ligjit 119/2014 për të drejtën e informimit.

⁷⁹ Neni 7 i Ligjit të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës për Aksesin e lirë në informacionet e karakterit publik (Fletorja Zyrtare e Bosnjës dhe Hercegovinës, nr. 28/00, 45/06, 102/09 dhe 62/11).

Pala e tretë në fjalë duhet të dëshmojë se do të pësojë dëme nëse ato informacione do të bëheshin publike.⁸⁰

Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë (IRJM)

Kontrata e Partneritetit Publik Privat mund të vihet në dispozicion të publikut në bazë të Ligjit të Maqedonisë për akses të lirë në informacionin e karakterit publik.⁸¹ Gjithashtu, projekt kontrata është e disponueshme si pjesë e dokumentacionit të tenderit të publikuar në sistemin elektronik përkatës për prokurimin publik.

Kosova*

Çdo person ka të drejtë të ketë akses në dokumentet zyrtare që mbahen nga institucionet publike,⁸² përveç përjashtimeve të caktuara.⁸³

Mali i Zi

Kushtetuta e Malit të Zi⁸⁴ garanton të drejtën për të pasur akses në informacionin që mbajnë autoritetet publike, të cilat mund të kufizohen vetëm në raste të caktuara (p.sh., për mbrojtjen e jetës, shëndetit publik, moralit dhe intimitetit).

Serbia

Çdo person ka të drejtë të ketë akses në informacionin që është nën kontrollin e një autoriteti publik. Autoritetet publike janë të detyruara ta japin këtë informacion me kërkesë të çdo personi të interesuar, përveçse nëse autoriteti publik dëshmon se nuk ka ndonjë interes të arsyeshëm për të kërkuar informacionin. Autoritetet publike mund të përjashtojnë informacione të caktuara nga ky rregull i përgjithshëm, p.sh., nëse ai informacion ka një natyrë konfidenciale për një palë të tretë.⁸⁵

18.4 Kufizimet e transferimit të kontratës

Kontrata e Partneritetit Publik Privat do të përfshijë dispozita që lidhen me aftësinë e secilës palë për t'ia caktuar (ose transferuar) kontratën e Partneritetit Publik Privat një palë të tretë. Nëse secila nga palët nuk respekton kufizimet e caktimit apo të transferimit, atëherë pala tjetër do të ketë të drejtën ta ndërpresë kontratën për mosekzekutim të detyrimeve. Kufizimet e transferimit u japin palëve siguri në lidhje me identitetin e palës tjetër dhe parandalojnë situatën kur kontrata e Partneritetit Publik Privat mund të transferohej tek një palë të tretë që është më pak të aftë financiarisht

⁸⁰ Neni 7 i Ligjit të Republikës Serbe për Aksesin e lirë në informacionet e karakterit publik (Fletorja Zyrtare e Bosnjës dhe Hercegovinës, nr. 28/00, 45/06, 102/09 dhe 62/11).

⁸¹ Ligji për Akses të lirë në informacionet e karakterit publik (Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 13/2006), i ndryshuar.

⁸² Nenet 1 dhe 2 të Ligjit nr. 03 / L –155 për Aksesin në dokumentet publike.

⁸³ Neni 12 i Ligjit nr. 03/L –215 për Aksesin në dokumentet publike.

⁸⁴ Neni 51 i Kushtetutës së Malit të Zi ("Fletorja Zyrtare e Malit të Zi" nr. 01/07).

⁸⁵ Nenet 4 dhe 14 të Ligjit të Serbisë për Akses të lirë në informacionin e karakterit publik (Fletorja Zyrtare e Republikës së Serbisë, nr. 120/2004, 54/2007, 104/2009 dhe 36/2010).

ose teknikisht për të realizuar kontratën e Partneritetit Publik Privat sesa pala fillestare.

Ndonëse kontrata e Partneritetit Publik Privat do të përfshijë gjithashtu edhe një ndalim absolut të mundësisë së partnerit privat për të transferuar kontratën e Partneritetit Publik Privat tek një pale të tretë, kjo zakonisht nuk shtrihet tek partneri privat që jep interesa sigurie tek huadhënësit e tij. Kjo zakonisht nuk cenon kushtet e marrëveshjeve të drejtpërdrejta të lidhura midis autoritetit publik dhe huadhënësve të partnerit privat.

Duke pasur parasysh natyrën afatgjatë të kontratave të Partneritetit Publik Privat, shumë pranojnë se ndryshimet në organizimin e autoritetit publik mund të rezultojnë në nevojën që kontrata e Partneritetit Publik Privat të transferohet tek një subjekt publik pasardhës. Kontrata e Partneritetit Publik Privat mund të përfshijë dispozita që bëjnë të mundur që autoriteti publik t'ia caktojë kontratën e Partneritetit Publik Privat një pale të tretë, me kusht që autoriteti publik ose garanton detyrimet e pasardhësit të tij sipas kontratës së Partneritetit Publik Privat ose subjekt pasardhës të ketë një gjendje të ngjashme financiare për autoritetin publik.

Pavarësisht dispozitave të tilla të kontratës së Partneritetit Publik Privat, përgjithësisht njihet nga sektori privat fakti që qeveria është gjithnjë e lirë të miratojë legjislacion që bën të pavlefshëm efikasitetin dhe zbatueshmërinë e kufizimeve të tilla në rast të transferimit të kontratës nga autoriteti publik tek një palë e tretë. Sipas rrethanave, partnerët privatë zakonisht e njohin riskun e transferimit të kontratës së Partneritetit Publik Privat nga autoriteti publik tek një palë të tretë si një risk normal politik.

18.5 Respektimi i ligjeve

Në shumicën e rasteve, secilës palë të kontratës së Partneritetit Publik Privat do t'i kërkohet që të përmbushë detyrimet e saj sipas kontratës dhe për zbatimin e saj dhe në përputhje me të gjitha ligjet përkatëse. Nëse njëra palë shkel një detyrim të tillë, atëherë pala tjetër mund të përdorë mjetet ligjore (kontraktuale ose jo kontraktuale) që mund të ketë në dispozicion lidhje me një shkelje të tillë.

Fjalor i termave dhe frazave kryesore

Aftësia financiare

Aftësia financiare lidhet ose me aftësinë e autoritetit publik për të bërë pagesa të bazuara në performancë ndaj partnerit privat nga buxheti publik (në një Partneritet Publik Privat që paguhet nga qeveria) ose me aftësinë dhe gatishmërinë e përdoruesve për të paguar tarifatat/pagesat e vendosura nga partneri privat (në një koncesion).

Pagesa e disponueshmërisë (dhe Partneriteti Publik Privat e bazuar në disponueshmëri)

Në rastin e Partneritetit Publik Privat të bazuar në disponueshmëri (një lloj Partneriteti Publik Privat që paguhet nga qeveria), autoriteti publik paguan partnerin privat për sigurimin dhe përdorimin e infrastrukturës publike dhe shërbimeve të ngjashme publike. Pagesa është e lidhur me disponueshmërinë e asetit dhe/ose shërbimeve për kohëzgjatjen e kontratës së Partneritetit Publik Privat (pagesa e disponueshmërisë ose pagesa unitare/tarifa unitare). Standardet e disponueshmërisë dhe kërkesat e shërbimit të autoritetit publik përcaktohen në kontratën e Partneritetit Publik Privat.

Në shumicën e kontratave të këtij lloji, pagesa për partnerin privat fillon vetëm pasi të ketë përfunduar faza e ndërtimit dhe kur shërbimet mund të ofrohen.

I financueshëm (dhe financueshmëria)

Projekti i Partneritetit Publik Privat konsiderohet i financueshëm nëse huadhënësit janë të gatshëm ta financojnë atë.

Kandidat

Një shoqëri ose një grup shoqëri (zakonisht në formën e një konsorciumi ose ndërmarrje të përbashkët) që i përgjigjet një ftese për t'u parakualifikuar për një projekt, si pjesë e procesit të prokurimit.

Koncesion

Koncesioni (nganjëherë i quajtur edhe Partneriteti Publik Privat me pagesë të përdoruesit) është një lloj Partneriteti Publik Privat në të cilën autoriteti publik i jep një partneri privat të drejtën për të nxjerrë të ardhura nga ofrimi i një shërbimi. Partneri privat paguhet nga përdoruesit e shërbimit dhe normalisht merr riskun e të gjitha ndryshimeve të kërkesës së përdoruesve të shërbimit. Kërkesat e autoritetit publik për shërbimin përcaktohen në kontratën e koncesionit. (p.sh., mbajtja e një ure të hapur për qarkullimin rrugor, mbledhja e tarifave nga përdoruesit e një ure).

Parakushtet

Kushtet që duhet të përmbushen përpara se kontrata e Partneritetit Publik Privat të hyjë në fuqi ose para se të fillojë marrja e huasë. Secila palë mund të jetë përgjegjëse për përmbushjen e kushteve në një kontratë të veçantë të Partneritetit Publik, por partneri privat zakonisht ka një përgjegjësi më të madhe në këtë drejtim.

Mbyllja e kontratës (dhe mbyllja tregtare)

Mbyllja e kontratës (herë pas here e quajtur edhe *mbyllja tregtare*) është pika në të cilën autoriteti publik dhe partneri privat nënshkruajnë kontratën e Partneritetit Publik Privat. Kushtet kryesore të kontratës së Partneritetit Publik Privat do të përfundojnë në mbylljen financiare.

Rritja e kreditimit

Profili i kredisë së një strukture të financimit të projektit mund të përmirësohet nëpërmjet formave të ndryshme të rritjes së kredisë; për shembull:

- **Mbështetja me kredi** në formën e garancive nga sponsorët në lidhje me ekzekutimin e detyrimeve të SPV-së, lehtësirat e financimit që ofrojnë likuiditet të përkohshëm për të trajtuar risqet specifike dhe sigurimin e risqeve të caktuara të lidhura me projektin.
- **Mbështetja e sektorit publik** siç është financimi i drejtpërdrejtë përmes një kontributi kapitali (p.sh., nga fondet kombëtare, rajonale ose të tjera) ose mbështetje ose garanci të mundshme për lloje të caktuara risqesh, të cilat nuk mund të menaxhohen ose zbuten në mënyrë të efektshme nga SPV-ja, huadhënësit ose nënkontraktorët.

Mosekzekutim detyrimesh (dhe rast mosekzekutimi detyrimesh)

Shkelje materiale e kontratës nga njëra palë (përfshirë shkeljen e vazhdueshme) e cila i jep palës tjetër të drejtë që të ndërpresë kontratën. Kontrata e Partneritetit Publik Privat shpesh do të përcaktojë shkeljet duke iu referuar dispozitave të sakta kontraktuale.

Marrëveshje e drejtpërdrejtë

Marrëveshja e drejtpërdrejtë është një kontratë që ka lidhje me kontratën e Partneritetit Publik Privat, e cila krijon një marrëdhënie kontraktuale midis pjesëmarrësve në projekt, marrëdhëniet kryesore kontraktuale të së cilës janë me partnerin privat. Marrëveshja kryesore e drejtpërdrejtë është ajo ndërmjet autoritetit publik, partnerit privat dhe huadhënësit dhe bën të mundur që huadhënësi të ushtrojë të drejtat e ndërhyrjes në kontratën e Partneritetit Publik Privat. Autoriteti publik gjithashtu mund të ketë marrëveshje të drejtpërdrejta me nënkontraktorët e partnerit privat që bëjnë të mundur që ai të lidhë nënkontratë në një rast të mosekzekutimit të detyrimeve nga ana e partnerit privat.

Analiza e ekonomike e kostos dhe përfitimit (AEKP)

Analiza e ekonomike e kostos dhe përfitimi vlerëson nëse përfitimet e sjella për shoqërinë nga një investim i veçantë publik justifikojnë dhe tejkalojnë kostot e zbatimit apo jo. Zakonisht ajo do të marrë parasysh avantazhet dhe disavantazhet sociale, mjedisore dhe ekonomike të investimit, si dhe kostot faktike monetare dhe të ardhurat e krijuara nga projekti.

Kapitali (dhe investitorët e kapitalit)

Kapitali në një Partneriteti Publik Privat është pjesa e shpenzimeve kapitale CAPEX të projektit që jepet si kapital aksionesh në Subjektin për qëllime të veçanta SPV (d.m.th., kapitali i pastër) dhe borxhi i varur (zakonisht përmes kredive të aksionerëve që herë pas here quhet edhe *borxh i vogël*). Investitorët e kapitalit (që herë pas here quhen edhe *ofrues të kapitalit, sponsorët ose aksionaret*) zakonisht zotërojnë si kapitalin e pastër ashtu edhe borxhin e varur dhe zakonisht kontrollojnë SPV-në. Disa investitorë të kapitalit mund të mos marrin rol aktiv në menaxhimin e kontratës së Partneritetit Publik Privat.

Herë pas here, autoriteti publik mund t'i ofrojë kapital SPV-së, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose përmes një fondi të investimeve publike. Pjesëmarrja e publikut në kapitalin e SPV-së (përfshirë të drejtat e kontrollit) mund të ndikojë në trajtimin statistikor të kontratës së Partneritetit Publik Privat.

Mbyllja financiare

Mbyllja financiare është pika në të cilën nënshkruhen dokumentet e financimit të kontratës së Partneritetit Publik Privat (përfshirë marrëveshjen e drejtpërdrejtë midis huadhënësve dhe autoritetit publik) dhe financimi vihet në dispozicion të projektit. Zakonisht është pika në të cilën norma e interesit për projektin është fikse duke përdorur *këmbimin e normës së interesit*. Mbyllja financiare zakonisht ndodh në të njëjtën kohë ose menjëherë pas nënshkrimit të kontratës.

Risku fiskal

Partneritetet Publike Private krijojnë angazhime financiare afatgjata që (me kalimin e kohës dhe kur shqyrtohen me angazhime të tjera) mund të sfidojnë koherencën e procesit të buxhetit publik dhe, në fund të fundit, qëndrueshmërinë fiskale të një vendi dhe stabilitetin makroekonomik. Risqet fiskale mund të ekzistojnë kur angazhimet faktike dhe të mundshme për Partneritetin Publik Privat nuk njihen qartë ose kuptohen dhe kur ato nuk janë raportuar dhe buxhetuar në mënyrë të centralizuar.

Huadhënësit

Termi huadhënës në këta Udhëzues të Qendrës Evropiane të Ekspertizës së Partneritetit Publik Privat të Kuadrit të Investimeve të Ballkanit Perëndimor i referohet në përgjithësi organizatave që sigurojnë financime për Partneritetin Publik Privat në formën e borxhit kryesor për partnerin privat. Kjo mund të përfshijë banka tregtare, banka zhvillimi shumëpalësh dhe dypalësh, institucione financiare, si dhe investitorë institucionalë siç janë fondet e pensioneve dhe kompanitë e sigurimeve.

Kostot e ciklit të jetës (dhe kostot e tërë jetës)

Kjo është kostoja totale e krijimit të një aseti dhe administrimi i tij deri në fund të jetës së tij të dobishme (ose gjatë kohëzgjatjes së kontratës së Partneritetit Publik Privat). Kjo përfshin koston fillestare të ndërtimit dhe koston e të gjitha punëve të mëvonshme të mirëmbajtjes që garantojnë se aseti vazhdon të realizojë në një standard të pranueshëm ose minimal. Kontrata e Partneritetit Publik Privat përcakton standardin minimal të performancës që duhet të përmbushet nga partneri privat.

Vlerësimi i nevojave

Vlerësimi i hendekut midis një sërë objektivash të pranuar dhe rregullimeve ekzistuese që investimi synon të trajtojë.

Vlera aktuale neto (VAN) dhe norma e uljes

VAN-ja është vlera e zbritur e fluksit të hyrjes së parave të një projekti minus vlerën e zbritur të fluksit të daljes së parave të tij. Kjo llogaritet bazuar në një normë zbritje. Kjo temë diskutohet në mënyrë më të plotë në *Udhëzuesin e Qendrës Evropiane të Ekspertizës së Partneritetit Publik Privat të Kuadrit të Investimeve të Ballkanit Perëndimor për vlerësimin cilësor dhe sasior të vlerës së parasë në Partneritetin Publik Privat*.

Trajtimi në bilanc dhe jashtë bilancit (statistikor) i PPP-ve

Kontrata publike regjistrohet si në bilanc ashtu edhe jashtë bilancit të qeverisë qendrore sipas sistemit kombëtar të llogarive (zakonisht i njohur si *trajtimi statistikor* i kontratës). Trajtimi i një kontrate të Partneritetit Publik Privat brenda bilancit të qeverisë mund të jetë një kontribut i rëndësishëm për përgatitjen e projektit.

Anësia ndaj optimizmit

Anësia ndaj optimizmit është sjellja sistemike e autoriteteve publike (bazuar në përvojën e projektit) si për i) nënvlerësimin e afatit të fazës së ndërtimit të një projekti dhe shpenzimeve kapitale CAPEX dhe shpenzimeve operative OPEX të tij ashtu edhe ii) për mbivlerësimin e përfitimeve/të ardhurave që do të sjellë.

Specifikimi i produktit (dhe kërkesat e përdoruesit)

Këto janë kërkesat e sektorit publik të përcaktuara si një grup i qartë i rezultateve që mund të maten drejtpërdrejt në përputhje me standardet e performancës së cilësisë. Kërkesat e produktit (herë pas here të njohura edhe si *kërkesat e përdoruesve ose kërkesat e autoritetit*) mund të përfshijnë kërkesat teknike dhe kërkesat e shërbimit. Ato janë një tipar dallues i projekteve të Partneritetit Publik Privat në krahasim me kërkesat e produktit që zakonisht përdoren në prokurimin e projekteve tradicionale.

Mekanizmi i pagesës

Mekanizmi i pagesës është mjeti ose mekanizmi kryesor brenda kontratës së Partneritetit Publik Privat për shpërblimin e partnerit privat. Në Partneritetin Publik Privat të paguar nga qeveria ekzistojnë dy lloje kryesore të mekanizmit të pagesave si më poshtë vijon:

- *Mekanizmi i pagesave i bazuar në disponueshmëri*, ku pagesa që autoriteti publik i bën partnerit privat janë të lidhura me infrastrukturën që është e disponueshme për përdorim dhe me shërbimet që kryhen siç përcaktohet në kontratën e Partneritetit Publik Privat. Pagesa e disponueshmërisë i nënshtrohet zbritjeve nëse infrastruktura nuk është e disponueshme ose kur shërbimet kryhen dobët. Autoriteti publik merr riskun e ndryshimit të kërkesës për shërbime; dhe

- *Mekanizmi i pagesave i bazuar në kërkesë*, ku pagesa për partnerin privat lidhet me nivelin e përdorimit të infrastrukturës.

Në rastin e koncesionit, mekanizmi i pagesave mund të rregullojë bazën në të cilën partneri privat ka të drejtë t'i vendosë përdoruesve tarifa dhe të nxjerrë të ardhura.

Shkelje e vazhdueshme

Shkelja e vazhdueshme ndodh kur partneri privat nuk respekton në mënyrë konstante dispozitat e kontratës së Partneritetit Publik Privat, p.sh., nuk zbaton të njëjtën dispozitë në një numër të përsëritur rastesh ose akumulon penalizime financiare ose kontraktuale për një periudhë të caktuar.

Kontrata e Partneritetit Publik Privat

Ky është dokumenti kryesor kontraktor midis autoritetit publik dhe partnerit privat. Ai përcakton përgjegjësitë e partnerit privat për projektimin, ndërtimin, financimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e asetit dhe ofrimin e shërbimeve të lidhura publike. Kontrata e Partneritetit Publik Privat alokon risqet e projektit midis palëve dhe përmban mekanizmin e pagesës.

Kontrata e Partneritetit Publik Privat përshkruhet më plotësisht në *Udhëzuesin e Qendrës Evropiane të Ekspertizës së Partneritetit Publik Privat të Kuadrit të Investimeve të Ballkanit Perëndimor për dispozitat kryesore të kontratës së Partneritetit Publik Privat të bazuar në disponueshmëri*.

Njësia e Partneritetit Publik Privat

Organizatë e specializuar publike që ofron ekspertizë për Partneritetin Publik Privat në sektorin publik. Kjo mund të përfshijë këshilla dhe mbështetje për autoritetet publike në hartimin dhe zbatimin e projekteve të Partneritetit Publik Privat dhe/ose të politikave të Partneritetit Publik Privat. Ajo mund të ketë gjithashtu edhe një rol sigurimi ose miratimi. Zakonisht ajo është një pjesë e një ministrie qeveritare ose një agjencie publike qendrore, siç është Ministria e Financave.

Ofertuesi i preferuar

Ofertuesi që ka paraqitur ofertën më të mirë në përputhje me projektin e Partneritetit Publik Privat dhe me të cilin autoriteti publik synon të nënshkruajë kontratën e Partneritetit Publik Privat. Ofertuesi i preferuar bëhet partner privat kur nënshkruhet kontrata e Partneritetit Publik Privat.

Partneri privat

Shoqëria e sektorit privat që lidh kontratën e Partneritetit Publik Privat, që ka përgjegjësinë për ofrimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës publike dhe shërbimeve të lidhura publike gjatë afatit të kontratës. Zakonisht merr formën e një Subjekti për qëllime të veçanta (SPV).

Procedura e prokurimit

Direktiva e BE-së 2014/24/BE (Direktiva 2014) parashikon katër procedura të prokurimit:

- Procedura e hapur;
- Procedura e kufizuar;
- Procedura e dialogut konkurrues; dhe
- Procedura konkurruese me negociim.

Direktiva e vitit 2014 reformon dhe shfuqizon Direktivën 2004/18/KE (Direktiva 2004). Ajo mbulon prokurimin publik në përgjithësi, duke përcaktuar parimet që duhet të zbatohen për të gjitha kontratat e punëve, mallrave ose shërbimeve. Legjislacioni që trajton prokurimin publik brenda rajonit të Ballkanit Perëndimor përputhet, në pjesën më të madhe, me Direktivën e vitit 2004.

Proces i prokurimit

Udhëzuesit e Qendrës Evropiane të Ekspertizës së Partneritetit Publik Privat të Kuadrit të Investimeve të Ballkanit Perëndimor e përdorin këtë shprehje për të përshkruar hapat dhe aktivitetet që autoriteti publik miraton për të zbatuar procedurën e tij të zgjedhur të prokurimit. Kur përcakton procesin e prokurimit, autoriteti publik do të marrë parasysh çështje të tilla si kalendari i prokurimit (përfshirë objektivat kryesorë), numrin e ofertuesve për para-kualifikim, numrin dhe formatin e takimeve me ofertuesit.

Cikli i projektit

Cikli i projektit është përdorur në udhëzuesit e Qendrës Evropiane të Ekspertizës së Partneritetit Publik Privat të Kuadrit të Investimeve të Ballkanit Perëndimor për të përshkruar serinë e hapave që ndiqet nga një projekt tipik i Partneritetit Publik Privat nga koha kur përcaktohet fillimisht qëllimi i projektit, deri në përfundimin e tij dhe ofrimi i shërbimeve përkatëse. Cikli i projektit është i ndarë në katër faza:

- Faza 1: Faza e identifikimit të projektit
- Faza 2: Faza e përgatitjes së projektit
- Faza 3: Faza e prokurimit të projektit
- Faza 4: Faza e zbatimit të projektit

Financimi i projektit (dhe strukturat e financimit të projektit)

Projektet e Partneritetit Publik Privat financohen në përgjithësi duke përdorur strukturat e *financimit të projektit*. Struktura e financimit të projektit kërkon të optimizojë disponueshmërinë e financave dhe të theksojë alokimin e risqeve tek palët që janë më të afta për t'i menaxhuar ato risqe.

Asetet dhe të ardhurat e projektit zakonisht ndodhen brenda SPV-së. Huadhënësit dhe investitorët e SPV-së ose mbështeten ose në mënyrë ekskluzive (d.m.th., financim *pa rikthim*) ose kryesisht (d.m.th. financim me *rikthim të kufizuar*) në fluksin e parave të krijuar nga projekti për sigurinë e tyre lidhur me shlyerjen e kredive ose për të fituar kthimin e investimit të tyre. Kjo është në kontrast me financimin e korporatave

ku huadhënësit mbështeten në forcën e bilancit të huamarrësit si siguri për shlyerjen e kredive të tyre.

Faza e identifikimit të projektit

Faza e identifikimit është faza e parë e *ciklit të projektit*. Në fund të kësaj faze, autoriteti publik përcakton nëse projekti i zgjedhur mund (dhe duhet) të zhvillohet apo jo më tej si një Partneritet Publik Privat dhe nëse do të vazhdojë në fazën e përgatitjes së projektit.

Faza e zbatimit të projektit

Faza e zbatimit është faza e katërt dhe e fundit e *ciklit të projektit*. Ajo ndjek mbylljen financiare dhe përfshin menaxhimin e kontratës së Partneritetit Publik Privat dhe monitorimin e rregullt të performancës së partnerit privat.

Faza e përgatitjes së projektit

Faza e përgatitjes është faza e dytë e *ciklit të projektit*. Ajo përfshin zhvillimin e projektit të mundshëm në mënyrë që ai të jetë i gatshëm për fazën e prokurimit të projektit. Autoriteti publik do të krijojë strukturën e menaxhimit të projektit (d.m.th., ekipin e projektit dhe komiteti, drejtues), do të kryejë vlerësime të mëtejshme të projektit dhe do të përgatisë dokumentet përkatëse për fazën e prokurimit. Vlerësimet përfshijnë analizën e hollësishme të përbalueshmërisë, shpërndarjen e riskut dhe vlerësimin e vlerës së parasë. Autoriteti publik përcakton procedurën dhe procesin e preferuar të prokurimit, kriteret e vlerësimit dhe draftin e kontratës së Partneritetit Publik Privat.

Faza e prokurimit të projektit

Faza e prokurimit është faza e tretë e *ciklit të projektit*. Ajo pason fazën e përgatitjes dhe fillon me publikimin e njoftimit të prokurimit. Ajo përfshin të gjitha aktivitetet e lidhura me procesin e prokurimit deri në dhënien e kontratës së Partneritetit Publik Privat dhe deri në mbylljen e kontratës, dhe përfundon me mbylljen financiare.

Autoriteti publik

Organi i sektorit publik (që herë pas here njihet si *autoriteti prokurues* ose *autoriteti kontraktor*) që planifikon të lidhë një kontratë të Partneritetit Publik Privat me një partner të sektorit privat. Në rastin e një Partneritetit Publik Privat të bazuar në disponueshmëri, është organi publik që është përgjegjës edhe për shlyerjen e pagesës së disponueshmërisë tek partneri privat.

Partneritetet Publike Private (PPP)

Termi Partneritet Publik Privat përshkruan një marrëveshje kontraktuale afatgjatë në të cilën një autoritet publik dhe një partner privat bashkëpunojnë për të ofruar infrastrukturë publike (ose asete) dhe shërbimet përkatëse. Sipas kontratës së Partneritetit Publik Privat, partneri privat mban risqe dhe përgjegjësi drejtuese të mëdha. Dy llojet kryesore të kontratës së Partneritetit Publik Privat janë Partneriteti

Publik Privat i paguar nga qeveria (që përfshin Partneritetet Publike Private të *bazuara në disponueshmëri* dhe të *bazuara në kërkesë*) dhe *koncesioni* (herë pas here i quajtur si Partneriteti Publik Privat me pagesë të përdoruesit).

Krahasuesi i sektorit publik (KSP)

Krahasuesi i sektorit publik është një model i fluksit të parave i përshtatur me riskun për realizimin e një projekti duke përdorur një opsion tradicional të prokurimit publik (herë pas here quhet *standardi krahasues i sektorit publik*, SKSP). Krahasimi i vlerave aktuale neto të opsioneve të Krahasuesit të sektorit publik dhe të Partneritetit Publik Privat për një projekt të veçantë mund të përdoret si pjesë e një vlerësimi sasior të vlerës së parasë.

Vlerësimet cilësore dhe sasior të vlerës së parasë

Vlerësimi cilësor i vlerës së parasë shpesh përfshin testimin e opsionit të ofrimit të projektit të Partneritetit Publik Privat kundrejt një grupi kriteresh të përcaktuara paraprakisht (d.m.th., cilësore) për të përcaktuar potencialin e opsionit të Partneritetit Publik Privat për të siguruar vlerën e parasë.

Vlerësimi sasior i vlerës së parasë zakonisht përfshin vlerësimin dhe krahasimin e kostove të një opsioni të realizimit të një projekti të Partneritetit Publik Privat me një mundësi tradicionale të realizimit të projektit publik (d.m.th., një Krahasuesi i sektorit publik) ku janë vlerësuar risqet e projektit. Kostoja e vlerësuar e secilit opsion të realizimit llogaritet në bazë të vlerës faktike duke përdorur një normë të përshtatshme zbritje.

Kjo temë diskutohet më plotësisht në Udhëzuesin e Qendrës Evropiane të Ekspertizës së Partneritetit Publik Privat të Kuadrit të Investimeve të Ballkanit Perëndimor për vlerësimin cilësor dhe sasior të vlerës së parasë në Partneritetin Publik Privat.

Menaxhimi i riskut

Menaxhimi i riskut është një proces që ndihmon në identifikimin, analizimin, çmimin dhe alokimin e risqeve të projektit. Ai fillon gjatë fazës së identifikimit të projektit dhe vazhdon gjatë afatit të projektit të Partneritetit Publik Privat (përfshirë monitorimin dhe shqyrtimin e risqeve gjatë fazës së zbatimit). Kjo temë diskutohet në mënyrë më të plotë në *Udhëzuesin e Qendrës Evropiane të Ekspertizës së Partneritetit Publik Privat të Kuadrit të Investimeve të Ballkanit Perëndimor për vlerësimin cilësor dhe sasior të vlerës së parasë në Partneritetin Publik Privat*.

Borxhi kryesor

Kjo është forma kryesore e borxhit të marrë nga partneri privat dhe renditet mbi format e tjera të borxhit (p.sh., borxhi i vogël ose i varur). Huadhënësit kryesorë të borxhit zakonisht kanë përparësinë e parë për shlyerjen e huasë nga partneri privat dhe (në rast të mosekzekutimit të detyrimeve) ndaj asetëve ose të ardhurave të tij. Huadhënësit kryesorë të borxhit kanë gjithashtu edhe përparësinë e kompetencave vendimmarrëse nëse ushtrojnë të drejta për të ndërhyrë.

Përshtatshmëria (si Partneritetin Publik Privat)

Përshtatshmëria i referohet përshtatshmërisë së përdorimit të opsionit të Partneritetit Publik Privat për të realizuar një projekt të veçantë. Projekti vlerësohet i përshtatshëm, në parim, si një Partneritetin Publik Privat nëse ai zotëron karakteristika të caktuara specifike të projektit ndërkohë që mjediset ligjore, institucionale dhe kombëtare të tregut janë mbështetëse. Kjo temë diskutohet në mënyrë më të plotë në *Udhëzuesin e Qendrës Evropiane të Ekspertizës së Partneritetit Publik Privat të Kuadrit të Investimeve të Ballkanit Perëndimor për vlerësimin cilësor dhe sasior të vlerës së parasë në Partneritetin Publik Privat*.

Subjekt për qëllime të veçanta (SPV) ose kompani për qëllime të veçanta (SPC)

Shih *partnerin privat*. Një subjekt ligjor, qëllimi i vetëm i të cilit është të zbatojë projektin e Partneritetit Publik Privat dhe që përgjithësisht krijohet në vendin ku ndodhet projekti.

Të drejtat e ndërhyrjes

E drejta e ndërhyrjes është një dispozitë kontraktuale e drejtpërdrejtë, e cila lejon dikë të ndërhyjë në vendin e një pale që nuk ka ekzekutuar detyrimet, në mënyrë që pala që ndërhyrjen të mund të korigjojë mosekzekutimin e detyrimeve (dhe të parandalojë ndërprerjen e kontratës). Dy llojet kryesore të të drejtave të ndërhyrjes në një Partneritet Publik Privat janë ato që i jepen autoritetit publik dhe ato që i jepen huadhënësve të projektit.

Borxhi i varur

Borxhi që zakonisht sigurohet nga aksionaret e SPV-së dhe në të njëjtën proporcion me aksionet e tyre përkatëse. Ky borxh është në vartësi të borxhit tjetër (d.m.th., renditet nën borxhin kryesor).

Ngjarje e paparashikuar

Ngjarja e paparashikuar është një ngjarje që ndodh gjatë rrjedhës së kontratës së Partneritetit Publik Privat dhe që është jashtë kontrollit të secilës palë. Ngjarje të tilla trajtohen në kontratën e Partneritetit Publik Privat si një *rast kompensimi*, një *rast ndihme* (ose një *rast vonese*) ose si një *ngjarje e forcave madhore*. Këto raste përshkruhen në mënyrë të plotë në *Udhëzuesin e Qendrës Evropiane të Ekspertizës së Partneritetit Publik Privat të Kuadrit të Investimeve të Ballkanit Perëndimor për dispozitat kryesore të kontratës së Partneritetit Publik Privat të bazuar në disponueshmëri*.

Ofertuesi

Një shoqëri ose një grup shoqëri (zakonisht në formën e një konsorciumi ose ndërmarrje të përbashkët) që është para-kualifikuar (dhe është klasifikuar ndoshta edhe në listën e përzgjedhur) nga autoriteti publik si kandidat në procesin e prokurimit për projektin Partneritetit Publik Privat me qëllim që të ftohet për të paraqitur një ofertë.

Prokurimi publik tradicional ose ofrimi i shërbimeve

Metodë tradicionale e prokurimit publik ose e ofrimit të shërbimeve që përfshin sigurimin dhe financimin e infrastrukturës publike dhe shërbimeve përkatës nga autoriteti publik. Autoriteti publik është përgjegjës për funksionimin dhe mirëmbajtjen afatgjatë të infrastrukturës. Autoriteti publik gjithashtu mban pjesën më të madhe të risqeve që lidhen me integrimin dhe optimizimin e aktiviteteve të ndryshme brenda projektit.

Kontratat më të përdorura dhe që janë prokuruar tradicionalisht janë si më poshtë vijon:

- Kontrata që është vetëm kontratë ndërtimi (ose konstruksioni) (zakonisht me një kontratë të veçantë për projektimin e infrastrukturës);
- Kontrata për ndërtimin dhe projektimin;
- Kontrata inxhinierike, prokurimi dhe ndërtimi (IPN); dhe
- Kontrata vetëm për funksionim dhe mirëmbajtje.

Vlera e parasë(VeP)

Vlera e parasë konsiderohet si bilanci relativ midis vlerës dhe kostos së opsioneve të ndryshme të ofrimit të shërbimeve që janë të disponueshme (d.m.th., ndërmjet një qasjeje tradicionale të ofrimit të shërbimeve dhe një qasje të Partneritetit Publik Privat), ku:

- Aspekti *i vlerës* përfshin cilësinë dhe sasinë e shërbimit (d.m.th., nivelin e performancës) të opsioneve të ndryshme, të ofruara gjatë periudhës së Partneritetit Publik Privat; dhe
- Aspekti *i kostos* zakonisht paraqet koston e pagesit (d.m.th., autoriteti publik dhe/ose përdoruesi i fundit) gjatë të së njëjtës periudhë për të ofruar opsione të ndryshme (përfshirë koston e administrimit të risqeve).

Vlerësimi i vlerës së parasë do të identifikojë mundësinë e ofrimit të shërbimeve që përfaqëson bilancin më të mirë afatgjatë të vlerës dhe kostos të përshtatura me riskun.


Kjo temë diskutohet në mënyrë më të plotë në *Udhëzuesin e Qendrës Evropiane të Ekspertizës së Partneritetit Publik Privat të Kuadrit të Investimeve të Ballkanit Perëndimor për vlerësimin cilësor dhe sasior të vlerës së parasë në Partneritetin Publik Privat.*



Kontakte

Për informacion:

EPEC Secretariat

 +352 4379-22022

 +352 4379-65499


 QEEP@eib.org

www.eib.org/epec

European Investment Bank

98-100, boulevard Konrad Adenauer

L-2950 Luxembourg

 +352 4379-1

 +352 437704

www.eib.org